



# PROGRAMI I ZONAVE FUNKSIONALE MALËSI E MADHE

Ky dokument është përgatitur nga Programi për Decentralizim dhe Zhvillim Lokal (dldp), me mbështetjen financiare të Agjensisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC).

Ky publikim reflekton mendimet e autorëve dhe jo detyrimisht të SDC

Zhvilluar nga:  
Instituti i Kërkimeve Urbane (URI)

Publikuar nga:  
Programi për Decentralizim dhe Zhvillim Lokal (dldp)

**HELVETAS Swiss Intercooperation** | Albania  
Adresa: Rruga "Ibrahim Rugova",  
Pallati i PLUS, kati i 2-të / Nr. 3. Tiranë | Shqipëri  
[www.dldp.al](http://www.dldp.al) | [www.km.dldp.al](http://www.km.dldp.al)

# PËRMBAJTJA

<b>HYRJE</b> .....	1
<b>PJESA A: ANALIZA E ZONËS FUNKSIONALE</b> .....	5
<b>1. Përshkrim i përgjithshëm i zonës funksionale Malësi e Madhe</b> .....	5
1.1. Gjeografia .....	5
1.2. Historia dhe kultura.....	6
1.3. Prirjet demografike .....	6
1.4. Tiparet e zonës funksionale .....	13
<b>2. Ekonomia e zonës funksionale Malësi e Madhe</b> .....	14
2.1. Karakteristika të ekonomisë së zonës funksionale.....	14
2.1.1. Të dhëna të përgjithshme ekonomike .....	14
2.1.2. Tregu i punës.....	20
2.2. Ndërveprimet ekonomike të zonës funksionale.....	23
2.3. Analizë e hollësishme e zonës funksionale.....	28
2.3.1. Analiza ekonomike e sektorit të bujqësisë.....	28
2.3.2. Analiza ekonomike e sektorit të turizmit .....	50
<b>3. Hartëzimi i shërbimeve publike të zonës funksionale Malësi e Madhe</b> .....	59
3.1. Ujësjetllës Kanalizime .....	59
3.2. Menaxhimi i mbetjeve .....	63
3.3. Rrugët, hekurudhat dhe transporti publik .....	72
<b>4. Organizimi i qeverisjes vendore të tanishme</b> .....	80
4.1. Struktura dhe burimet njerëzore.....	80
4.2. Veçantitë dhe të përbashkëtat në dhënien e shërbimeve publike.....	84
4.3. Rekomandime mbi strukturën organizative të njësië vendore Malësi e Madhe .....	84
<b>PJESA B: PROGRAMI I ZHVILLIMIT TË ZONËS FUNKSIONALE</b> .....	87
<b>5. Koncepti i zonës funksionale Malësi e Madhe</b> .....	87
<b>6. Projekte kyçe të zonës funksionale Malësi e Madhe</b> .....	87

## Lista e hartave

<i>Harta 1: Zona Funktionale Malësi e Madhe.....</i>	<i>1</i>
<i>Harta 2: Krahina Malësi e Madhe.....</i>	<i>5</i>
<i>Harta 3: Punësimi sipas degëve të ekonomisë në njësitë vendore të ZF Malësi e Madhe.....</i>	<i>21</i>
<i>Harta 4: Ndërveprimi për konsum në ZF Malësi e Madhe.....</i>	<i>24</i>
<i>Harta 5: Ndërveprimi për punësim në ZF Malësi e Madhe.....</i>	<i>25</i>
<i>Harta 6: Bashkëpunimi ndërmjet njësive vendore të ZF Malësi e Madhe.....</i>	<i>27</i>
<i>Harta 7: Kultivimi i tokës bujqësore në njësitë vendore të ZF Malësi e Madhe.....</i>	<i>42</i>
<i>Harta 8: Toka bujqësore e pambjellë sipas njësive vendore të ZF Malësi e Madhe.....</i>	<i>47</i>
<i>Harta 9: Përqendrimi i veprimtarisë turistike në sezonin veror në ZF Malësi e Madhe.....</i>	<i>52</i>
<i>Harta 10: Zona Liqenore e Malësisë së Madhe.....</i>	<i>55</i>
<i>Harta 11: Harta turistike Kelmend.....</i>	<i>58</i>
<i>Harta 12: Mbulimi aktual i popullsisë me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve në ZF MM.....</i>	<i>64</i>
<i>Harta 13: Skemë e përgjithshme e grumbullimit të mbetjeve urbane nga ZF Malësi e Madhe.....</i>	<i>70</i>
<i>Harta 14: Infrastruktura rrugore e zonës funksionale Malësi e Madhe.....</i>	<i>74</i>

## Lista e grafikëve

<i>Grafiku 1: Ndryshimi i popullsisë ZF Malësi e Madhe gjatë viteve 2001 deri 2011 .....</i>	<i>9</i>
<i>Grafiku 2: Struktura e popullsisë ZF Malësi e Madhe .....</i>	<i>11</i>
<i>Grafiku 3: Niveli i arsimimit në ZF Malësi e Madhe krahasuar me mesataren e vendit.....</i>	<i>12</i>
<i>Grafiku 4: Bizneset e reja në ZF Malësi e Madhe, të regjistruara nga 05.09.2007 deri 27.11.2014.....</i>	<i>17</i>
<i>Grafiku 5: Investime për frymë kryer nga NJQV-të e ZF Malësi e Madhe gjatë vitit 2014 .....</i>	<i>18</i>
<i>Grafiku 6: Të punësuarit në shtëpi dhe që udhëtojnë për në punë në ZF Malësi e Madhe .....</i>	<i>26</i>
<i>Grafiku 7: Hyrjet e daljet ditore të të punësuarve në ZF Malësi e Madhe.....</i>	<i>26</i>
<i>Grafiku 8: Përdorimi në vite i tokës bujqësore në ZF Malësi e Madhe.....</i>	<i>29</i>
<i>Grafiku 9: Përdorimi në vite i tokës bujqësore, foragjere e bimë mjeksore në ZF Malësi e Madhe .....</i>	<i>30</i>
<i>Grafiku 10: Përdorimi i tanishëm i tokës bujqësore në ZF Malësi e Madhe.....</i>	<i>30</i>
<i>Grafiku 11: Sasie e eksportuar në vite e bimëve mjeksore nga prodhimi i ZF Malësi e Madhe .....</i>	<i>31</i>
<i>Grafiku 12: Eksporti i bimëve mjekësore të ZF Malësi e Madhe kundrejt nivelit kombëtar .....</i>	<i>32</i>
<i>Grafiku 13: Sasie e eksportuar në vite e gështenjave nga prodhimi i ZF Malësi e Madhe .....</i>	<i>35</i>
<i>Grafiku 14: Vlerësim i të ardhurave aktuale nga prodhimi e shitja e gështenjës në ZF Malësi e Madhe. 35</i>	
<i>Grafiku 15: Të ardhurat nga shitja në grumbullim dhe eksporti i gështenjës në ZF Malësi e Madhe.....</i>	<i>36</i>
<i>Grafiku 16: Numri i krerëve të kafshëve blegtorale në vite në ZF Malësi e Madhe.....</i>	<i>43</i>
<i>Grafiku 17: Numri i krerëve të shpendve në vite në ZF Malësi e Madhe .....</i>	<i>43</i>
<i>Grafiku 18: Numri i krerëve të bletëve koshere në vite në ZF Malësi e Madhe .....</i>	<i>44</i>
<i>Grafiku 19: Gjendja e blegtorisë në ZF Malësi e Madhe, 2013 .....</i>	<i>44</i>
<i>Grafiku 20: Kosto e vlerësuar e menaxhimit të mbetjeve të ZF Malësi e Madhe .....</i>	<i>69</i>
<i>Grafiku 21: Investimi në ndërtim rrugësh ndaj investimeve gjithsej në ZF Malësi e Madhe, 2014.....</i>	<i>77</i>

## Lista e tabelave

<i>Tabela 1: Niveli i punësimit në ZF Malësi e Madhe (%).....</i>	<i>7</i>
<i>Tabela 2: Treguesit e paaftësisë në punë për ZF Malësi e Madhe.....</i>	<i>8</i>
<i>Tabela 3: Popullsia dhe tendencat e rritjes/zvogëlimit të ZF Malësi e Madhe.....</i>	<i>9</i>
<i>Tabela 4: Struktura e popullsisë e njësive vendore të ZF Malësi e Madhe.....</i>	<i>10</i>
<i>Tabela 5: Niveli i arsimimit të popullsisë në ZF Malësi e Madhe.....</i>	<i>11</i>
<i>Tabela 6: Shkolla, kopshte dhe qendra sociale, kulturore e sportive të ZF Malësi e Madhe.....</i>	<i>13</i>
<i>Tabela 7: Bizneset aktive në ZF Malësi e Madhe, deri 27.11.2014.....</i>	<i>15</i>
<i>Tabela 8: Punëdhënësit kryesorë në ZF Malësi e Madhe, 2014.....</i>	<i>16</i>
<i>Tabela 9: Pësia e investimeve ndaj të ardhurave të njësive vendore të ZF Malësi e Madhe.....</i>	<i>18</i>
<i>Tabela 10: Burimi i të ardhurave të njësisë ekonomike familjare në ZF Malësi e Madhe (%).....</i>	<i>20</i>
<i>Tabela 11: Punësimi në ZF Malësi e Madhe sipas degëve të ekonomisë (%).....</i>	<i>21</i>
<i>Tabela 12: Punësimi në ZF Malësi e Madhe sipas nivelit arsimor (%).....</i>	<i>22</i>
<i>Tabela 13: Papunësia në ZF Malësi e Madhe sipas grup-moshave.....</i>	<i>22</i>
<i>Tabela 14: Papunësia në ZF Malësi e Madhe sipas nivelit arsimor.....</i>	<i>23</i>
<i>Tabela 15: Mjetet mekanike të përdorura në sektorin e bujqësisë të ZF Malësi e Madhe.....</i>	<i>29</i>
<i>Tabela 16: Shpërndarja e tokës bujqësore të mbjellë dhe të pambjellë në ZF Malësi e Madhe.....</i>	<i>46</i>
<i>Tabela 17: Treguesit e Performancës për vitin 2013, SHAU Malësi e Madhe, SHAU Shkodër Fshat.....</i>	<i>60</i>
<i>Tabela 18: Përmbledhja e të dhënave për shërbimin e pastrimit në NjQV-të e ZF.....</i>	<i>65</i>
<i>Tabela 19: Tarifat e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve në NJ.Q.V-të e ZF Malësi e Madhe.....</i>	<i>65</i>
<i>Tabela 20: Kosto e shërbimit të mbetjeve në NJ.Q.V-të e ZF Malësi e Madhe.....</i>	<i>66</i>
<i>Tabela 21: Mbulimi me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve në ZF Malësi e Madhe.....</i>	<i>67</i>
<i>Tabela 22: Tregues të shërbimit të menaxhimit të mbetjeve në ZF Malësi e Madhe.....</i>	<i>68</i>
<i>Tabela 23: Transporti për në punë i të punësuarve në ZF Malësi e Madhe.....</i>	<i>75</i>
<i>Tabela 24: Linjat e transportit publik të ZF Malësi e Madhe.....</i>	<i>76</i>
<i>Tabela 25: Rrugët rurale nën administrimin e njësive vendore të ZF Malësi e Madhe, 2012.....</i>	<i>77</i>
<i>Tabela 26: Shpenzime mirëmbajtje rrugësh në ZF Malësi e Madhe, 2014.....</i>	<i>78</i>
<i>Tabela 27: Vlerësim i kostos së mirëmbajtjes së rrjetit të rrugëve të ZF Malësi e Madhe.....</i>	<i>78</i>


## HYRJE

Programi për Decentralizim dhe Zhvillim Vendor (DLDP) në kuadër të misionit të tij për zhvillimin e kapaciteteve të qeverisë vendore të Shqipërisë, ka ngritur Programin e Zonave Funktionale (PZF) në përgjigje të riorganizimit të njërive të kësaj qeverie sipas funksionalitetit të tyre me zbatimin e reformës së re administrative dhe territoriale në vend.

Programi përmban hartimin e një koncepti të zhvillimit strategjik (KZHS) për disa zona funksionale (ZF) të përzgjedhura të vendit.

Dokumenti i këtushëm është koncepti i zhvillimit strategjik të zonës funksionale Malësi e Madhe e cila ka në përbërje gjashtë njësi të qeverisjes vendore (NJ.Q.V): Bashkisë Koplík dhe Komunave Qendër, Gruemirë, Kastrat, Shkrel dhe Kelmend.

**Harta 1: Zona Funktionale Malësi e Madhe**



Burimi: DLDP, Raporti i Zonave Funktionale, 2014

Ky dokument është hartuar nga Instiuti i Kërkimeve Urbane në bashkëpunim me grupet e punës të ngritura pranë gjashtë njërive të qeverisjes vendore dhe në konsultim të vazhdueshëm me publikun dhe grupet e interesit.

Programi i Zonës Funktionale ka objektiv hartimin e një dokumenti i cili identifikon sektorët prioritarë të zhvillimit afatgjatë të Zonës Funktionale Malësi e Madhe, ose Bashkisë së ardhshme, duke drejtuar politikatat e zhvillimit të ardhshëm ekonomik, përmirësimin e

infrastrukturës publike, të shërbimeve publike, menaxhimin më të mirë të territorit duke garantuar mbrojtjen e mjedisit, dhe përmirësimin e jetës shoqërore.

Qëllimi i tij është të mbështesë qeveritë e ardhshme vendore me një koncept të zhvillimit strategjik të hartuar mbi bazën e kohezionit të zonave funksionale, sinergjisë, ekonomive të shkallës e gjithëpërfshirjes, elemente të cilat përcaktojnë pikërisht shkallën e *funksionalitetit* të tyre.

Procesi për hartimin e këtij programi ka përfshirë një numër të konsiderueshëm stafi nga Bashkia Koplík e Komunat Qendër, Gruemirë, Kastrat, Shkrel e Kelmend, grupe interesi me përfaqësues të biznesit lokal, të fermerëve, të familjeve, përfaqësues të Drejtorive të pushtetit Qendror në nivel lokal për sektorët kryesorë të analizuar, përfaqësues të shoqërisë civile të organizatave ambientaliste.

Programi i Zonës Funksionale është i përbërë nga dy pjesë:

Pjesa e parë (A) përmban një përshkrim të përgjithshëm të zonës funksionale, analizën e zonës funksionale në tre drejtime: analiza ekonomike dhe potenciali i zhvillimit të sektorëve kyç të ekonomisë, hartëzimi i shërbimeve publike, organizimi i qeverisjes së njësive vendore, duke nxjerrë në pah për secilën fushë çështjet kryesore, barrierat për zhvillim dhe rekomandimet për adresimin e këtyre problemeve në të ardhmen.

Pjesa e dytë (B) përmban vizionin e zonës funksionale Malësi e Madhe si e tërë dhe objektivat strategjike të zhvillimit të saj, si dhe parashtron një numër projekt idesh të derivuara nga gjetjet dhe rekomandimet e analizës dhe në shërbim të zbatimit të tyre.

Programi i Zonës Funksionale është hartuar në periudhën shtator 2014 – prill 2015, duke ndjekur një proces dinamik i cili, si i tillë, ka pasqyruar përshtatjen shkallë-shkallë me qasjen e re të krijimit dhe funksionimit të njësive vendore në të ardhmen.

***Në krye të fillimit të punës***, PZF u prezantua tek administrata e gjashtë njësive vendore të cilat do të shkrihen nën zonën funksionale Malësi e Madhe, në një takim të përbashkët dhe në takime të veçanta me qëllim njohjen me të të gjitha njësive dhe sigurimin prej tyre të bashkëpunimit në këtë sipërmarrje.

Puna për këtë program është zhvilluar në dy faza, rezultati i të cilave janë pjesët A dhe B të dokumentit.

***Gjatë fazës së parë***, u krye analiza e gjendjes së gjashtë njësive të qeverisjes vendore në tre drejtime të përcaktuara:

- a) analizë e gjendjes së ekonomisë së NJ.Q.V-ve
- b) analizë e gjendjes së shërbimeve publike që jepen aktualisht nga NJ.Q.V-të
- c) analizë e strukturës organizative të tanishme të NJ.Q.V-ve

Mbledhja e të dhënave dhe informacionit fillestar mbi ekonominë, shërbimet publike dhe strukturën organizative është kryer duke përdorur *pyetësorë* drejtuar grupeve të punës së njësive vendore, *takime në grup dhe individuale* me këtë njësi.



Përkrah kësaj, statistika e të dhëna zyrtare për tregues të përgjithshëm të ekonomisë dhe shërbimeve publike në zonën e Malësisë së Madhe janë mbledhur nga burime kryesisht qendrore e rajonale, të cilat janë: Instituti i Statistikave të Shqipërisë, Ministria e Financave, Ministria e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit, Ministria e Bujqësisë, Ministria e Mjedisit, Qendra Kombëtare e Regjistrimit, Qarku Shkodër, Sektori i Statistikave pranë Drejtorisë Rajonale Bujqësore Shkodër, Enti Rregullator i Ujit dhe SH.A. Ujësjetës Kanalizime Malësi e Madhe.

***Dokumenta të politikave kombëtare dhe rajonale*** të zhvillimit strategjik konsultuar gjatë hartimit të analizës së gjendjes së zonës funksionale Malësi e Madhe janë:

Strategjia Kombëtare Ndërsektoriale për Zhvillimin Rural dhe Bujqësor 2014 – 2020

Draft Strategjia e Zhvillimit të Turizmit në Shqipëri 2014 – 2020

Projekti i Menaxhimit të Integruar të Ekosistemit të Liqenit të Shkodrës 2007

Enti Rregullator Ujit: Raporti i Performancës për SH.A Ujësjetës Kanalizime 2013

Plani i Menaxhimit për Rezervatin Natyror të menaxhuar të liqenit të Shkodrës Qershor 2012

Ngrijta e një bashkëpunimi ndërvendor mbi menaxhimin e mbetjeve në zonën e Malësisë së Madhe, Co-Plan 2013

***Faza e dytë*** e hartimit të PZF shtrihet në muajin mars – prill 2015 dhe përmban përgatitjen e një numri projekt idesh mbi investime të mundshme në njësinë e ardhshme vendore Malësi e Madhe, të cilat u derivuan nga gjetjet e analizës së saj, në bazë të nevojave dhe rekomandimeve të dhëna. Projekt idetë përqëndrohen në fushën e ekonomisë, të shërbimeve publike ndërsa një pjesë janë në mbështetje të fillimit të shpejtë të punës së administratës së re vendore. Një pjesë e këtyre projekt ideve u zhvilluan më në detaje, gjithsesi të përgjithshme, duke lënë hapësirë për shtim e plotësim të tyre në të ardhmen nga drejtuesit e njësisë së re.

Gjatë procesit të hartimit të PZF janë mbajtur katër forume diskutimi me përfaqësues të NJQV-ve dhe grupeve të interesit. Mendimet dhe sugjerimet nga forumet e zhvilluara janë reflektuar në dokumentin e PZF.

Forumi i parë u zhvillua me përfaqësues të gjashtë njësive vendore të zonës funksionale Malësi e Madhe, të cilët shprehën gatishmërinë për të bashkëpunuar mbi realizimin e Programit të Zonës Funksionale në Malësi të Madhe.

Me rëndësi për procesin ishte trajnimi i grupeve të punës së njësive vendore pjesëmarrëse në hartimin e PZF mbi mënyrën e plotësimit të pyetësorit, me qëllim mbledhjen e saktë dhe në kohë të të dhënave fillestare të nevojituara për analizën e zonës funksionale Malësi e Madhe

Forumi i dytë i PZF miratoi sektorët kyç të potencialit zhvillimor të zonës funksionale Malësi e Madhe, dhe një vizion zhvillimi për zonën si e tërë.



Forumi i tretë i PZF miratoi gjetjet përfundimtare lidhur me ekonominë dhe shërbimet publike, nevojat e nxjerra në pah dhe rekomandimet e dhëna.



Forumi i katërt i PZF miratoi projekt idetë e propozuara lidhur me ekonominë, shërbimet publike dhe fillimin e punës së administratës së re.

Statistikat dhe treguesit e përgjithshëm ekonomikë e demografike për zonën funksionale Malësi e Madhe, në pjesën më të madhe të tyre, bazohen në burimin zyrtar të INSTAT Census 2011, për të cilin mund të thuhet se ka shmangie nga gjendja reale në vitin 2014, por që reflekton një prirje të përgjithshme të statistikave dhe treguesve të afërt me prirjen reale.


## PJESA A: ANALIZA E ZONËS FUNKSIONALE

### 1. Përshkrim i përgjithshëm i zonës funksionale Malësi e Madhe

#### 1.1. Gjeografia

Malësia e Madhe shtrihet në pjesën më veri-perëndimore të vendit. Shkëmbinjtë gëlqerorë që mbizotërojnë këtu dhe reshjet e vogla i kanë përcaktuar kësaj krahine një fizionomi të thatë dhe të zhveshur. Në këtë hapësirë rrjedh lumi i Cemit, i cili buron nga Alpet Shqiptare dhe derdhet në Moraçë. Në pjesën e epërme ka një rrjedhë të shpejtë e të vrullshme, ndërsa lugina është e thellë dhe e ngushtë. Me të dalë në fushën e Cemit ai zgjeron shtratin e vet dhe fiton tiparet e lumit fushor me rrjedhje më të ngadalshme, me luginë të cekët dhe me shumë gjarpërime.

#### Harta 2: Krahina Malësi e Madhe



Krahina e Malësisë së Madhe është e mbrojtur prej erërave të ftohta të veriut nga kompleksi malor që e përshkon. Ajo është e hapur ndaj liqenit të Shkodrës dhe influenca e kësaj mase ujore ndikon në klimë më të butë, me verë të nxehtë dhe të thatë dhe dimër të butë e me reshje. Malësisë së Madhe ka një pozitë periferike dhe të izoluar, me sipërfaqe të kufizuar të tokave të punueshme, dhe ndahet në tri zona: zona bjeshkore, zona malore dhe zona fushore. Zonat bjeshkore janë: Kelmendi dhe disa zona të Shkrelit. Zonat malore janë: një pjesë e Kastratit dhe e Shkrelit. Zonat fushore janë: Koplíku, Gruemira e një pjesë e Kastratit.

## 1.2. Historia dhe kultura

Në të shkuarën ilire në Malësi jetonte fisi ilir Labeatët. Tokat malore të Malësisë së sotme quheshin “Malet e Labeateve”, fusha afër liqenit të Shkodrës është quajtur liqeni i Labeateve. Vendbanimet ilire më të njohura në Malësi janë: Meduni, Cinna te Kopluku, Balleza e Rrjollit etj.

Në kohët e lashta nëpër Malësi kalonin rrugë shumë të rëndësishme edhe për Europë, siç përmendim nga Norona nëpër Dinoshë-Tërgajë-Vermosh-Guci dhe Noronë-Dinoshë-Tuzë-Koplik-Shkodër.

Më parë Malësia e Madhe përbëhej nga zona të vogla territoriale të njohura me emrin male, në të cilat zhvillohej jeta fisnore. Ato ishin: Hoti, Kelmendi, Kastrati, Shkreli, Kopluku, Rranxat. Në krye të çdo mali ishte krye kreu, kurse çdo vëllazëri kishte kreun e vetë. Gjithashtu vepronin edhe pleqtë e maleve. Toponimi Malësi del nga fjala shqipe MAL-I me kuptim gjeografik dhe territorial.

Malësia mbante lidhje të mira dhe të ngushta me Venedikun. Gjatë pushtimit të Turqve ndarja më e hershme administrative njihej ndarja me tre njësi, **Nahije**. Më konkretisht: Nahija e Kelmendit, Nahija e Hotit dhe Nahija e Bregut të liqenit të Shkodrës.

Pas viteve 1550, si pasojë e rezistencës dhe kërkesave të malësorëve, qeveria turke bëri ndarje territoriale në bazë **Malesh**, pas vitit 1690 u bë ndarja territoriale në bazë **Bajraqesh**. Ndarja e fundit u organizua deri në vitin 1912.

Me Kongresin e Lushnjës (1920) Malësia u nda në pesë njësi vendore dhe u krijua për herë të parë N/Prefektura me qendër në Koplik. Njësitë vendore ishin: Komuna Kelmend, Komuna Kastrat me Hotin e mbetur nga shpëputja e vitit 1913, Komuna Shkrel, Komuna Gruemirë dhe Komuna Koplik.

Pas viteve 1944 Malësia e Madhe u la fillimisht N/Prefekturë me qendër në Koplik. Më vonë Kopluku u bë lokalitet. Pas krijimit të Kooperativave Bujqësore dhe ndërmarrjeve Bujqësore forma e organizimit u tjetërsua pasi e gjithë toka e objektet e pronat e tjera u shtetëzuan me pronarë vetëm shtetin. U krijuan: Kooperativa e Kelmendit, Kooperativa e Bajzës, Kooperativa e Koplikut, Kooperativa e Grizës dhe Kooperativa e Gruemirës.

Rreth viteve 1990 këto kooperativa u ndanë në më të vogla duke marrë formën e para viteve 1950-1960.

Aktualisht Malësia e Madhe ka 6 njësi vendore: një bashki dhe pesë komuna.

## 1.3. Prirjet demografike

### Të dhëna të përgjithshme sociale demografike

Qarku i Shkodrës ka 33 njësi administrative. Popullsia është 211,685 banorë. Qarku i Shkodrës gjithashtu ka pësuar rënie në numrin e popullsisë në krahasim me 2001 (-17%). Zonat urbane kanë pësuar zvogëlim me (-2.6%) ndërsa ato rurale një rënie me (-26%). Dendësia gjithashtu ka rënë (-17%).

Shpërndarja e popullsisë në Qarkun e Shkodrës sipas gjinisë është 49.8 % e meshkuj dhe 50.2 % femra. Popullsia në moshë pune përbën 65.9% të totalit të popullsisë së Qarkut.

Zona Funktionale Malësi e Madhe përbëhet nga komunat ekzistuese të Gruemirës, Kastratit, Kelmendit, Qendrës dhe Shkrelit si dhe nga Bashkia e Koplikut. Popullsia rezidente e Zonës sipas Censurit të Popullsisë 2011 është 30,823 banorë nga të cilët 88 % jetojnë në komunat ekzistuese dhe 12 përqind në territorin e Bashkisë Koplik. Popullsia e Malësisë së Madhe përbën 14.6 përqind të popullsisë së Qarkut.

## Varfëria

Sipas Anketës së Matjes të Nivelit të Jetesës 2012, niveli i varfërisë në Qarkun e Shkodrës është 3.7 % me ashpërsi 1.6 %. Treguesit e varfërisë së këtij qarku janë më të lartë se mesatarja kombëtare. Koeficienti GINI për Qarkun e Shkodrës është 28.2.

Duke marrë të mirëqenë se zhvillimi ekonomik i zonave skajore të qarkut është më i ulët se qendra e tij dhe në mungesë të shifrave të sakta të përlogaritura nga INSTAT në nivel bashkie e komune mund të arrijmë në konkluzionin se treguesit e varfërisë së ZF Malësi e Madhe (niveli, ashpërsia dhe koeficienti GINI) janë pritshmërisht më të dobët se mesatarja e qarkut.

Profili ekonomik i rajonit tregon se Qarku Shkodër pjesë e të cilit është edhe Zona Funktionale Malësi e Madhe ka një nga treguesit më të ulët të GDP për frymë në vend sipas të dhënave të vitit 2012 prej vetëm 2,327 euro, e barabartë me 70 % të mesatares në shkallë vendi. Vitet 2011 dhe 2012 kanë rregjistruar një ulje të GDP prej respektivisht – 1.7 % dhe - 2.7 %, simptoma të një ekonomie në tkurrje.

## Punësimi

Në tabelën më poshtë jepen të dhëna më të detajuara lidhur me forcën e punës dhe shpërndarjen e saj në territorin e zonës funksionale.

**Tabela 1: Niveli i punësimit në ZF Malësi e Madhe (%)**

Treguesit e punësimit	Koplik	Qendër	Gruemirë	Kelmend	Kastrat	Shkrel	ZF Malësi e Madhe	Mesatare vendi
Shkalla e papunësisë*	33,7	9,9	16,0	48,1	44,5	16,7	<b>26,91</b>	29,3
<i>femra</i>	40,1	14,4	13,8	50,0	53,5	15,1		31,4
<i>meshkuj</i>	30,5	8,2	16,8	47,2	40,90	17,6		27,9
<i>të rinj</i>	69,4	38,0	40,0	74,7	73,1	32,9		52,9

Burimi: INSTAT, Web Atlas, Census 2011, statistika për ZF MM është përlogaritur nga autori

\*forca punëtore 15-64 vjeç

## Shëndetësia

Në nivel qarku është 12,318 numri i personave me aftësi të kufizuar të moshës mbi 15 vjeç ose rreth 7.87 % e popullsisë. Ndërsa në Zonën Funksionale Malësi e Madhe numri i personave me të paktën një paaftësi është 2,770 ose 9 % e popullsisë.

**Tabela 2: Treguesit e paaftësisë në punë për ZF Malësi e Madhe**

Treguesit e popullsisë	Koplik	Qendër	Grue mirë	Kelmend	Kastrat	Shkrel	ZF Malësi e Madhe
Persona me të paktën një aftësi të kufizuar %	6,46	8,39	5,86	14,67	9,66	14,13	8,99
Persona me të paktën një aftësi të kufizuar numri	241	398	521	448	665	497	2,770

Burimi: INSTAT, Web Atlas, Census 2011

Qarku Shkodër ka dy spitale me 653 shtretër, njëri prej të cilëve, dhe më i afërti për ZF Malësi e Madhe, ndodhet në Koplik. Spitali është i vogël dhe nuk ofron shërbime të specializuara për të cilat banorët e Malësisë së Madhe duhet ti drejtohen spitalit rajonal të Shkodrës, spitaleve të Tiranës apo edhe spitaleve të vendeve të tjera.

Nga 119 qendra shëndetësore që ka Qarku, 27 prej tyre ndodhen në ZF Malësi e Madhe (6 qendra shëndetësore dhe 21 ambulanca) të shpërndara në të gjitha komunat e bashkitë.

Në Qarkun e Shkodrës kemi një numër total mjekësh prej 225 dhe nga këto 20 mjekë janë në Zonën Funksionale Malësi e Madhe. Edhe pse ka 15 % të popullsisë së Qarkut, Zona Funksionale Malësi e Madhe ka vetëm 9 % të numrit të mjekëve.

Numri i mjekëve në ZF është më i vogël se sa numri i qendrave shëndetësore dhe ambulancave gjë që tregon që disa prej tyre funksionojnë pa praninë e një mjeku. Raporti mjek/nr. banorësh i ZF është 1 mjek për 1541 banorë, rreth 1.6 herë më e ulët se mesatarja e Qarkut ku ky raport është 1 mjek për 940 banorë.

Distanca nga qendra më e afërt shëndetësore/mjeku më i afërt si në zonat urbane (bashki) ashtu edhe në zonat rurale është 18 minuta.

Gjatë muajve të dimrit bëhet i vështirë aksesimi në shërbimin shëndetësor për fshatrat e zonave malore të Komunës Kelmend si pasojë e bllokimit të rrugëve nga dëborat. Përmirësimi i cilësisë së rrugëve (ndërtimi i rrugës së re Tamarë – Vermosh) dhe përmirësimi i mirëmbajtjes mund të çojnë në garantim të aksesit në shërbimin parësor shëndetësor për zonat problematike.

## Popullsia dhe prirjet demografike

Popullsia rezidente totale e ZF Malësi e Madhe është 30,823 banorë. Numri i popullsisë ka pësuar një rënie të ndjeshme krahasuar me vitin 2001. Rënia prej 22.3% është ndjeshëm më e madhe sesa mesatarja e vendit prej rreth 9 %. Zonat me uljen më të ndjeshme të popullsisë janë ato të Kelmendit (35.5%) dhe Shkrelit (29.9%). E vetmja njësi ku popullsia është dyfishuar është Kopliku duke dhënë një indikacion të drejtimit të migrimit të brendshëm në zonë. Pjesa tjetër e popullsisë kanë migruar në qytete të tjera pranë burimeve të punësimit ose jashtë vendit.


**Tabela 3: Popullsia dhe tendencat e rritjes/zvogëlimit të ZF Malësi e Madhe**

Komuna / Bashkia	Popullsia Census 2001	Popullsia Census 2011	Njësitë Ekonomike Familjare 2011	Sipërfaqja km <sup>2</sup>	Dendësia e popullsisë Census 2001	Dendësia e popullsisë Census 2011	Ndryshimi Popullsisë % 2001 - 2011
<i>Gruemirë</i>	9816	8890	2115	104	94,4	85,5	-9,2
<i>Kastrat</i>	8748	6883	1558	144,5	60,5	47,6	-18,6
<i>Kelmend</i>	6608	3056	747	375,7	17,6	8,1	-35,5
<i>Koplik</i>	1790	3734	917	13,1	136,5	284,7	109,1
<i>Qendër</i>	6202	4740	1160	49,5	125,4	95,8	-14,6
<i>Shkrel</i>	6509	3520	999	262,4	24,8	13,4	-29,9
<b>ZF Malësi e Madhe</b>	<b>39673</b>	<b>30823</b>	<b>7496</b>	<b>949,2</b>	<b>41,8</b>	<b>32,5</b>	<b>-22,3</b>

Burimi: INSTAT, Web Atlas, Census 2011

Tendecat e rritjes apo zvogëlimit të popullsisë në njësitë përbërëse të ZF Malësi e Madhe tregohen në grafikun më poshtë.

**Grafiku 1: Ndryshimi i popullsisë ZF Malësi e Madhe gjatë viteve 2001 deri 2011**



Burimi: INSTAT, Web Atlas, Census 2011

Gjatë periudhës së tranzicionit ndryshimet demografike në Malësinë e Madhe kanë qënë relativisht të larta. Malësia e Madhe është ndër zonat që kanë humbur popullsi si pasojë e lëvizjeve të brendshme migratore pas vitit 1990. Faktorët kryesorë që kontribuojnë në këto zhvillime demografike janë të lidhura më tranzicionin ekonomik: mbylljen e shumë ndërmarrjeve në pronësi shtetërore dhe papunësisë që e shoqëroi, infrastrukturën jashtëzakonisht të dobët të transportit dhe të komunikimit, terrenit në përgjithësi të vështirë, kushteve të papavorshme klimatike dhe bujqësore, si dhe shfrytëzimit pa kriter të pyjeve.

Ka shumë fshatra në zonat malore që po braktisen nga popullsia dhe po dynden drejt zonave të tjera pasi kushtet e jetesës për ta janë shumë të vështira apo cilesia e shërbimeve që u ofrohen është e ulët. Shumë nga banorët e zonave malore rreth e rrotull kanë zbritur të jetojnë në ultësirën e liqenit të Shkodrës ku ka një përqendrim të madh të popullsisë. Mjaft prej tyre janë përqendruar në Bashkinë Koplík, Komunën Rrethina dhe Komunën Gruemirë, por ka që kanë lëvizur drejt Shkodrës apo Tiranës. E vështirë të gjenden shifra të sakta për këto lëvizje populsië.

Vlen të përmendet se një numër i konsiderueshëm i të rinjve kanë emigruar jashtë vendit kryesisht drejt Britanisë dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Me bashkimin në një NJQV të vetme synohet të shkohet drejt një rritjeje ekonomike të qëndrueshme e cila do reflektohet në rritjen e punësimit, si rrjedhim reduktimin e lëvizjeve demografike dhe rritjen e nivelit të jetesës.

### Struktura e popullsisë

Një paraqitje e strukturës së popullsisë për sejcilën njësi përbërëse të ZF Malësi e Madhe jepet në Tabelën më poshtë.

**Tabela 4: Struktura e popullsisë e njësive vendore të ZF Malësi e Madhe**


Njësia Vendore	Popullsia 0-14 vjeç	Popullsia 15-64	Popullsia mbi 65 vjeç
<i>Gruemirë</i>	2060	5709	1121
<i>Kastrat</i>	1417	4439	1027
<i>Kelmend</i>	602	1992	462
<i>Koplík</i>	838	2456	440
<i>Qendër</i>	1021	3023	696
<i>Shkrel</i>	752	2270	498
<b>ZF MALËSI E MADHE</b>	<b>6690</b>	<b>19889</b>	<b>4244</b>

Burimi: INSTAT, Web Atlas, Census 2011

Në mënyrë të agreguar paraqiten të dhënat e strukturës së popullsisë për ZF Malësi e Madhe në Grafikon 2 më poshtë.



**Grafiku 2: Struktura e popullsisë ZF Malësi e Madhe**



Burimi: INSTAT, Web Atlas, Census 2011

## Arsimi dhe Kultura

### Arsimi

Tabela në vijim tregon nivelin e arsimimit të popullsisë në njësitë përbërëse dhe Zonën Funktionale të krahasuar me mesataren e vendit. Zona karakterizohet nga një përqindje e lartë e popullsisë me arsim 8 dhe 9 vjeçar ndërsa relativisht të ulët përsa i takon arsimimit të mesëm dhe atij të lartë.


**Tabela 5: Niveli i arsimimit të popullsisë në ZF Malësi e Madhe**

Niveli arsimor (% ndaj popullsisë 15 vjeç e lart)	ZF Malësi e Madhe						Mesatare vendi
	Koplik	Qendër	Gruemirë	Kelmend	Kastrat	Shkrel	
<i>8 ose 9 vjeçar i mesëm i lartë</i>	49,59	70,93	71,26	74,08	67,97	76,88	68,79
	35,2	20,5	20,1	14,6	21,9	15,1	21,25
	11,8	4,7	3,4	1,7	3,6	2,6	4,39
Shkalla e analfabetizmit (% ndaj popullsisë 10 vjeç e lart)	2,2	2,3	3,2	7,3	4,1	4,0	2,8

Burimi: INSTAT, Web Atlas, Census 2011

Grafiku në vijim ilustron nivelin e arsimimit të popullsisë së ZF Malësia e MA dhe krahasur me mesataren e vendit në të tre nivelet e arsimimit.

**Grafiku 3: Niveli i arsimimit në ZF Malësi e Madhe krahasuar me mesataren e vendit**



Burimi: INSTAT, Web Atlas, Census 2011

Po të vëmë re shpërndarjen e shkollave të sistemit parauniversitar për shkollat 9-vjeçare, shohim së Bashkia Koplík ka vetëm 1 shkollë 9-vjeçare për një popullsi prej 3,734 banorë, ndërsa Komuna Gruemirë ka të stacionuara në territorin e saj 14 shkolla 9-vjeçare për një popullsi prej 8,890 banorë. Komuna Kelmend më një popullsi prej 3,056 banorë, pra më të vogël se Bashkia Koplík, ka 11 shkolla 9-vjeçare, ndërkohë që bashkia Koplík ka 1 të tillë. Njësia e re vendore do të ketë 50 shkolla 9-vjeçare për 30,823 banorë duke synuar një shpërndarje më të mirë të infrastrukturës shkollore për të gjithë nxënësit, gjë e cila nuk garantohet në sistemin e fragmentuar të qeverisjes vendore.

E njëjtë situatë paraqitet për shkollat e mesme, ndërsa Bashkia Koplík ka 1 shkollë të mesme, Komuna Kastrat ka 2 të tilla, ndërsa komuna Qënder nuk ka fare shkolla të mesme.

Zona funksionale Malësi e Madhe do të ketë 37 kopshte dhe 27 qendra shëndetësore e ambulanca duke shtuar aksesin e të gjithë banorëve të zonës në to, e duke mos u limituar vetëm në territorin e njësisë vendore ku ato janë aktualisht si pasojë e sistemit të fragmentuar.

Tabela 6 më poshtë tregon qartë mungesën e aksesit social-kulturor-sportiv pothuajse në të gjithë Malësinë e Madhe. Shumë komuna madje edhe bashkia kanë tregues 0 për sa i përket qendrave sociale, qendrave kulturore dhe terreneve sportive të cilat edhe pse ekzistojnë si të tilla në disa komuna, nuk janë funksionale për shkak të mungesës së infrastrukturës dhe personelit.

**Tabela 6: Shkolla, kopshte dhe qendra sociale, kulturore e sportive të ZF Malësi e Madhe**

Njësitë e Qeverisjes Vendore (2012)	Shkolla të mesme	Shkolla 9-vjeçare	Kopshte	Qendra Kulturore	Qendra Sociale	Terrene Sportive
<i>Bashkia Koplik</i>	1	1	2	1	0	0
<i>Komuna Gruemirë</i>	1	14	14	0	0	0
<i>Komuna Kastrat</i>	2	9	8	0	0	1
<i>Komuna Kelmend</i>	1	11	1	1	0	1
<i>Komuna Qendër</i>	0	7	7	0	0	0
<i>Komuna Shkrel</i>	1	8	5	1	0	1
<b>ZF Malësi e Madhe</b>	<b>6</b>	<b>50</b>	<b>37</b>	<b>3</b>	<b>0</b>	<b>3</b>

Burimi: Qarku Shkodër

#### 1.4. Tiparet e zonës funksionale

Zona funksionale Malësi e Madhe përmbledh në vehte të njëjtën hapësirë territoriale të Rrethit të Malësisë së Madhe. Ajo karakterizohet si një zonë koncentrike funksionale, me qendër të vetme kyçe Bashkinë Koplik. Ndërveprimet mes banorëve, përcaktuese të funksionalitetit të kësaj zone, janë për qëllime konsumi dhe marrje të shërbimeve.

Lëvizja e banorëve brenda për brenda zonës për qëllime të ndryshme është krahasimisht e kufizuar, duke marrë parasysh relievin malor deri alpin në pjesën veriore të saj; gjendja përkeqësohet gjatë stitës së dimrit për arsye të motit të ftohtë. Rrjeti rrugor është ende i pamjaftueshëm për një ndërlidhje të shpeshtë me fshatrat e thellë.

Në nivel administrativ, njësitë vendore janë më shumë të lidhura përmes shërbimit të ujësjellësit i cili jepet për thujse

të gjithë Rrethin.

Ndërveprimet ekonomike e shoqërore ndërkufitare nuk janë të dendura; ato përqëndrohen tipikisht në pjesën më veriore të Komunës Kelmend, pjesërisht në Shkrel, dhe, gjithashtu, në qendrën Bajzë të Komunës Kastrat, e cila ka lidhje të vazhdueshme me Malin e Zi përmes linjës hekurudhore Bajzë-Tuz.

Analiza e zonës funksionale veçon dhe dy nën-zona brenda saj të cilat mund të jenë të vlefshme si pika referimi të zhvillimeve dhe zgjerimeve në të ardhmen:

*territori ndërmjet Komunës Kelmend dhe qendrave Plavë e Guci të Malit të Zi*  
*territori ndërmjet Komunës Kastrat, Kelmend e qendrës Tuz në Malin e Zi*

Klasifikimi i ri vendit në zona urbane dhe rurale nga INSTAT, cilëson krejtësisht rurale popullsinë në të gjitha njësitë vendore përbërëse të Malësisë së Madhe – me përjashtim të vetëm 6 % të popullsisë së Komunës Gruemirë.

## 2. Ekonomia e zonës funksionale Malësi e Madhe

### 2.1. Karakteristika të ekonomisë së zonës funksionale

#### 2.1.1. Të dhëna të përgjithshme ekonomike

Treguesit e nivelit të përgjithshëm të ekonomisë në vend gjenden, deri më sot, të agreguar në nivel qarku – sipas ndarjes administrative të deritanishme të vendit. Kështu, në vitin 2012, nga të dhënat e INSTAT<sup>1</sup>, **PBB** e Qarkut Shkodër përbën 5.4 % të PBB në nivel kombëtar, duke treguar një nivel të përafërt zhvillimi ekonomik me Qarkun Korçë e Vlorë, ndërsa nivelet më të larta mbas Tiranës arrijnë në 12.9 % (Qarku Fier), 9.9 % (Qarku Durrës), 7.9 % (Qarku Elbasan) dhe nivelet më të ulta, në rreth 2 % (Qarku Gjirokastrë dhe Kukës).

Gjithashtu, për vitin 2012, niveli i **PBB për frymë** në Qarkun Shkodër është 70 % e nivelit kombëtar, ndër më të ultët në vend, që e vendos mes Korçës, Kukësit e Lezhës, ndërsa nivelet më të larta të treguesit mbas Tiranës arrijnë në 113 % (Qarku Fier) dhe 104.5 % (Qarku Durrës).

Struktura e Produktit të Brendshëm Bruto të Qarkut Shkodër, në bazë të **Vlerës së Shtuar Bruto në çdo sektor të ekonomisë** së Qarkut, shfaqet për vitin 2012 si më poshtë:

- *sektori i shërbimeve* të tregtisë, hoteleve e restoranteve, transportit, postë dhe telekomunikacionit e të tjera krijon 44.1 % të VSHB-së, që është nën mesataren e sektorit në shkallë vendi 51.6%
- *bujqësia dhe peshkimi* krijojnë 33.9 % të VSHB-së, që është mbi mesataren e sektorit në shkallë vendi 21.8 %;
- *industria* nxjerrëse dhe përpunuese krijon 12.2 % të VSHB-së, nën mesataren e sektorit në shkallë vendi 14.4 %;
- *ndërtimi* krijon pjesën e mbetur prej 9.8 % të VSHB-së, përsëri nën mesataren e sektorit në shkallë vendi 12.2 %;

Në përfundim për Qarkun Shkodër, gjatë periudhës 2008-2012, me gjithë luhatjet ndër vite të peshave të vlerës së shtuar bruto të këtyre sektorëve të ekonomisë, raportet ndërmjet tyre kanë qënë të qëndrueshme; sektorë primarë për këtë periudhë veçohen shërbimet dhe bujqësia e peshkimi.

---

<sup>1</sup> INSTAT, Llogaritë Rajonale në Shqipëri, 2012

Në zonën funksionale Malësi e Madhe veprojnë aktualisht rreth 1095 biznese, nisur nga të dhënat e Qendrës Kombëtare të Regjistrimit në Nëntor 2014. Ato janë kryesisht biznese të vogla, të përqëndruar më shumë në Bashkinë Koplík, dhe gjithashtu në Komunat Kastrat e Gruemirë. Shpërndarja e tyre sipas llojit të veprimtarisë për secilën njësi vendore jepet në tabelën më poshtë:

**Tabela 7: Bizneset aktive në ZF Malësi e Madhe, deri 27.11.2014**

Bashkia/ Komuna	Bujqësia, gjuetia dhe silvikultura	Peshkim	Industria nxjerrëse	Industria përpunuese	Ndërtim	Hotele, Restorante	Transporti dhe telekomunikacioni	Tregtia, të tjera	Pasuritë e patundshme, të tjera	Shërbime kolektive, shoqërore e personale	Gjithsej
Koplík	9	22	0	24	24	114	67	266	15	19	<b>572</b>
Qendër	1	23	0	0	0	1	10	4	0	0	<b>40</b>
Kastrat	10	5	0	6	8	24	33	86	2	6	<b>186</b>
Gruemirë	4	31	0	11	10	26	31	47	2	1	<b>169</b>
Kelmend	1	4	0	2	1	4	17	8	3	1	<b>43</b>
Shkrel	11	0	4	1	3	11	31	21	0	0	<b>85</b>
<b>ZF Malësi e Madhe</b>	<b>36</b>	<b>85</b>	<b>4</b>	<b>44</b>	<b>46</b>	<b>180</b>	<b>189</b>	<b>432</b>	<b>22</b>	<b>27</b>	<b>1,095</b>

Burimi: Qendra Kombëtare e Regjistrimit, Tiranë

Vihet re se pjesa më e madhe e bizneseve të zonës është e përqëndruar në fushën e shërbimeve, veçanërisht në tregti, hoteleri dhe restorante si dhe transport e telekomunikacion. Në vijim, në tabelën e mëposhtme renditen aktivitetet ekonomike më kryesore të secilës njësi vendore së bashku me sektorin ku veprojnë dhe numrin e të punësuarve. Baza e të dhënave është viti 2012<sup>2</sup>, ndërsa është pasuruar me të dhëna të vitit 2014 nga Drejtoria e Bujqësisë së Rrethit Malësi e Madhe.

Në nivel të Zonës Funksionale, aktivitetet ekonomike bujqësore, të shërbimeve dhe të tregtisë janë punëdhënësit më të mëdhenj në Malësinë e Madhe, gjithashtu dhe bizneset e ndërtimit.

Katër bizneset e grumbullimit të bimëve mjeksore - që veprojnë në Koplík, Bajzë, Qendër dhe Gruemirë - janë pjesë e rëndësishme e aktivitetit tërësor të bimëve mjeksore në zonë, një nga aktivitetet më fitimprurëse në sektorin bujqësor, i cili nis me kultivimin nga fermerët dhe i drejtohet veçanërisht tregut të jashtëm.

<sup>2</sup> DLDP, 2012: Report for the second delineation of the functional areas


**Tabela 8: Punëdhënësit kryesorë në ZF Malësi e Madhe, 2014**

Bashkia/Komuna	Biznese	Sektori	Të punësuar
Koplik	Bajraktari IMPEX	Shërbime	25
	ReLikaj sh.p.k	Bujqësi - bimë mjeksore	25
	Curri sh.p.k.	Ndërtim	20
	Canaj	Tregti	15
	Mela sh.p.k.	Ndërtim	10
Shkrel	Kooperativa Reç	Bujqësi / Blegtori	70
	Rrogu gust	Ndërtim	60
	Sterkaj	Ndërtim	50
	Kantina Relikaj	Bujqësi - vreshtari	30
	Alpin	Prodhim uji	15
Kelmend	Kolë Gjoni	Prodhim energjie	4
	Sebastian Pjetri	Prodhim energjie	4
	Miki konstruksion	Ndërtim	3
	V.I.S.	Turizëm	3
	Gjergj Hysaj	Peshkim	2
	Gjeto Pepaj	Peshkim	2
Gruemirë	Canaj sh.p.k.	Tregti	15
	Kujtim Kekaj	Bujqësi - bimë mjeksore	n.a
	Hapje sh.p.k.	Ndërtim	10
	Dukaj sh.p.k.	Ndërtim	8
	Boka sh.p.k.	Prodhim uji	7
	2 Luanët	Shërbime - Restorant	6
Kastrat	Muçaj sh.p.k	Bujqësi - bimë mjeksore	n.a
	Stacioni i Trenit Bajzë	Transport	n.a
Qendër	Zagora sh.p.k	Bujqësi - bimë mjeksore	n.a

Burimi: DLDP dhe Drejtoria e Bujqësisë, Rrethi Malësi e Madhe

Një këndvështrim dinamik i aktivitetit ekonomik të zonës funksionale jepet përmes bizneseve të reja të regjistruara në QKR gjatë periudhës Shtator 2009 - Nëntor 2014, së bashku me sektorin përkatës ku synojnë të zhvillojnë veprimtarinë e tyre. Kështu, në Koplik është përqëndruar numri më i madh i bizneseve të krijuara në këtë periudhë, dhe në Kelmend numri më i vogël. *Peshkimi* është ndër aktivitetet e reja më të përzgjedhura nga sipërmarrësit, i përhapur thuajse në masë të njëjtë në këtë periudhë në Koplik, Qendër e Gruemirë, njësi këto të cilat janë kanë dalje në Liqenin e Shkodrës. Bizneset në sektorin e *shërbimeve* të transportit e telekomunikacionit kanë gjithashtu rritje përafërsisht të njëtrajtshme në zonën funksionale, ndërsa në shërbime hotelerie e restorante, vërehen një shtrirje më e madhe e aktiviteteve të reja në Koplik. *Tregtia* është sektori i zgjeruar më shumë në periudhën 2009-2014, i përqëndruar ndjeshëm në Koplik në krahasim me komunat përreth.


**Grafiku 4: Bizneset e reja në ZF Malësi e Madhe, të regjistruara nga 05.09.2007 deri 27.11.2014**



Burimi: Qendra Kombëtare e Regjistrimit

Investimet e kryera nga njësitë vendore në vitin 2014 kanë objekt kryesisht infrastrukturën rrugore, shtrim e asfaltim apo përmirësim të segmenteve rrugore që lidhin komunat me njëra tjetrën. Në disa raste dhe rindërtim të ndërtesave publike; investimet e qeverisë vendore për frymë kanë qënë veçanërisht të larta në Komunën Kelmend, të cilat pasqyrojnë punimet mbi rrugën lidhëse deri në Tamarë, dhe që pritet të vazhdojnë edhe me tej. Në grafikun e mëposhtëm paraqiten investimet për frymë të njësive vendore në vitin 2014 si dhe mesatarisht për zonën funksionale.

**Grafiku 5: Investime për frymë kryer nga NJQV-të e ZF Malësi e Madhe gjatë vitit 2014**



Burimi: Njësitë e qeverisjes vendore të ZF Malësi e Madhe

Në tre vitet e fundit, investimet e njësive vendore kanë qënë në rritje të ndjeshme, me përjashtim të Bashkisë Koplík.

**Tabela 9: Pesha e investimeve ndaj të ardhurave të njësive vendore të ZF Malësi e Madhe**

Njësia vendore	Pesha e <i>investimeve</i> ndaj të ardhurave gjithsej		
	2012	2013	2014
Koplík	20.25%	n.a	12.45%
Qendër	4.40%	12.60	26.68
Kelmend	12.39%	26.71	39.36
Kastrat	21.80%	14.88	25.48
Gruemirë	24.52%	35.67	37.57
Shkrelë	39.17%	n.a	n.a
<b>ZF Malësi e Madhe</b>	<b>18.98%</b>		

Burimi: Ministria e Financave, Njësitë e Qeverisjes Vendore

Zona funksionale Malësi e Madhe ka dy pika kufitare: Vermosh dhe Hani i Hotit. Pika kufitare dhe doganore e Hanit të Hotit, me vendndodhje 7 km nga qendra e Komunës Kastrat, Bajzë, është e rëndësishme për ndërlidhjen e njerëzve dhe mallrave me vendin fqinjë të Malit të Zi.



### *Parku industrial Koplík*

Në janar të vitit 2008, me vendim të Këshillit të Ministrave, në Bashkinë Koplík u shpall Zonë Ekonomike me statusin “Park Industrial” një zonë me sipërfaqje 61 ha, në të cilën parashikohen të kryhen veprimtari:

- *prodhuese, industriale e agropërpunimi*
- *tregtare*
- *eksport-importi*
- *ndihmëse*

Investimi fillestar i kërkuar për ngritjen e Parkut është rreth 18,510,000 EUR, dhe parashikohet të hapë rreth 16,700 vende punë. Periudha e funksionimit të tij është 35 vjet.

Ministria e Ekonomisë Tregtisë dhe Energjitikës është ngarkuar me zbatimin e vendimit<sup>3</sup> për zhvillimin e Parkut Industrial Koplík. Që prej vitit 2008 deri më sot, investimi në zonën prej 61 ha nuk ka nisur ende, ndërsa ecuria e punës për zbatimin e vendimit ka ndalur.

### *Stacioni hekurudhor Bajzë*

Stacioni hekurudhor i Bajzës (Komuna Kastrat) është pjesë e Sh.a. Hekurudha Shqiptare. Ai është ndërlidhës i shkëmbimeve tregtare të vendit me Malin e Zi, përmes transportit të mallrave Tuz (Mal i Zi) – Bajzë, dhe është e vetmja linjë hekurudhore që lidh vendin me Malin e Zi. Mallrat e transportuara janë në pjesën më të madhe importe të vendit, dhe vetëm një përqindje e papërfillshme janë eksporte. Mallrat që hyjnë transportohen më pas në qytetet e ndryshme të vendit sipas destinacionit përfundimtar.

Kryesisht përmes Stacionit të Bajzës hyjnë:

- *Skrap hekur* - për në Elbasan
- *Plastmas* - për në Tiranë
- *Lëndë drusore* - për në Vlorë, Fier, Tiranë, Durrës etj.
- *Qymyr* - për në Elbasan
- *Laminat* - për në Shkodër, Tiranë etj.
- *Gips* - për në Tiranë
- *Lëngje frutash* - për në Tiranë, Vlorë, Durrës etj.

Deri në 2-3 vite më parë, përmes këtij stacioni kanë hyrë mesatarisht 1 ton mall në ditë dhe deri 400.000 ton mall në vit, me një vlerë të ardhurash transporti deri në 2,000,000 EUR. Sot, veprimtaria e stacionit është më shumë së përgjysmuar. Kjo rënie ka ardhur kryesisht si pasojë e konkurrencës nga transporti rrugor, i cili është më i shpejtë, shmang vonesa të ngarkimit të mallit si dhe të kalimeve doganore.

---

<sup>3</sup> VKM 12 datë 04.01.2008, Për Shpalljen e Zonës Ekonomike në Koplík, Shkodër

Nisur nga pozicioni i saj strategjik, kjo linjë hekurudhore mund të shërbejë si pikë alternative hyrëse për turistët e zonës së Malësisë së Madhe, dhe veçanërisht të Alpeve në veri. Kjo mbetet një mundësi për t'u vlerësuar me kujdes në të ardhmen nga analistë të fushës.

### 2.1.2. Tregu i punës

Të dhëna të drejtpërdrejta statistikore për nivelin e tanishëm të papunësisë në zonën funksionale Malësi e Madhe mungojnë; në Zyrën e Punës Shkodër janë 2593 të papunë të regjistruar deri në Dhjetor 2013, të cilët përbëjnë 57 % të forcës punëtore të zonës<sup>4</sup>. Këto të dhëna nuk janë të plota duke pasur parasysh se njerëzit nuk regjistrohen rëndom në Zyrën e Punës. Në këto kushte, një pamje më e qartë e tregut të punës së zonës na vjen përmes statistikave mbi punësimin.

Tabela në vazhdim paraqet burimin kryesor të të ardhurave në njësitë vendore të zonës funksionale, sipas Census-it të muajit tetor 2011: puna e paguar apo vetëpunësimi është burimi kryesor i të ardhurave për familjet në Koplik, Qendër, Shkrel dhe Gruemirë. Vërehet se në Komunën Kelmend ndihma sociale është burimi kryesor i të ardhurave, ndërsa në Komunën Kastrat, format e ndryshme të pensioneve.

Nga ana tjetër, duke grupuar të tre burimet e të ardhurave familjare që nuk janë nga puna - pensionet, ndihma sociale dhe remitancat - niveli i papunësisë mund të përafrohet në rreth 50 % ose më shumë në të gjitha njësitë vendore, me përjashtim të Komunës Qendër, ku niveli duket të jetë më i ulët.

**Tabela 10: Burimi i të ardhurave të njësisë ekonomike familjare në ZF Malësi e Madhe (%)**

Burimi i të ardhurave Census 2011	Koplik	Qendër	Gruemirë	Kelmend	Kastrat	Shkrel	ZF Malësi e Madhe
<i>punë e paguar ose vetëpunësim</i>	46,35	62,41	55,43	25,70	29,83	45,80	45.8
<i>të gjitha llojet e pensioneve</i>	32,82	32,24	32,14	42,03	39,81	34,91	35.2
<i>ndihmë sociale</i>	30,75	8,79	6,52	57,16	17,51	45,09	33.4
<i>remitanca</i>	12,10	21,21	13,94	13,25	11,27	18,46	14.8

Burimi: INSTAT, Web Atlas; statistika për ZF MM është përlogaritur nga autori

Punësimi sipas sektorëve të ekonomisë shfaqet i ndryshëm ndër njësitë vendore të zonës funksionale: në Qendër, Gruemirë, Shkrel e Kelmend mbi 50 % e të punësuarve përqëndrohen në bujqësi, në një nivel ndjeshëm mbi mesataren prej 26.1 % në shkallë vendi. Në të kundërt, në Kastrat e Koplik mbi 60 % e të punësuarve punojnë në industrinë nxjerrëse e përpunuese. Sektori i shërbimeve mbetet një burim i rëndësishëm i punësimit në zonë.

Vlen të veçohet se, në Koplik, pjesa e të punësuarve në bujqësi është ndjeshëm më e ulët se mesatarja kombëtare, ndërsa për Komunën Kelmend dhe Shkrel, punësimi në industri është në

<sup>4</sup> Forca e punës është përfutur duke mbledhur numrin e të punësuarëve dhe të papunëve në Rrethin Malësi e Madhe, për këtë arsye kjo peshë mbetet vetëm një përaftrim.


nivele minimale, çka pasqyron tiparet gjeografike dhe ekonomike të ndryshme të këtyre dy njësisve vendore në krahasim me të tjerat.

**Tabela 11: Punësimi në ZF Malësi e Madhe sipas degëve të ekonomisë (%)**

Punësimi sipas degëve të ekonomisë	Koplik	Qendër	Gruemirë	Kelmend	Kastrat	Shkrel	ZF Malësi e Madhe	Mesatare vendi
<i>bujqësi</i>	14,8	51,9	56,6	56,2	26,6	72,6	45.8	26.1
<i>industri</i>	15,8	13,0	13,1	6,5	12,9	3,9	11.7	20.4
<i>shërbime</i>	69,46	35,11	30,22	37,31	60,45	23,57	42.5	53.5

Burimi: INSTAT, Web Atlas, statistika për ZF MM është përlogaritur nga autori

**Harta 3: Punësimi sipas degëve të ekonomisë në njësitë vendore të ZF Malësi e Madhe**



Burimi i hartës: Autori

Në zonën funksionale të Malësisë së Madhe, pjesa më e madhe e popullsisë mbi moshën 15 vjeç ka përfunduar vetëm arsimin e detyruar 8/9 vjeçar; me përjashtim në Koplik, në njësitë e tjera vendore kjo pjesë është ndjeshëm mbi mesataren e vendit prej 52.1 %.

Në të kundërt, pjesa më e vogël e popullsisë mbi moshën 15 vjeç ka përfunduar arsimin e lartë, me përqindjen më të lartë në Koplik, 11.8%, e cila përputhet me mesataren në shkallë vendi.

Në Malësi të Madhe ka vetëm shkolla të mesme të përgjithshme. Mundësinë më të afërt për arsim të mesëm profesional nxënësit e zonës e kanë në Shkodër, përkatësisht në fushën e pyjeve, teknologjisë, veterinerisë, gjuhëve të huaja dhe artit.

Popullsia mbi moshën 15 vjeç me nivelin më ulët arsimor është më shumë e punësuar në Shkrel, 71.6 % e tyre, dhe në Kelmend, 63.5%, shumë më tepër se mesatarisht në vend; vetëm në Koplik ata janë grupi më i vogël i të punësuarve. Pjesa më e arsimuar gjen punësim më shumë në Koplik krahasuar me njësitë e tjera fqinje, 30.1 %, e cila është mbi mesataren në shkallë vendi prej 23 % të popullsisë.

**Tabela 12: Punësimi në ZF Malësi e Madhe sipas nivelit arsimor (%)**

Punësimi sipas nivelit arsimor	Koplik	Qendër	Gruemirë	Kelmend	Kastrat	Shkrel	ZF Malësi e Madhe	Mesatare vendi
<i>8 ose 9 vjeçar</i>	24,72	59,45	59,11	63,47	49,17	71,57	54.6	38.1
<i>i mesëm e profesional</i>	44,89	30,56	31,62	29,02	35,49	20,32	32.4	38
<i>universitar</i>	30,1	9,7	8,6	6,5	14,4	6,7	12.3	23

Burimi: INSTAT, Web Atlas, statistika për ZF MM është përlogaritur nga autori

Bazuar sërish në të dhënat e Zyrës së Punës Shkodër, mund të përftohet një vështrim mbi papunësinë në Rrethin e Malësisë së Madhe (që përputhet me zonën funksionale) me të dhëna të 6 - mujorit të parë të vitit 2012, në varësi të faktorëve moshë dhe nivel arsimor.

Mbi këtë bazë, vërehet se numri më i lartë i të papunëve të cilët kërkojnë punë në Zyrat e Punës Shkodër, janë të moshës 30 deri 44 vjeç, por edhe 45 deri 50, ndërsa janë më pak të rinjtë dhe forca punëtore mbi moshën 50 vjeç.

**Tabela 13: Papunësia në ZF Malësi e Madhe sipas grup-moshave**

Papunësia 2012 (6-mujori I)	Sipas grup-moshave %							
	15 - 19	20 - 24	25 - 29	30 - 34	35 - 39	40 - 44	45 - 50	mbi 50
Malësi e Madhe	5.2	6.9	14.2	16.1	18	16	13.8	9.6

Burimi: Qarku Shkodër

Lidhur me nivelin arsimor, papunësia në Malësinë e Madhe prek shumë më pak forcën e specializuar punëtore dhe është e lartë ndër popullsinë me arsim të ulët ose të paspecializuar.

**Tabela 14: Papunësia në ZF Malësi e Madhe sipas nivelit arsimor**

Papunësia 2012 (6-mujori I)	Sipas nivelit arsimor %					
	më pak se fillor	fillor	9 vjeçar	i mesëm i përgjithshëm	i mesëm profesional	i lartë
Malësi e Madhe	1.2	22	40	27	8.5	1.7

Burimi: Qarku Shkodër

## 2.2. Ndërveprimet ekonomike të zonës funksionale


Ndërveprimet përcaktuese mes banorëve të zonës funksionale të Malësisë së Madhe janë *konsumi dhe marrja e shërbimeve* - kryesisht të punësimit, shkollimit dhe shëndetësisë. Hartat e mëposhtme, pjesë të studimit të hollësishëm të zonave funksionale të ndërmarrë në kuadër të propozimit për ndarjen e re administrative e territoriale të vendit, përshkruajnë drejtimit e ndërveprimeve dhe dendësitë e tyre.

**Qendra tregtare (konsumi)** më e rëndësishme e zonës funksionale të Malësisë së Madhe është Bashkia Koplík, ku janë të përqëndruar numri më i madh i bizneseve e i njësive të shërbimit, ku drejtohen banorët e komunave fqinjë; ndërveprimin më të dendur e kanë Komunitat Kastrat, Shkrel, Qendër e Gruemirë.

Shkodra përbën gjithashtu një treg kyç edhe për vetë Bashkinë Koplík dhe disa nga Komunitat përreth, të cilat ndërveprojnë me thujse të njëjtën dendësi.

Veçohet Komuna Kelmend për ndërveprimin e saj tregtar (më pak të dendur) me zonën ndërkufitare të Plavës e Gucisë përmes pikës kufitare Vermosh.


#### Harta 4: Ndërveprimi për konsum në ZF Malësi e Madhe



Burimi: DLDP (2014), Studim rreth zonave funksionale në Shqipëri

Në tregun e Koplikut dhe Shkodrës banorët e Malësisë së Madhe drejtohen kryesisht për mallra shumice, veshje apo mobilie e pajise shtëpiake; për produktet ushqimore të përditshme, mund të thuhet se qendrat e komunave dhe fshatrat janë përgjithësisht të vetëmjaftueshëm. Pikërisht dhe për këtë arsye, kërkesa për prodhimet bujqësore e blegtorale brenda për brenda Malësisë së Madhe nuk është e lartë, e për rrjedhojë, fermerët gjejnë treg të rëndësishëm vetëm në Shkodër. Nga ana tjetër, për fshatrat më të thellë ndërveprimi me Shkodrën është më e vështirë për shkak të rrugëve të pashtuara.

## Harta 5: Ndërveprimi për punësim në ZF Malësi e Madhe




Burimi: DLDP (2014), Studim rreth zonave funksionale në Shqipëri

**Qendrat kryesore të punësimit (shërbimet)** brenda zonës funksionale janë Bashkia Koplík dhe Komuna Kastrat. Shkodra mbetet sërish një qendër punësimi e rëndësishme përmes aktiviteteve të prodhimit të këpucëve e veshjeve në zonën industriale të veri të qytetit, ku drejtohen veçanërisht banorë nga Bashkia Koplík dhe Komuna Gruemirë, siç është e cilësuar në hartën më sipër.

Përqindja më e lartë e të punësuarve që udhëtojnë çdo ditë për në punë është në Koplík, 72 % e të punësuarve gjithsej. Në të kundërt, në Komunat Gruemirë, Qendër, Kelmend e Shkrel, rreth 70 % dhe jo më pak se 60 % e të punësuarve punojnë në shtëpi, duke treguar natyrën bujqësore të punësimit që mbizotëron në këto zona. Në Komunën Kastrat ka një shpërndarje të barabartë të këtij treguesi.


**Grafiku 6: Të punësuarit në shtëpi dhe që udhëtojnë për në punë në ZF Malësi e Madhe**



Hyrjet më të shumta ditore të të punësuarve ndodhin në Bashkinë Koplík, me një ndryshim të ndjeshëm me njësitë e tjera vendore; nga ana tjetër daljet ditore nga Bashkia Koplík janë të pakta. Të marrë së bashku, treguesit theksojnë rëndësinë e veçantë të zonës së Koplíkut në punësimin e komunave fqinjë dhe gjithashtu të banorëve të saj.

Në të kundërt, Komuna Gruemirë, ka daljen më të madhe të të punësuarve. Ky fakt mund të pasqyrojë mundësi të ulta të punësimit në krahasim me komunat e tjera dhe përqendrim të bizneseve të vogla me një person të punësuar apo të vetëpunësuar.


**Grafiku 7: Hyrjet e daljet ditore të të punësuarve në ZF Malësi e Madhe**





Komuna Kelmend regjistron vetëm një numër shumë të ulët daljesh ditore, duke pasqyruar karakterin e izoluar të ekonomisë së saj për shkak të relievit malor, përqëndruar në bujqësinë, blegtorinë e aktivitetin turistik të bujtinave.

**Harta 6: Bashkëpunimi ndërmjet njësisve vendore të ZF Malësi e Madhe**



Burimi: DLDP (2014), Studim rreth zonave funksionale në Shqipëri

Në tërësi, niveli i bashkëpunimit ndërmjet njësisve të tanishme vendore brenda Malësisë së Madhe është i lartë sa më shumë i afrohehi zonës fushore të saj, ndërsa bie ndjeshëm në zonat e

larta malore. Bashkëpunimi qendërzohet në Bashkinë Koplík, si njësi vendore kyçe për tregtinë dhe shërbimet, porse nuk shtrihet në Komunën Kelmend dhe pjesën më veriore të Komunës Shkrel; këtu ndërveprimi drejtohet si rrjedhojë për nga qendrat e vendit fqinjë të Malit të Zi si Podgorica, Plava e Gucia.

## 2.3. Analizë e hollësishme e zonës funksionale

### 2.3.1. Analiza ekonomike e sektorit të bujqësisë

Në zonën e Malësisë së Madhe sektori i bujqësisë është i zhvilluar në grupet e mëposhtme të kulturave:

- *Bimë të arave* ku përfshihen: drithëra buke (misër e grurë), perime, patate, bishtajore (fasule), bimë industriale (duhan), foragjere, ndër të cilat bimë mjeksore.
- *Pemtari* ku përfshihen: drufrutorë, ullinj tryeze dhe për vaj, gështenja, agrume (portokalle, limona, mandarina), vreshta për rrush tryeze dhe për verë.
- *Blegtori* ku përfshihen: gjedhë, shpendë dhe bletë koshere.

Sipërfaqja e tokës bujqësore është 15,955<sup>5</sup> ha. Numri i fermave është 8,222, kryesisht me natyrë familjare dhe madhësi mesatare të vogël, rreth 1.85 ha. Pjesa më e madhe e tyre gjenden në zonat e ulëta të Komunës Gruemirë, Qendër e Shkrel, por dhe në Kelmend, në të cilat dhe popullsia është më së shumti e punësuar në sektorin e bujqësisë, siç u vërejt në paragrafin 2.1.2.

Vetëm 10% e tokës bujqësore mbulohet nga sistemi ujitës, ndërkohë që potenciali i këtij sistemi në kushtet e tanishme arrin deri në 60%<sup>6</sup>. Mjetet e përdorura nga fermerët janë si më poshtë. Numri i disave prej tyre (traktorë me rrota, minitraktorë dhe freza) është rritur veçanërisht në vitin 2013, megjithatë mungon informacion i hollësishëm mbi nivelin e mekanizimit që ato tregojnë apo të dobisë së secilës makineri në proceset e prodhimit të një apo më shumë kulturave bujqësore. Në vija të përgjithshme, specializimi i mjeteve është i ulët pasi makineritë përdoren për më shumë se një lloj kulturash; puna e krahut dhe kafshët shtëpiake janë ende pjesë e rëndësishme e proceseve të prodhimit në bujqësi.

---

<sup>5</sup> Kësaj sipërfaqje të tokës bujqësore i është shtuar dhe 700 ha të ish-Ndërmarrjes Bujqësore.

<sup>6</sup> Të dhëna të vitit 2013 nga Drejtoria Rajonale e Statistikave Shkodër


**Tabela 15: Mjetet mekanike të përdorura në sektorin e bujqësisë të ZF Malësi e Madhe**

Nr.	Emërtimi	2010	2011	2012	2013
1	Traktor me rrota	104	101	105	175
2	Minitraktorë	62	62	64	73
3	Makinë mbjellëse	6	4	5	5
4	Motokorrëse	38	41	43	48
5	Autokombajna	8	7	7	8
6	Traktor me zinxhir	1	1	1	1
7	Freza	32	52	52	73

Burimi: Drejtoria Rajonale e Bujqësisë, Shkodër


Në vitin 2014, toka bujqësore e punuar është 12,227 ha, pra ajo përdoret në masën rreth 80 %. Në grafikun e mëposhtëm paraqitet i detajuar përdorimi i saj në vite sipas disa prej kulturave më domethënëse:

**Grafiku 8: Përdorimi në vite i tokës bujqësore në ZF Malësi e Madhe**




Burimi: Drejtoria Rajonale e Bujqësisë, Shkodër

**Grafiku 9: Përdorimi në vite i tokës bujqësore, foragjere e bimë mjeksore në ZF Malësi e Madhe**



Burimi: Drejtoria Rajonale e Bujqësisë, Shkodër

**Grafiku 10: Përdorimi i tanishëm i tokës bujqësore në ZF Malësi e Madhe**



Burimi: Drejtoria Rajonale e Bujqësisë, Shkodër, 2014

Jonxha, e cila është ushqim për kafshët shtëpiake e të punës zë rreth 37 % të tokës së kultivuar, në 29 % të saj kultivohen bimë mjeksore dhe rreth 22 % përdoret për grurë, misër dhe perime, më së shumti për përdorim familjar dhe tregun rajonal; në pjesët më të vogla të mbetura kultivohen pemët e frutave, ullinjët, vreshtat dhe duhani.

Madhësia e tokës së papunuar është rreth 3,700 ha, pjesa më e madhe e shtrirë në Komunën Gruemirë dhe Kastrat.


## ***Bimët mjeksore***

Bimët mjeksore kultivohen në rreth 3,571 ha, të shtrira gjerësisht në fushën e Koplikut (Komuna Qendër) dhe në Komunën Kastrat. Ndër disa lloje bimësh mjeksore, në Malësinë e madhe tradicionalisht është kultivuar sherebela, ku sot është veçanërisht e specializuar forca punëtore dhe toka. Një lloj tjetër autokton i zonës është makthi, ndërsa kushtet klimatike janë të favorshme gjithashtu për rritjen e lavandës e rozmarinës.

Prodhimi i bimëve mjeksore grumbullohet prej fermerëve nga katër firma grumbulluese dhe tregtohet kryesisht në tregjet e huaja; njëri prej tyre kryen gjithashtu përpunim të sherebelës, nga e cila, përmes një procesi distilimi, nxirret vaj.

Bimët mjeksore të zonës së Malësisë së Madhe janë të njohura në tregun e jashtëm. Kërkesa është veçanërisht e lartë për sherebelën tradicionale - e vlerësuar për cilësinë shumë të mirë, në sajë dhe të përmbajtjes së lartë të vajit; gjatë viteve të fundit kërkesa ka qënë në rritje gjithashtu edhe për makthin. Çmimi i shitjes në tregun e brendshëm të bimëve mjeksore në periudhën 2011 - 2014 është luhatur nga 120 lekë/kg në 200 lekë/kg. Ndërsa, çmimi i eksportit për të njëjtën periudhë është luhatur nga 70 lekë/kg për cilësinë më të ulët, deri në 200 lekë/kg për cilësinë më të mirë.

**Grafiku 11: Sasie e eksportuar në vite e bimëve mjeksore nga prodhimi i ZF Malësi e Madhe**



Shënim: Këto janë sasi prodhimi neto, të cilat përbëjnë rreth 60 % e prodhimit bruto të bimëve mjeksore

Emri i mirë i prodhimit të sherebelës autoktone në tregjet e huaja u dëmtua gjatë vitit 2014 për shkak të kultivimit të një varieteti të jashtëm të sherebelës, gjenetikisht e modifikuar, në ngjyrë më jeshile, e cila rritet më shpejt por përman ndjeshëm më pak vaj se bima tradicionale e egër shqiptare. Për pasojë, çmimi ka zbritur në 120 lekë/kg ndërsa rreth 60 % e prodhimit të vitit është ende gjendje tek fermerët.


Eksportet e bimëve mjekësore kanë shënuar rritje të konsiderueshme gjatë vitit 2014 krahasuar me një vit më parë.

Sipas të dhënave nga dikasteri i Bujqësisë, ecuria pozitive e këtij sektori vazhdon të konfirmojë trendin e suksesit në këtë biznes duke i vënë eksportet e bimëve mjekësore në krye të eksporteve bujqësore.

Kështu, për periudhën janar-dhjetor 2014, eksporti i bimëve aromatike-mjekësore ka arritur në rreth 11.600 ton nga 11.200 ton që ishin në vitin 2013, me vlerë respektivisht 3.5 miliardë lekë nga 3.3 miliardë në 2013.

Eksportet e këtij biznesi shkojnë kryesisht në tregjet e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, vendet e Evropës etj. Kultivuesit kryesorë të bimëve mjekësore janë në Qarkun e Shkodrës, ku janë të punësuar edhe një numër i lartë banorësh që merren me prodhimin, grumbullimin, tharjen e përpunimin e tyre. Kjo industri prej vitesh ka ecur me hapa pozitivë, duke luajtur edhe një rol të rëndësishëm në rritjen ekonomike të vendit.

#### **Grafiku 12: Eksporti i bimëve mjekësore të ZF Malësi e Madhe kundrejt nivelit kombëtar**




Burimi: Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave, referuar nga ATSH

Sipas të dhënave të pasqyruara në grafikun me sipër, produkti i bimëve mjekësore nga ZF përbën respektivisht 26% dhe 29 % të totalit që eksporton vendi, gjë që tregon për potencialin e madh të kësaj zonë lidur me këtë produkt kaq të kërkuar në tregun e jashtëm.

Duke ekstrapoluar të dhënat mbi të ardhurat nga eksporti i bimëve mjekësore në nivel kombëtar për vitet 2013 dhe 2014 për sasinë e këtij produkti që ofrohet për eksport nga Zona Funktionale, rezulton se kjo Zonë ka gjenuar 854 milion Lekë dhe 1,02 milion Lekë ose 25% dhe 29% të totalit të të ardhurave respektivisht për vitet 2013 dhe 2014.

Në mbështetje të pamjes së mësipërme, të dhënat e mbledhura, tregojnë se, në harkun kohor të viteve 2010-2014, sasia e tokës bujqësore të mbjellë me bimë mjeksore është rritur të paktën pesë herë, rendimenti i tokës është rritur vazhdimisht nga 20 në 25 kv/ha dhe prodhimi është sot të paktën gjashtë herë më i lartë<sup>7</sup>.



Duke analizuar këtë tendencë natyrshë lind rekomandimi se sipërfaqja e mbjellë me këtë bimë dhe rendimenti i prodhimit duhet të jenë një objektiv parësor i zhvillimit ekonomik të ZF Malësia e Madhe.

Në përgjithësi ne rekomandojmë se zhvillimi i bujqësisë në ZF duhet të fokusohet në ato produkte të cilat janë të kërkuara në tregun e jashtëm dhe që e kanë të sigurtë këtë treg, pasi kështu ZF do të sigurojë të ardhura në rritje dhe një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik.

Në lidhje me bimët mjeksore, sipërfaqja dhe rendimenti të prodhimit duhet të rriten; kjo iniciative duhet të shoqërohet me masa mbështetëse të cilat përfshijnë, por që nuk kufizohen, në si më poshtë vijon:



1. Konsolidimi i parces bujqësore dhe organizmi në ferma të medha të përbashkëta të prodhuesëve;
2. Rehabilitimi i sistemit ujites për të arritur potencialin ekzistues nga 10 % në 60 % të tokës bujqësore;
3. Ruajtja dhe kultivimi i varietetit “autokton” të këtyre bimëve.

<sup>7</sup> Të dhënat numerike të Drejtorisë Rajonale Statistikore Shkodër kanë ndryshim nga të dhënat e Drejtorisë së Bujqësisë Rrethi Malësi e Madhe, megjithatë ato tregojnë në çdo rast prirje rritëse, dhe përafrimet këtu janë bërë në masën më të ulët me qëllim shmangien e mbivlerësimeve.

## Gështenja

Pemët frutore rriten mirë në zonat pyjore të Malësisë së Madhe, aktualisht të përqëndruara në Gruemirë, Kastrat dhe Shkrelë, në 477.7 ha të tokës bujqësore. Në bazë të të dhënave për vitin 2011 dhe 2012<sup>8</sup> në shkallë vendi, Malësia e Madhe dallon për rendimentin e lartë në pemët frutore, rreth 34 - 35 kg/rrënjë, i cili është jo vetëm mbi nivelin e mesatares kombëtare prej rreth 23 kg/rrënjë, por dhe ndër më të lartët në vend përkrah Rrethit të Matit dhe Peqinit, përkatësisht 40 kg/rrënjë dhe 31 kg/rrënjë.

Ndërmjet pemëve frutore, druri i gështenjës është i një cilësie të lartë dhe të mirënjohur në vend. Masivi më i madh i gështenjave në Malësinë e Madhe është ai i zonës së Reçit në Komunën Shkrel, i cili daton që para 200 vjetësh. Masivi shtrihet në një sipërfaqe prej 450 ha, prej të cilave mbi 350 ha janë të shfrytëzueshme.




Ky është masivi i dytë, si për nga sipërfaqja po ashtu edhe nga prodhimtaria, pas atij të Tropojës me rreth 2,000 ha, i cili është masivi më i madh i Ballkanit.

Prodhimi i gështenjave i drejtohet tregut të jashtëm, ku kërkesa është e lartë. Çmimi i shitjes luhetet nga 1 Euro/kg deri në 1.2 Euro/kg me një çmim mesatar prej 0,93 Euro/kg ose 130 Lekë/kg.

<sup>8</sup> INSTAT, Vjetari Statistikor, 2011 dhe 2012



**Grafiku 13: Sasie e eksportuar në vite e gështenjave nga prodhimi i ZF Malësi e Madhe**




Burimi: Drejtoria e Bujqësisë Rrethi Malësi e Madhe

Rënia e vitit të fundit ka ardhur për shkak të kushteve jo të favorshme klimatike, gjithsesi potenciali në tregun e jashtëm vlerësohet të jetë i lartë.

Duke u referuar me të dhënat më sipër, për një mesatare prodhimi vjetor prej 438 ton/vit dhe çmimit mesatar në grumbullim prej 80 lekë/kg, të ardhurat për familjet që merren me këtë biznes në Malësinë e Madhe mund të llogariten afërsisht 35 milion lekë/vit, ndërsa vlera nga eksporti llogaritet në afërsisht 56,9 milion lekë/vit.

**Grafiku 14: Vlerësim i të ardhurave aktuale nga prodhimi e shitja e gështenjës në ZF Malësi e Madhe**




Burimi: Të dhënat mbi prodhimin nga Drejtoria Rajonale Bujqësisë; çmimi mesatar i shitjes në grumbullim dhe eksport sipas shoqatës “Reçi Prodhimtar”

Duke iu referuar të dhënave të Shoqatës “Reçi Prodhimtar”, të raportuara nga Revista Monitor, gjatë vitit 2014 çmimi i grumbullimit të gështenjës është luhatur nga 50 deri 110 Lekë/kg me një mesatare prej 80 Lekë/kg, ndërsa i eksportit vlerësohet rreth 130 Lekë/kg. Vetëm kjo shoqatë zotëron rreth 200 ha nga 450 ha e masivit të Recit dhe gjatë vitit 2014 ka tregtuar rreth 170 ton prej te cilave 100 ton për tregun italian dhe 70 ton për tregun e brëndshëm.

Gjithnje mbi të njëjtin burim informacioni, administratorët e shoqatës raportojnë se synimi i tyre është që të arrijnë të shfrytëzojnë kapacitetin maksimal të hapsirës që ata zotërojnë i cili vlerësohet rreth 4000 ton/vit kundrejt rreth 6000 ton/vit që vlerësohet si kapaciteti i të gjithë masivit.

Duke iu referuar këtyre të dhënave, për një çmim mesatar prej 80 Lekë/kg në grumbullim, nga kjo kulturë, në kushtet aktuale, mund të gjenerohën nga 320 milion Lekë/vit deri në 490 milion Lekë/vit; ndërsa vlera në eksport, bazuar në çmimin mesatar aktual prej 130 Lekë/kg mund të arrijë nga 520 milion Lekë/vit (3.7 milion Euro) në 520 milion Lekë/vit (5,6 milion Euro/vit). Grafiku më poshtë ilustron krahasimisht të ardhurat aktuale nga shitja në grumbullim (me shumicë) me të ardhurat potenciale nga eksporti i gështenjës.

**Grafiku 15: Të ardhurat nga shitja në grumbullim dhe eksporti i gështenjës në ZF Malësi e Madhe**




Në këto kushte rekomandimi i parë do të ishte në lidhje:

1. Shtrirja e shfrytëzimit drejt kufijve optimale te potencialit prodhues të gështenjës në Malësinë e Madhe, dhe së dyti,
2. Zgjerimi i kultivimit të gështenjës është i këshillueshëm ndonse koha e nevojshme për ngritjen e një plantacioni të ri me dru gështenje është disa vite, për këtë arsye ndikimi në prodhim dhe të ardhura nga shitja do të shtrihet në një periudhe afatgjatë.

## Vreshtat

Zona e Malësisë së Madhe, e përberë nga terrene dhë të kuq dhe shkëmbinj gëlqerorë, me lartësi nga niveli i detit, është mjaft e favorshme për rritjen e vreshtave.



Vreshtat zënë 369 ha tokë bujqësore, e shtrirë në Kastrat, Gruemirë dhe Koplík (Komuna Qendër). Ato i përkasin varietetit autokton të rrushit Kallmet, i cili është një markë e regjistruar në Shqipëri.

Vite më parë ekzistenca e Fabrikës së Verës në Shkodër kishte ndikuar në rritjen e sipërfaqeve të kultivuara me rrush Kallmet. Pas viteve '90 fabrika falimentoi dhe një pjesë e mirë e vreshtave u shkatërruan dhe lindën shumë kantina private të vogla që vazhduan të prodhojnë, por në sasi dhe cilësi më të ulët. Gjatë viteve të fundit është punuar mjaft nga organizata të huaja për mbrojtjen e Kallmetit si varietet rrushi autokton.

Kallmeti është i njohur për cilësitë e tij unike dhe të rralla: ai ka ngjyrë të kuqe shege me nuanca vjollcë dhe ka një buqetë aromash të pasura, ndër të cilat mbizotërojnë vjollca dhe qershia. Cilësia e varietetit të rrushit Kallmet pohohet nga ekspertë të fushës<sup>9</sup>, nga ana tjetër, vlen të theksohet se prodhimtaria e zonës nuk është veçanërisht e lartë krahasuar me zona të tjera të vendit të specializuara në prodhim rrushi dhe vere. Bazuar përsëri në të dhënat e vitit 2011 dhe 2012, rendimenti i Malësisë së Madhe luhet tek 92 - 96 kg/rrënjë ndërsa mesatarja kombëtare është rreth 123 kg/rrënjë, dhe nivelet më të larta arrijnë deri në mbi 200 kg/rrënjë.

Në vitet e fundit, prodhimi i vreshtave ka qënë krahasimisht i qëndrueshëm, mesatarisht rreth 2,400 ton, i drejtuar kryesisht për në tregun vendas, dhe një pjesë më e vogël për prodhimin e verës.

Aktualisht, në zonën e Malësisë së Madhe ka një kantine vere e cila përdor lëndë të parë rrushin nga vreshtat në pronësi të së njëjtës firmë, dhe shet nën markën e regjistruar të varietetit të Kallmetit. Prodhimi i kësaj kantine i drejtohet deri më tani tregut të brendshëm. Pjesa tjetër e fermerëve prodhojnë verë pa markë të regjistruar, gjithashtu raki ose rrush tryeze për tregun e brendshëm. Për shfrytëzimin e këtij potenciali janë të nevojshme kantina të tjera në zonë, të cilat, nga ana tjetër, janë investim i një vlere të lartë.

<sup>9</sup> Sipas mendimit të ekspertëve të L.V.I.A



Në këto kushte, një mundësi për fermerët e zonës mund të jetë shitja e prodhimit të vreshtave në kantina të zonave fqinjë, nderkohe, që forcojnë pozitën e tyre financiare apo gjejnë financime për të ngritur kantinat e tyre të vogla.





Gjatë viteve të fundit në tregun vendas rrushi i varietetit Kallmet është tregtuar me shumicë për kantina me 80 lekë/kg. Rritja e sipërfaqjes me 500 ha vreshta Kallmet, që prodhojnë rreth 90 kv/ha, do të sillte një të ardhur prej rreth 360 milion lekësh. Megjithatë, mbetet shumë për t'u bërë për regjistrimin e varietetit, sensibilizimin e fermerëve për të shtuar sipërfaqjet e vreshtave me kallmet dhe varietete të huaja, në njohjen e tyre me teknikat prodhuese dhe inovative të rrushit dhe verës, me teknikat e marketingut apo organizimin e aktiviteteve promovionale.

### **Perimet**

Perimet së bashku me fasulet e patatet renditen të tretat për nga madhësia e tokës bujqësore të kultivuar, gjithsej 1,837.35 ha. Fushat e Komunës Gruemirë janë të përshtatshme për mbjelljen e perimeve, veçanërisht specat (fshati Dobër), patate dhe fasule, ndërsa në zonën malore të Kelmendit, pjesa krahasimisht më e vogël e tokës bujqësore është e specializuar në kultivimin e patates dhe është prodhuesi kryesor në zonën e Malësisë së Madhe.

Aktualisht, pjesa më e madhe e prodhimit të perimeve, fasuleve e patateve të zonës funksionale shiten në tregun vendas, dhe pavarësisht specializimit të zonës nuk renditen ndër kulturat më fitimprurëse. Rendimenti i prodhimit të patates ka qënë në rritje gjatë viteve 2010 - 2014, megjithatë mbetet nën mesataren në shkallë vendi. Po kështu, dhe rendimenti i fasuleve, i cili ka qënë krahasimisht i pandryshueshëm në këto vite, është gjithsesi nën mesataren e vendit. Rendimenti i perimeve, nga ana tjetër, ka qënë në rënie, ndërsa ka një nivel ndjeëshm më të ulët se mesatarja në shkallë vendi.





Zhvillimi i këtij sektori shfaq disa probleme të cilat identifikohen përgjithësisht nga specialistët e bujqësisë dhe që kanë të bëjnë me sa më poshtë vijon:

- Janë prodhime delikate që dëmtohen dhe prishen shpejt, kanë qëndrueshmëri të shkurtër pas vjeljes si dhe kërkojnë çdo ditë në treg;
- Prodhimi dhe marketingu i perimeve është aktivitet global dhe për rrjedhojë dhe ligjet e konkurrencës së sektorit janë prezent dhe të pashmangshëm;
- Përballimi i kërkesave të tregut si: shumëllojshmëri dhe vazhdueshmëri në prodhimin e perimeve të freskëta;
- Plotësim i shijeve të konsumatorit dhe siguria për produkt të shëndetshëm;
- Rritja e vlerës së produktit duke siguruar manipulimin e pas-vjeljes;
- Standardet e transportit, ruajtjes, tregtimint deri në tavolinën e konsumatorit

Prodhimi i perimeve mund të shtohet por rendimenti në këtë kulturë delikate është i lidhur me gjetjen e menjëhershme dhe në kohën e duhur të tregut si dhe me kushtet e magazinimit dhe konservimit. Në këto rrethana rekomandohet që fokusi i veprimtarisë krahas shtimit të sipërfaqes me këto kultura, të jetë:

1. Përqëndrimi i prodhimit të perimeve në afërsi ose periferitë e zonave urbane me qëllim pozicionimin sa më afër tregut,
2. Zgjerimin e prodhimit të perimeve nga serat,
3. Stabilizimi i lidhjeve me tregtarët dhe tregun,

Në afatgjatë do të rekomandonim që sektori të fokusohet në:



4. Përmirësimi dhe rritja e kapaciteteve magazinuese dhe konservuese,
5. Zhvillimin ose lidhejn e prodhueseve me industrinë përpunuese.

**Kutia 1: Raport mbi Forumin për Analizën Ekonomike dhe të Shërbimeve Publike 27 shkurt 2015**

Specialistët e pranishëm argumentojnë që, veç duhanit, hyrja e produkteve bujqësore të importit me çmime shumë më konkurruese ka penguar dhe zhvillimin e kulturave të perimeve dhe frutave ku zona e Malësisë së Madhe ka traditë por për të cilat, sot kërkesa vendase është shumë e ulët. Në mënyrë të veçantë përmenden këtu specat, tradicionalisht të kultivuara në fshatin Dobër, dhe patatet, në Kelmend, që përbëjnë një potencial, që sot nuk arrin të shfrytëzohet. Në përfundim, ata mendojnë se këto argumente mbi nevojën për politika tregtare qëndrore në mbrojtje të prodhimit vendas të përfshihen në dokumentin e analizës dhe ti bëhen prezent qeverisë.

### Duhani

Në rreth 238 ha tokë bujqësore kultivohet aktualisht duhan, bimë industriale që është tradicionale për zonën dhe e kultivuar më gjerësisht në Gruemirë. Pavarësisht kësaj tradite të vjetër, cilësia e duhanit nuk vlerësohet konkurruese në tregjet e huaja. Prodhimi i drejtohet më së shumti tregut të brendshëm, ku çmimi është i ulët dhe kërkesa gjatë viteve 2010-2014 ka qënë e paqëndrueshme.



Kërkesa për këtë kulturë është rritur vetëm gjatë vitit 2013 në përgjigje të një rritje të përgjithshme të çmimit të cigareve të importuara si pasojë e rritjes së tarifave të importit.



**Kutia 2: Raport mbi Forumin për Analizën Ekonomike dhe të Shërbimeve Publike 27 shkurt 2015**

Specialistë të pranishëm në Forum janë të mendimit se mungesa e politikave qeveritare proteksioniste për prodhuesit vendas është një arsye që shpjegon më saktë rënien e prodhimit dhe shitjes së duhanit të prodhuesve të Malësisë së Madhe në vitet e fundit. Specialistë të pranishëm në Forum janë të mendimit se mungesa e politikave qeveritare proteksioniste për prodhuesit vendas është një arsye që shpjegon më saktë rënien e prodhimit dhe shitjes së duhanit të prodhuesve të Malësisë së Madhe në vitet e fundit. Pjesëmarrësit në forum ata rekomandojnë se këto argumente mbi nevojën për politika tregtare qendrore në mbrojtje të prodhimit vendas të përfshihen në dokumentin e analizës dhe ti bëhen prezent qeverise.

Rekomandohet përqendrimi i prodhuesve vendas në varietete duhani cilësore. Kjo përqsaje i orienton prodhuesit drejt një produkti cilësor dhe jo drejt sasive të larta të prodhimit. Një përqsaje e tillë mund të ndryshohet pas disa viteve nëse cilësia e lartë e produktit jep rezultate duke gjetur tregje të qëndrueshme brenda dhe jashtë vendit, gjë që mund të çojë në nevojën për shtimin e sipërfaqeve të mbjella. Për këtë lind nevoja që prodhuesit të prezantohen me varietete më cilësore dhe teknika moderne kultivimi në koordinim me Drejtorinë e Bujqësisë dhe Qendrën e Transferimit të Teknologjive Bujqësore.

### **Ullinj**

Drunjte e ullirit janë mbjellë vitet e fundit në bazë të një nisme eksperimentale qeveritare, kryesisht në fushën e Komunës Kastrat e Qendër, si dhe më pak në Koplík e Gruemirë, gjithsej në 410 ha tokë bujqësore. Prodhimi u rrit deri në vitin 2012 dhe, prej një maksimumi, ka qënë në rënie të vazhdueshme deri më sot, po ashtu dhe rendimenti, i cili ishte fillimisht i pandryshueshëm. Pjesa më e madhe e drurëve të ullirit nuk i mbijetuan kushteve klimatike të zonës së Malësisë së Madhe, dhe e njëjta gjë pritet edhe në vitet në vazhdim, duke dalë në përfundimin se kjo kulturë nuk i përshtatet zonës.




Së fundi, është e rëndësishme të vihet në dukje se, të dhënat e sektorit të bujqësisë shfaqin rënie të prodhimit në përgjithësi thuajse për të gjitha kulturat, gjatë harkut kohor të viteve 2010 - 2014, e cila ka ardhur si pasojë e krizës ekonomike dhe pasqyron PBB-në negative në nivel qarku për vitin 2011 dhe 2012<sup>10</sup>.

**Kutia 3: Raport mbi Forumin për Analizën Ekonomike dhe të Shërbimeve Publike 27 shkurt 2015**

Specialistë të pranishëm në Forum janë të mendimit se peshkimi është një veprimtari me potencial të ardhurash për zona të Malësisë së Madhe të cilat janë afër burimeve ujore, si lumi Cen, burimi i Rjollit dhe liqeni i Shkodrës. Në Komunën Kelmend ka sipërmarrje fillestare në këtë drejtim, të cilat, specialistët argumentojnë se mund të mbështeten dhe zhvillohen më tej, me qëllim krijimin e burimeve alternative të të ardhurave për banorë të zonave të veçanta.

**Harta 7: Kultivimi i tokës bujqësore në njësitë vendore të ZF Malësi e Madhe**



Burimi i hartës: Autori


<sup>10</sup> Treguesi PBB në nivel qarku nuk është ende i publikuar për vitet 2013 dhe 2014.



## Blegtoria

Politikat aktuale të Sektorit të Prodhimit Blegtoral janë fokusuar kryesisht në rritjen e numrit të kafshëve (gjedhë dhe të imta) brenda fermës blegtorale me synim konsolidimin e fermave dhe orientimin e këtyre fermave drejt tregut. Gjithashtu, mbështetja e prodhimit të mëshqerrave të racës duke synuar krijimin dhe nxitjen e shoqatave racore si dhe krijimin e tregut vendas për kafshët me vlera racore të identifikuara.


**Grafiku 16: Numri i krerëve të kafshëve blegtorale në vite në ZF Malësi e Madhe**



Burimi: Drejtoria Rajonale e Bujqësisë, Shkodër


Nga të dhënat e paraqitura në grafikët më sipër shihet se ka stabilitet në rritjen e numrin e krerëve të kafshëve, ashtu si dhe të shpëndve.

**Grafiku 17: Numri i krerëve të shpëndve në vite në ZF Malësi e Madhe**




Në ZF Malësia e Madhe zhvillimi i blegtorisë në vite (2010 – 2014) është paraqitur si në grafikët më poshtë:

**Grafiku 18: Numri i krerëve të bletëve koshere në vite në ZF Malësi e Madhe**







**Grafiku 19: Gjendja e blegtorisë në ZF Malësi e Madhe, 2013**



Prodhimi blegtoral në zonën funksionale Malësi e Madhe është më së shumti për përdorim familjar. Tre baxho kanë veprimtari tregtare të rëndësishme, në Gruemirë, Shkrel (fshati Reç) dhe në Kastrat.

Mbështetur në të dhënat statistikore të vitit 2011 dhe 2012. Rrethi i Malësisë së Madhe veçohet për rendimentin mbi mesataren kombëtare në prodhimin e qumështit të deles, dhisë si dhe vezëve. Numri më i madh i krerëve ndër vite është pikërisht i deleve dhe shpendëve.

Në grafikët më poshtë jepen prodhimet e produkteve kryesore blegtorale të zonës në vitet e fundit. Prodhimi qumështit dhe mishit ka rënë në vitin 2013, pas një rritje thuajse të vazhdueshme në periudhën 2010-2012; vezët janë në rritje ndërsa prodhimi i mjaltit është relativisht i qëndrueshëm.



Strategjia Ndërsektorale për Zhvillimin Rural dhe Bujqësor të Shqipërisë, 2014-2020 vëren së kërkesa për prodhime ushqimore në tregun e brendshëm është në rritje; konsumatorët janë më të ndërgjegjësuar për vendin apo zonën e origjinës së produkteve ushqimore që ata blejnë e konsumojnë dhe për më tepër, ata zgjedhin produkte vendase, duke shfaqur preferenca edhe të zonave të veçanta e traditave të tyre<sup>11</sup>. Kjo prirje është një sinjal i rëndësishëm për rajonet e vendit si Malësia e Madhe, si për potencialin e rritjes së prodhimit në masë, dhe për përqëndrimin tek produktet tradicionale dhe rigjallërimin e specializimeve të herëshme apo të vonshme të rajonit në kulturat bujqësore apo në blegtori.

Spektori i akuakulturs ka filluar të gjejë gjithashtu haspirë në territorine ZF të Malësisë së Madhe. Ekspertë të bujqësisë dhanë mendimin për të përfshirë akuakulturën (rritja e troftës në rezervate) ndër sektorët me potencial të ardhurash, me rëndësi kryesisht në zonën malore të Kelmendit, ku ka mundësi të shfrytëzohen burimet ujore si lumi Cem dhe burimi i Rrjollit. Aktualisht, rezervatet e peshkut duket se kanë marrë një zhvillim fillestar në Tamarë dhe që ekspertët mendojnë se duhet nxitur.

<sup>11</sup> Strategjia Ndërsektorale për Zhvillim Rural dhe Bujqësor, 2014-2020, në Fletoren Zyrtare, 2014 Numër 169, faqe 8491.

Disa rekomandime të përgjithshme mund të rrjedhin nga kjo analizë:

1. Prirja ne rritje e kërkesës për produkte blektorale vendase është një sinjal i rëndësishëm për rajonet e vendit si Malësia e Madhe, si për potencialin e rritjes së prodhimit në masë, dhe për përqëndrimin tek produktet tradicionale dhe rigjallërimin e specializimeve të herëshme apo të vonshme të rajonit në në blegtori.
2. Forcimi i fermës së vogël dhe të mesmë për mbarështrimin e gjedhëve dhe dhenve do të rrisë prodhimin blektoral i cili aktualisht është vecanërisht i kërkuar në tregun vendas.
3. Përmirësimi i infrastrukturës për mbarështrimin e këtyre kafshëve është i nevojshëm të përmirësohet, krahas shitmit të krerëve dhe produkteve blektorale

## Rekomandime mbi zhvillimin e sektorit të bujqësisë dhe blegtorisë

### Rekomandime të përgjithshme

1. Autenticiteti i farërave dhe i traditave në kultivim të kulturave bujqësore dhe blegtori dhe vlerat shëndetësore të produkteve natyrore janë baza cilësore të rëndësishme për zhvillimin e sektorit të bujqësisë dhe blegtorisë të Zonës Funktionale Malësi e Madhe me orjentim kryesor tregjet e huaja dhe vendase.
2. Në tërësi, kulturat bujqësore dhe blegtorale e produkte e tyre mund të gjejnë hapësirë zgjerimi edhe duke mbështetur zhvillimin e sektorit të turizmit rural, natyror e kulturor për të cilin ushqime tradicionale, bio dhe gatimet ‘slow-food’ janë një ndër faktorët dhe atraksionet kryesore te turizmit rural dhe malor.
3. Për zonën funksionale të Malësisë së Madhe, rritja e sektorit të bujqësisë bëhet nëpërmjet shtimit të sipërfaqes së punueshme duke futur në përdorimi rreth 3,700 ha tokë bujqësore e disponueshme.


**Tabela 16: Shpërndarja e tokës bujqësore të mbjellë dhe të pambjellë në ZF Malësi e Madhe**

Njësitë vendore	Toka gjithsej ha	Tokë e mbjellë ha	Drithëra	Perime, bishtajore	Foragjere	Pemë frutore	Duhan	Bimë medicinale	Ullinj	Vreshta	Tokë e papunuar
Koplik	830	452.9	40.0	65	80	10.5	1	196	35.2	25.2	377.1
Qendër	4,112	3,830.7	185.0	346	1,120	76.6	50	1,850	131.5	71.6	281.3
Gruemirë	4,045	2,697.4	215.0	577	1,235	57.2	142	342	49.3	79	1,347.7
Shkrel	1,759	1,704.6	123.0	256	800	121.9	5	363	0	35.7	54.4
Kastrat	4,163	3,033	202	413	1,015	192.1	40	820	194.6	156.3	1,130.0
Kelmend	1,046	508.4	58.0	180	250	19.4	0	0		1	537.6
Shuma	15,955	12,227	823	1,837	4,500	477.7	238	3,571	410.6	368.8	3,728.1

Burimi: Drejtoria e Bujqësisë Rrethi Malësi e Madhe

4. Planifikimi i zhvillimit të bujqësisë duhet të synojë zgjerimin e kultivimit të bimëve më fitimprurëse dhe me avantazh konkurrues në tregun e jashtëm dhe në tregun e brendshëm krahasuar me zona të tjera të vendit. Ndër to, më të rëndësishme janë:
  - a. bimët mjeksore, me përparësi sherebëlën e egër tradicionale
  - b. drufrutorët, me përparësi gështenjat
  - c. duhani
5. Me përparësi duhe të shikohet zgjerimi i prodhimit të perimeve mbi bazën e varieteteve autentike dhe veçanërisht:
  - d. perimet, me përparësi speci dhe patatja

**Harta 8: Toka bujqësore e pambjellë sipas njësive vendore të ZF Malësi e Madhe**



Burimi i hartës: Autori

6. Një planifikim i kujdesëshëm i shpërndarjes së sipërfaqjes së tokës bujqësore të papunuar në drejtim të këtyre kulturave dhe në përshtatje me zonat specifike të Malësisë së Madhe është i nevojshëm.
  - a. Konsolidimi i parcelave bujqësore për të rritur përdorimin e mekanikës, uljen e kostove dhe rritjen e rendimentit prodhues.
  - b. Mekanizimi i mëtejshëm i punës në sektorin e bujqësisë, përmirësimi i infrastrukturës dhe ngritja e kapacitetit të sistemit të ujitjes janë objekte kyçe investimi për të mundësuar rritjen e rendimentit të prodhimeve më fitimprurëse dhe me avantazh konkurrues të gjetura nga kjo analizë.
  - c. Në lidhje me bimët mjeksore, vlerësohet se kërkesa e tregut dhe toka bujqësore mund të mbështesin thujtë dy-fish më shumë prodhim se në vitin e fundit 2014, por nevojitet njëkohësisht zgjerimi i aftësive grumbulluese dhe ruajtëse të fermerëve dhe grumbulluesve.
  - d. Gjithashtu, nisur nga problematika e shfaqur gjatë vitit 2014 nga hyrja e farërave jo autoktone të sherebelës, është i nevojshëm ndërgjegësimi i fermerëve për ruajtjen e farës vendase por jo vetëm. Kjo do të kërkonte ndërhyrjen qeverisë me një politikë mbrojtëse të fermerëve vendas nëpërmjet ndalimit të importit të farave të huaja dhe masa të ngjashme.
  - e. Në lidhje me vreshtarinë, mbështetja për çertifikimin i prejardhjes gjeografike të produkteve është e vlefshme në mënyrë të veçantë për zhvillimin e nënsektorit. Në kushtet e mungesës së deritanishme të kantinave të verës të cilat të punojnë me fermerë të vegjël të zonës, drejtimi i tyre drejt kantinave të zonave fqinje duhet të shqyrtohet si mundësi zgjerimi të të ardhurave të tyre në afatshkurtër dhe afatmesëm. Gjithashtu është i rëndësishëm sensibilizimin e fermerëve për të shtuar sipërfaqjet e vreshatave me kallmet dhe varietete të huaja, në njohjen e tyre me teknikat prodhuese dhe inovative të rrushit dhe verës, me teknikat e marketingut apo organizimin e aktiviteteve promovionale.
  - f. Produkte të përpunimit të bimëve eterovajore dhe gështenjave, por edhe të produkteve blegtorale si djathi, vlerësohet të ketë potencial në tregun vendas dhe të huaj; për këtë arsye, projekte investimi në industrinë përpunuese mund të mbështeten në të ardhmen.
  - g. Njëkohësisht, vlerësojmë se është me rëndësi për zonën funksionale përfundimi i projektit për ngritjen e Parkut Industrial Kopluk; me qëllim rifillimin e procedurave për zbatimin e vendimit përkatës nga Ministria e Ekonomisë Tregtisë dhe Energjitikës, mendojmë se është e nevojshme konsulencë financiare dhe juridike e posaçme.

## ***Rekomandime specifike***

### *Bimët mjeksore*

1. Ne rekomandojmë se zhvillimi i bujqësisë në ZF duhet të fokusohet në ato produkte të cilat janë të kërkuara në tregun e jashtëm dhe që e kanë të sigurtë këtë treg, pasi kështu ZF do të sigurojë të ardhura në rritje dhe një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik.
2. Në lidhje me bimët mjekësore, sipërfaqja dhe rendimenti i prodhimit duhet të rriten; kjo nismë duhet të shoqërohet me masa mbështetëse të cilat përfshijnë, por që nuk kufizohen, në si më poshtë vijon:
  - a. Konsolidimi i parces bujqësore dhe organizmi në ferma të mëdha të përbashkëta të prodhuesëve,
  - b. Rehabilitimi i sistemit ujitjes për të arritur potencialin ekzistues nga 10 % në 60 % të tokës bujqësore,
  - c. Ruajtja dhe kultivimi i varietetit “autokton” të këtyre bimëve.

### *Gështenja*

1. Shtrirja e shfrytëzimit drejt kufijve optimale të potencialit prodhues të gështenjës në Malësinë e Madhe, dhe së dyti,
2. Zgjerimi i kultivimit të gështenjës është i këshillueshëm ndonse koha e nevojshme për ngritjen e një plantacioni të ri me dru gështenje është disa vite, për këtë arsye ndikimi në prodhim dhe të ardhura nga shitja do të shtrihet në një periudhë afatgjatë.

### *Duhani*

1. Rekomandohet përqendrimi i prodhuesve vendas në varietetet e duhanit cilësorë. Një përjasje e tillë mund të ndryshohet pas disa viteve nëq cilesia e lartë e produktit jep rezultate për të rritur sipërfaqen dhe prodhimin dhe duke gjetur tregje të qëndrueshme brenda dhe jashtë vendit.
2. Autoritete e bujqësisë në ZF, Qark dhe Ministrinë e Bujqësisë duhet të ndihmojnë dhe mbështesin prodhuesit që të prezantohen me varietete me cilësorë dhe teknikat moderne të kultivimit.

### *Perimet*

1. Prodhimi i perimeve mund të shtohet por rendimenti në këtë kulturë delikate është i lidhur me gjetjen e menjëhershme dhe në kohën e duhur të tregur si dhe me kushtet e magazinimit dhe konservimit.

Në këto rrethana rekomandohet që fokusi i veprimtarisë krahas shtimit të sipërfaqes me këto kultura, të jetë:

- a. Përqëndrimi i prodhimit të perimeve në afërsi të zonave urbane me qëllim pozicionimin sa më afër tregut,
  - b. Zgjerimin e prodhimit të perimeve nga serat,
  - c. Stabilizimi i lidhjeve me tregtarët dhe tregun.
2. Në afatgjatë do të rekomandonim që sektori të fokusohet në:
- a. Përmirësimi dhe rritja e kapaciteteve magazinuese dhe konservuese,
  - b. Zhvillimin ose lidhejn e prodhueseve me industrinë përpunuese.

### *Blegtoria*

4. Prirja në rritje e kërkesës për produkte blektorale vendase është një sinjal i rëndësishëm për rajonet e vendit si Malësia e Madhe, si për potencialin e rritjes së prodhimit në masë, dhe për përqëndrimin tek produktet tradicionale dhe rigjallërimin e specializimeve të herëshme apo të vonshme të rajonit në blegtori.
5. Forcimi i fermës së vogël dhe të mesme për mbarështimin e gjedhëve dhe dhenve do të rrisë prodhimin blektoral i cili aktualisht është veçanërisht i kërkuar në tregun vendas.
6. Përmirësimi i infrastrukturës për mbarështimin e këtyre kafshëve është i nevojshëm, krahas shitimit të krerëve dhe produkteve blektorale.

### *Peshkimi*

7. Peshkimi është një veprimtari ende në faza fillestare në zonën funksionale i cili rekomandohet të mbështetet financiarisht me qëllim shfrytëzimin e burimeve ujore të Malësisë së Madhe si një burim alternativ të ardhurash për banorët e zonave pranë këtyre burimeve.

### **2.3.2. Analiza ekonomike e sektorit të turizmit**

Sipas vlerësimit të bërë nga Këshilli Botëror i Turizmit dhe Udhëtimeve për Shqipërinë, në vitin 2011 sektori i turizmit arriti në 6.1 % të PBB të vendit, duke hapur afërsisht 51,000 deri në 183,000 vende pune; numri i vizitorëve ndërkombëtarë ka qënë në rritje që prej vitit 2001 dhe në vitin 2012 ka arritur 3.45 milion, pavarësisht se prirja rritëse është ngadalësuar gjatë vitit 2013<sup>12</sup>.

Draft Strategjia Kombëtare e Turizmit në Shqipëri 2014-2020 (SKTSH), veçon turizmin rural dhe natyror si llojin më të përshtatshëm për Shqipërinë, i cili pritet të zhvillohet në sajë të një rritje të përgjithshme të kërkesës në vende të huaja nga ku vijnë vizitorë<sup>13</sup>; përfundimi është nxjerrë nga anketimet dhe vlerësimet e kryera në vitin 2012<sup>14</sup>, e cila thekson pikërisht karakterin e egër dhe të panjohur të një sërë krahinash të Shqipërisë, diversitetin gjeografik, fizik, dhe

<sup>12</sup> Draft - Strategy of Tourism Development in Albania for 2014-2020, page 8.

<sup>13</sup> Ibid, page 13

<sup>14</sup> Vlerësime të kryera nga GIZ në 2012



kulturor si dhe traditat si trashëgimi me një potencial të madh për krijimin e të ardhurave. Format tipike të akomodimit për këtë lloj turizmi janë kampingu, bujtinat ose alternativa të ngjashme me kushte bazë, të cilat, për rrjedhojë, kanë dhe nevojë për një investim fillestar më të vogël në krahasim me ngritjen e hoteleve të turizmit bregdetar. Ndër aktivitetet tipike janë lundrimi në lumenj, ecja me biçikleta, peshkimi, ngjitja në male, kalërimi, etj.

Mbi këtë bazë, karakteristikat e ndryshme gjeografike dhe fizike të krahinës së Malësisë së Madhe, afrojnë mundësi për zhvillimin e turizmit liqenor gjatë bregut të Liqenit të Shkodrës, dhe atij rural e malor në Alpet e Kelmendit.


### ***Akomodimi***

Në Komunën Kelmend, gjenden sot rreth 20 bujtina me kapacitet mesatarisht 10 deri në 20 shtretër (jo më pak se 7 shtretër), më së shumti të përqëndruara në fshatrat Vermosh, Lepushë e më pak në Tamarë e Nikç. Ato afrojnë shërbimin “Fjetje dhe Mëngjes” për një çmim mesatar 13 EUR për vizitor. Që prej vitit 2010, në këtë zonë shoqëria italiane V.I.S mbështet zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit. Në bazë të të dhënave të kësaj shoqërie, në vitin 2009, në Kelmend numëroheshin vetëm 2 bujtina.

Në Komunën Shkrel, fshatrat Razëm dhe Bogë kanë qënë që herët pika turistike të mirënjohura dhe të vizituara në vend. Në Bogë, numri i bujtinave aktualisht arrin në 4, ndërsa dhe 5 të tjera pritet të përfshihen gjatë sezonit veror 2015 në projektet e zhvillimit të turizmit të shoqërisë V.I.S. Në Razëm gjenden 3 hotele me kapacitet deri në 200 shtetër.

Pjesa më e madhe e bujtinave në Komunën Kelmend, kanë formën juridike të shoqërisë me bashkëpunim reciprok, sh.b.r, një formë administrimi e cila përfshin në vendimmarrje të gjitha familjet e bujtinave, 3 - 4 prodhues tradicional të zonës, dhe guidën turistike, të gjithë me peshë të barabartë. Kjo shoqëri organizon aktivitete marketingu që përfshijnë lidhjen me agjensitë turistike, prezantime të “ushqimeve të ngrohta” (slow food) për të promovuar pjatat tradicionale të zonës apo dhe pjesëmarrja në panairë të produkteve ushqimore, ku jepet informacion dhe për mundësitë e akomodimit në Kelmend. Ajo ofron gjithashtu dhe kurse gastronomie dhe menaxhim hotelesh për banorë të moshave të ndryshme, me qëllim zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit të turizmit në zonë me anë të ngritjes së kapaciteteve njerëzore.

## Harta 9: Përqendrimi i veprimtarisë turistike në sezonin veror në ZF Malësi e Madhe



Burimi i hartës: Autori

### *Turizmi liqenor*

I vetmi biznes në zonën liqenore të Malësisë së madhe ndodhet në Komunën Gruemirë, në bregun e Liqenit të Shkodrës, ku është ngritur një kamping turistik. Investimi përfshin një infrastrukturë minimale dhe vetëm disa dhoma fjetje. Kampingu ofron udhëtime turistike në krahinën e Malësisë së Madhe dhe në zona të tjera fqinje. Nga të dhënat e biznesit, në sezonin e fundit turistik veror të vitit 2014, numri i turistëve arriti në 4,000 (pjesa më e madhe e tyre të huaj) duke krijuar të ardhura mesatarisht në nivelin 4 EUR për turist. Në kuadër të zhvillimit të turizmit malor, përveç burimeve dhe bukurive natyrore, zona ofron objekte të tjera të rëndësishme atraksioni siç mund të jenë produktet natyrore dhe bujqësore natyrore.

Zhvillimi ekonomik i zonës ndikon dhe ndikohet nga shfrytëzimi i burimeve natyrore të liqenit dhe qëndrueshmëria e tij.

Planet e zhvillimit ekonomik të njërive të pushtetit vendor pranë tij duhet të marrin parasysh një vizion dhe koncept të miratuar dhe administrata e liqenit duhet të marrë pjesë dhe monitorojë këto zhvillime.

Studimi i financuar nga GiZ për përgatitjen e një Plani Menaxhimi për liqenin e Shkodrës vëren se:

- propozimet për alternativat e zhvillimit ekonomik për basenin e liqenit duhet të vlerësohen me kujdes, sepse ato mund të ndikojnë në nivelin e liqenit, hidrologjinë, dhe rrjedhjen karakteristike shumë të shpejtë, duke minuar integritetin ekologjik dhe cilësinë e ujit të liqenit;
- cilësia e ujit në përgjithësi është e mirë, por vetëm nëse rigjallërimi ekonomik dhe rritja në basenin e liqenit menaxhohet në një mënyrë të qëndrueshme për mjedisin, përndryshe cilësia mund të përkeqësohet;
- ka disa zona të nxehta të ndotura veçanërisht nga ujërat e zeza të pa trajtuara nga vendbanimet në brigjet e liqenit;
- popullatat e peshkut, duke përfshirë speciet shtegtare me vlera komerciale, janë në rënie, ndoshta pjesërisht për shkak të numrit të madh të peshkatarëve aktive që përdorin metoda të paligjshme të tilla si shoku elektrik dhe kurthet e peshqve, dhe pjesërisht për shkak të ndotjeve të lokalizuara dhe shkatërrimin e habitateve;
- prerja me tepricë e pemëve, mbi-kullotja, dhe praktikatat shkatërruese të ndërtimit kanë eliminuar apo degraduar amortizuesin vegetativ.

Me zbatimin e moratoriumit të gjuetisë në tokë është përmirësuar ndjeshëm popullata e shpendëve banorë tradicionalë të zonës përreth liqenit. Ende mbetet problem prerja pa kriter e bimësisë përreth dhe peshkimi. I njëjti studim ka konstatuar se ndotja organike që vjen nga derdhjet e ujërave të zeza të fshatrave e qytezave përreth liqenit është faktori i dytë më i rëndësishëm për ndotjen e ujërave të liqenit pas ndotjes së shkaktuar nga ndotja kimike që vjen nga fabrikat si Kombinati i Aluminit Podgoricë (PAC) dhe Rafineria e Çelikut Nikshiq.

Përveç institucioneve kombëtare të cilat kanë kompetenca të përgjithshme mbi liqenin në lidhje me zhvillimin dhe mbrojtjen, zona është gjithashtu nën përgjegjësinë e bashkive/komunave, ku ndodhen pjesët e zonës së Liqenit të Shkodrës: Shkodër, Koplik, Rrethina, Gruemirë, Kastriot dhe Qendër. Përveç institucioneve shtetërore, aktorë të rëndësishëm në rregullimin e kësaj hapësire janë ndërmarrjet dhe agjencitë publike, organizatat joqeveritare, organizatat ndërkombëtare dhe sektori privat (sipërmarrës) në rritje.

Dy nga objektivat kryesore të Planit të Menaxhimit të Rezervatit Natyror të menaxhuar të Liqenit të Shkodrës kanë qenë:

1) *Mbështetja e përdorimit të qëndrueshëm të zonës së liqenit: peshkim, pylltari, bujqësi organike, blegtori, eko-turizëm, bimë mjekësore, punë artizanale dhe prodhime të tjera tradicionale me fokus si më poshtë:*

- a) Përgatitja dhe/ose përshtatja e strategjive, planeve (planeve menaxhuese, planeve të veprimtimit), rregullimeve dhe marrëveshjeve specifike për secilën nga aktivitetet kryesore ekonomike.

- b) Të garantohet që përdorimi i ZM nuk do të ndikojë negativisht në shëndetin dhe mirëqenien e mjedisit natyror, banorëve dhe vizitorëve.
- c) Promovimi i Liqenit të Shkodrës si një nga atraksionet turistike parësore në rajon.

2) *Përmirësimi i informacionit, promovimit, edukimit dhe forcimit të marrëdhënieve të komunitetit për menaxhimin e liqenit. me fokus në:*

- a) Ofrimi i mjediseve, shërbimeve dhe informacioneve për të përmirësuar eksperiencën e vizitorit brenda ZM si dhe për të rritur mirëkuptimin dhe vlerësimin e vizitorit për vlerat natyrore dhe kulturore të liqenit të Shkodrës.
- b) Njohja e rëndësisë së Liqenit të Shkodrës nga komuniteti si dhe të nxitet pjesëmarrja e tij në menaxhimin efikas, mbrojtjen dhe zhvillimin e ZM.

Fshatrat e ZF Malësi e madhe që ndodhen përreth liqenit (Komunat Qendër, Gruemirë, Kastrat) janë:

Fshatrat (Kamicë-Flake, Jubicë, Stërbeq, Kalldrun, Gril, Shtoj, Dobër, Vukpalaj, Kosan) ndodhen kryesisht në një distancë prej 1-2 km nga bregu i liqenit, që do të thotë se nuk kanë një ndikim të ndjeshëm.

Aktivitetet kryesore janë bujqësia, blegtoria, peshkimi, dhe disa bar-restorante në buzë të liqenit (Stërbeq).

Bregu përtej liqenit (i njohur me emrin “Buza e Ujit”), në kontrast me bregun e këtejshëm, ka një sipërfaqe bujqësore të konsiderueshme e cila është mjaft e përshtatshme për kultivimin e bimëve bujqësore, sidomos të perimeve, duhanit, foragjereve, vreshtarisë, bimëve eterike, etj. Kohët e fundit është zhvilluar shumë edhe blegtoria (gjedhët). Fshatrat, të cilët janë vendosur pranë njëritjetrit pothuajse në një linjë me bregun, shëmbëllojnë si lagje të një bregu gjigand. Këto fshatra përshkohen vertikalisht nga një rrugë e re dhe e drejtë. Rrugët gjarpërojnë përmes shtëpive të vjetra dy katëshe të ndërtuara me gurë me një arkitekturë karakteristike tradicionale për rrethin e Malësisë së Madhe.

Kosani: një fshat i vogël me disa shtëpi, ndodhet në një fushë rreth 1 km nga bregu dhe me të njëjtën largësi nga Kastrati që ndodhet në kodrat përreth. Banorët në këtë zonë merren kryesisht me blegtori (gjedhë), sidomos me lopë. Ata merren gjithashtu me peshkim për shkak të afërsisë me bregun e liqenit. Në mbasdite, peshkatarët drejtojnë varkat në liqen për të hedhur rrjetat, kthehen në fshat dhe dalin përsëri me varkë mëngjesin tjetër për të mbledhur rrjetat.

Flaka: ndodhet pranë Kosanit dhe ka pothuajse të njëjtat karakteristika si Kosani përveçse është më i hapur dhe më i populluar. Shtëpitë janë të vendosura në grupe, pranë njëra-tjetrës, në mes të fushës duke zbritur për nga liqeni. Gjatë reshjeve të shiut, uji mbulon pak nga pak luginat dhe disa prej shtëpive. Pylli me drurë të lartë dhe të hollë e bën bregun e liqenit më atraktiv. Në këtë fshat gjenden disa varka peshkimi të përdorura për peshkim.

Kamica: është një nga fshatrat më të mëdhenj në bregun lindor. Aty ka shtëpi të vjetra prej guri dhe midis tyre shtëpi të reja të ndërtuara kohët e fundit me çati të kuqe me majë, mure me ngjyra


të ndezura dhe parmakë të bardhë. Ka edhe rrugë anësore të cilat shkojnë poshtë në liqen. Në lugina gjenden mjaft dele dhe lopë. Pylli i përmbatur ka drurë të hollë, duke krijuar në këtë mënyrë hapësira për varkat e vogla të peshkimit. Ky fshat është i njohur për prodhimet blegtorale. Kuzhina tradicionale konsiston në disa gjellë me mish dhe peshk të pjekur, krem të freskët dhe perime të shoqëruara me raki dhe verë shtëpie.

Jubica: është zgjatim i fshatit të Kamicës. Gjatë viteve të fundit është ndërtuar një kishë e mrekullueshme në anë të rrugës me arkitekturë të këndshme dhe kullë elegante. Shumë shtëpi të reja janë ndërtuar, duke krijuar një miksturë me ato të vjetra dhe që së bashku me vathet, depozitat e ujit, mjetet e peshkimit dhe mullarët me kashtë krijojnë një mozaik tërheqës për turistët e huaj.

Stërbeq: është një fshat tjetër përgjatë bregut me shtëpi të bukura. Bregu i liqenit mbulohet nga një shtresë shelgu më pak të dendur dhe drurë të tjerë ujorë. Varka të reja me ngjyra të shndritshme kanë zëvendësuar varkat e zeza tradicionale. Baret dhe restorantet janë ndërtuar përgjatë bregut, dhe shërbejnë produkte vendase si peshku, mishi, djathi, rakia, vera, etj.

Kalldrën: Fshati i Kalldrunit është lokaliteti më i vjetër në bregun e liqenit dhe ndodhet në mes të ujërave dhe maleve të thepisura. Sipas të dhënave arkeologjike, në atë vend ekzistojnë shenja dhe gjurmë nga vendbanimet e hershme romake (II-IV E.R.). Banorët merren kryesisht me bujqësi (misër, duhan, foragjere, perime dhe vreshtari). Fshati ka disa kantina që merren me prodhimin e verës dhe rakisë nga rrushi vendas, i cili ka vlera dhe cilësi të lartë. Gjithashtu, ekziston edhe një traditë për peshkim dhe gjuetinë e shpendëve të egër. Në vitet e fundit është dalluar një rritje progresive ekonomike, megjithëse një faktor tjetër i rëndësishëm janë edhe të ardhurat nga emigrantët.

#### Harta 10: Zona Liqenore e Malësisë së Madhe



Burimi: Plani Manaxhimit Liqenit Shkodër

Gjenerimi i qëndrueshëm i të ardhurave është një sfidë me të cilën duhet të përballet RNMLSH për të balancuar dhe mbrojtur shfrytëzimin e burimeve natyrore të liqenit. Bazuar në anketat me banorë të zonës, peshkimi dhe turizmi konsiderohen si fushat me aktivitet potencial. Turizmi shihet si një fushë e rëndësishme për planifikimin e ardhshëm të qytetit të Shkodrës. Por modelet aktuale të turizmit që janë ndjekur deri tani janë problematike për mjedisin.

Turizmi ende konsiderohet si zgjidhja e të gjitha problemeve ekonomike për shkak të mungesës së eksperiencës dhe të mos kuptuarit e tij. Zhvillimi i qëndrueshëm i zonës kërkon planifikim të kujdesshëm, bashkëpunim ndërmjet aktorëve për krijimin dhe nxitjen e burimeve alternative të të ardhurave dhe aktiviteteve ekonomike.

### ***Infrastruktura***

Siç u përmend dhe më sipër, përmirësimi i infrastrukturës së transportit ka qënë vitet e fundit objekt i investimeve publike nga pushteti vendor. Lidhja mes komunave dhe qytetit të Shkodrës, por edhe lidhja mes fshatrave kryesorë është përmirësuar ndjeshëm. Veçanërisht i rëndësishëm ka qënë rindërtimi i rrugës deri në Tamarë dhe në fshatin Razëm.

Zhvillimi i mëtejshëm i aksesit dhe transportit në rajone me potencial turistik është një nga objektivat e shprehur në Draft SKTSH 2014-2020; masa strategjike për zhvillimin e turizmit natyror dhe rural planifikohet të mbështeten nga rreth 600,000 EUR<sup>15</sup>.

Sa i përket shërbimit shëndetsor, aktualisht në Kelmend ka dy qendra mjeksore dhe në Tamarë dy mjek janë në gatishmëri 24 orë në ditë.

Aktualisht, bujtinat dhe hotelet kanë veprimtari vetëm gjatë sezonit veror; turizmi dimëror, veçanërisht në Alpe, është ende i pashfrytëzuar për shkak të mungesës së infrastrukturës së nevojshme: (i) ngrohja është një nga disavantazhet kryesore, pasi shtëpitë e bujtinat në eri kanë një vatër vetëm në dhomën kryesore: (ii) shërbimi i largimit të dëborës nga njësitë vendore nuk është i plotë dhe pajisjet shpesh mungojnë; (iii) ambulancat që janë në gatishmëri zakonisht nuk janë të përshtatshme edhe për rrugë malore.

Mungojnë ose janë shumë të pakta rrugët që lidhin rrugën kombëtare Shkodër – Hani Hotit me liqenin e Shkodrës, kjo e ka e penguar aksesin e të interesuarve, por ka penguar edhe interesimin e bizneseve vendase dhe të huaja. Në bregun e liqenit ka vetëm ndonjë inisiativë sipërmarrëse të izoluar që ofron akses në ujërat e Liqenit. Me ndërtimin e rrugëve të aksesit këto inisiativa mund të shtohen, por duhet patur kujdes që gjithçka të ndërtohet sipas planeve rregulluese që respektojnë ekosistemin dhe faunën dhe janë në harmoni të plotë me zonat e mbrojtura.

Një çështje veçanërisht e ndjeshme, janë shtëpitë me çati të ndërtuar me eternit (me baze asbesti), një material i cili është përdorur gjerë në dekadat e mëparëshme në ndërtim, por që më vonë është vlerësuar i dëmshëm për shëndetin e njerëzve që ekspozohen direkt me të gjatë punës ose dhe gjatë jetesës në shtëpi. Në Kelmend, gjenden sot 105 shtëpi me çati të ndërtuara nga ky material. Nëse zona funksionale synon zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm, por jo vetëm, dhe veçanërisht sigurimin e shëndetit të banorëve të këtyre objekteve, duhet të marrë masa sa më parë të jetë e mundur për zëvendësimin e këtyre çatave me eternit me çati të tjera me materiale tradicionale ose bashkëkohore.

---

<sup>15</sup> Ibid, page 24

Kjo është një çështje emergjente dhe zona duhet të konsiderohet si një hot – spot mjedisor dhe një prej prioriteteve për njësinë e re vendore dhe Qeverinë. Në kushtet e një buxheti të kufizuar të njësisë vendore, autoritetet e zonës funksionale dhe Ministria e Mjedisit duhet të llojnë për të gjetur burime financimi dhe projekte nga donatorë të ndryshëm që, në bashkëfinancim me banorët që jetojnë në këto kushte, ta ndryshojnë sa më shpejt këtë situatë. Depozitimi i materialit eternit duhet të bëhet në venddepozitime të parashikuara nga ligji për materialet e dëmshme për shëndetin e njerëzve.

### ***Rekomandime***

*Në përgjithësi*, sektori i turizmit duhet të zhvillohet më së miri në rajonin e Malësisë së Madhe si një i tërë, ku paketat turistike të përfshijnë një sërë pikash turistike duke filluar nga bregu i Liqenit të Shkodrës deri në fshatrat malorë dhe Alpet e pjesës më veriore të vendit. Një vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet bregut të Liqenit, zonë natyrore e mbrojtur, përfshirë në listën e konventës “Ramsar”, e lënë gjatë këtyre viteve në harresë.

Pjatat tradicionale dhe ushqimet natyrore kanë nevojë të promovohen si pjesë plotësuese e vizitave turistike.

Nxitja e fermerëve për kultivimin e produkteve vendase e natyrore bujqësore si dhe për prodhimin e produkteve blegtorale gjithashtu tradicionale është një element i rëndësishëm singërgjiejë mes dy sektorëve të analizuar.

Për turizmin natyror e rural, rrugët e biçikletave apo / dhe shtigjet të cilat të lidhin fshatrat apo pikat kryesore turistike janë një investim i rëndësishëm që rrit mundësinë e shfrytëzimit të potencialit të zonës së Malësisë së Madhe si e tërë.

Në këtë kuadër, është e nevojshme që:


1. Të hartohet një plan i integruar për zhvillimin e turizmit i cili të sigurojë ofertë të plotë turistike dhe që do të lidhë liqenin – zonën rurale – alpet gjë që i jep Malësisë së Madhe një avantazh unik në tregun e turizmit në Shqipëri.

Ndër prioritetet kryesore të këtij plani duhet të jenë:

2. Zonimi funksional për zhvillimin e turizmit sipas potencialeve në këtë zonë:
  - a. Liqenor,
  - b. Rural,
  - c. Malor.
3. Planifikimi përmirësimit të infrastrukturës në raport me zonimin funksional për zhvillimin e turizmit në mënyrë që të aksesohen atraksionet turistike,
4. Ngritja e infrastrukturës lundruese në bregun e liqenit të Shkodrës me qëllim shtimin e aktiviteteve argëtuese për pushuesit,
5. Rritja e kapaciteteve pritëse duke synuar dhe lehtësuar ndërtimin e një resorti dimror dhe kushte për zhvillimin e sportit të skive dhe argëtimit në kushte dëbore,
6. Përmirësimi i sinjalistikës rrugore dhe të objekteve të atraksionit turistik,
7. Vendosja e standardeve të sigurisë dhe të shëndetit në bujtina dhe restorante,

8. Ndërtimi i një sistemi të sigurtë dhe funksional për emergjencën shëndetsore, si dhe, por jo e fundit,
9. Hartimin e nje strategjie marketimi për ofertën turistike të zonës

**Harta 11: Harta turistike Kelmend**



Burimi: Komuna Kelmend



### **3. Hartëzimi i shërbimeve publike të zonës funksionale Malësi e Madhe**

#### **3.1. Ujësjellës Kanalizime**

##### **Furnizimi me ujë**

Territori i zonës funksionale Malësi e Madhe mbulohet me shërbimin e furnizimit me ujë nga Shoqëria Aksionere Ujësjellës Kanalizime Malësi e Madhe lincensuar nga Enti Rregullator i Ujit në vitin 2014. Kjo Shoqëri është krijuar në fund të vitit 2013 si rezultat i bashkimit të dy shoqërive ekzistuese: SHAU Malësi e Madhe dhe SHAU Shkodër Fshat. Shoqëria e re është lincensuar edhe për shërbimin e largimit të ujërave të ndotura, licencë e cila nuk disponohej më parë nga asnjëra prej shoqërive përbërëse.

Entiteti i ri me emrin SHAUK Malësi e Madhe ka akionerë 18 njësi ekzistuese të Qeverisjes Vendore, 6 nga të cilat janë njësitë vendore përbërëse të zonës funksionale Malësi e Madhe.

Të dhënat e para të marra nga menaxhimi i SHAUK Malësi e Madhe paraqesin këta indikatorë shërbimi për të gjithë zonën e mbuluar nga kjo ndërmarrje (18 njësi vendore):

##### **Mbulimi me shërbim**

1. Rreth 75 % e rreth 320 fshatrave nën juridiksion furnizohen me ujë nga SHAUK Malësi e Madhe
2. Kohëzgjatja e furnizimit me ujë është 8 - 15 orë në ditë. Në zonat ku operojnë sisteme furnizimi me vetërrjedhje ka 24 orë furnizim.

##### **Përshkrimi i burimeve dhe gjendjes së infrastrukturës**

Vendodhja e burimeve është e vështirë të përcaktohet saktë sepse në zonën e shërbimit të SHAUK Malësi e Madhe ka shumë burime natyrore një pjesë e të cilave janë pothuajse në përdorim individual të disa fshatrave të zonave malore. Disa nga burimet kryesore jepen në vijim:

*Burimi i Rrjollit* i cili është më i madhi në zonën e shërbimit të SHAUK Malësi e Madhe dhe më i rëndësishmi për ZF Malësi e Madhe.

*Si pjesë të ZF Malësia e Madhe*, komunat Kastrat dhe Kelmend si dhe një pjesë e komunës Shkrel furnizohen me sisteme lokale me rrjedhje të lirë nga burime lokale dhe në disa raste përdorin stacione pompimi të SHAUK Malësi e Madhe. Nuk ka informacion për sisteme matësash, tarifimi dhe faturimi në sistemet e pavaruara që funksionojnë në këto NJQV.

Gjendja e rrjeteve ekzistuese të tubacioneve dhe e rezervuarëve vlerësohet e mirë ose e kënaqshme.

Numri i kontratave të lidhura aktualisht me përdoruesit është në të gjithë zonën e shërbimit të SHAUK MA është mbi 7,000.

## Menaxhimi i shërbimeve në Zonën e Shërbimit të SHAUK Malësia e Madhe (e re)

Indikatorët e mëposhtëm japin një pajme të përgjithshme të menaxhimit të shërbimit të ujësellsit nga SHAUK Malësi e Madhe në zonën e bashkuar nga SHAU Shkodër Fshat dhe SHAU Malësia e Madhe. .

1. Vëllimi i ujit të prodhuar me rrjedhje të lirë është 51,000 m<sup>3</sup> / muaj.
2. Vëllimi i ujit të prodhuar me sistem me ngritje mekanike është 40 000 m<sup>3</sup> / muaj.
3. Vëllimi i ujit të pamatur (pa matësa në popullatë) është 61,500 m<sup>3</sup> / muaj.
4. Vëllimi i ujit për të cilin arkëtohen të ardhura pa debitor është 50 000 m<sup>3</sup> / muaj.
5. Çmimi i ujit (pa T.V.SH) është 50 lekë / m<sup>3</sup>.

Këto të dhëna nuk disponohen të ndara për njësitë që përbëjnë ZF Malësia e Madhe.

Në terma të përgjithshëm, të ardhurat nga dhënia e shërbimit përmes kontratave arrijnë të mbulojnë deri 60% të kostove operative. Kostot të shërbimit të furnizimit me ujë nuk përfshijnë në një masë të ndjeshme energjinë elektrike të stacioneve të pompimit duke qënë se burimet kryesore – ndër të cilët Burimi i Rrjollit - janë me rrjedhje të lirë. Rjedhimisht raporti i ulët të mbulimit të kostove të shërbimit i detyrohet arkëtimit të ulët të tarifës së ujit ndër banorët.

### Mbulimi me shërbim në ZF Malësia e Madhe

Një qasje më e saktë ndaj cilësisë së shërbimit për territorin e ZF Malësi e Madhe jepet nga treguesit e performancës së ish SHAU Malësi e Madhe për vitin 2013 zona e shërbimit të të cilës përputhej me territorin e ZF Malësi e Madhe.

Treguesit e performancës për SHAU-të përbërëse janë ndër më të ultët për kategorinë përkatëse (kategoria më pak se 3,000 kontrata). Edhe pse me tregues pozitivë në drejtim të raportit midis të ardhurave dhe kostove operative SHAU Malësi e Madhe ka vuajtur pasojat e nivelit të ulët të ujit të faturuar, ujit të matur si dhe ujit të arkëtuar të cilat kanë ndikuar performancën totale të kësaj SHAU.

**Tabela 17: Treguesit e Performancës për vitin 2013, SHAU Malësi e Madhe, SHAU Shkodër Fshat**

	Nr. Kontratave	Mbulimi kostove O&M	Mbulimi kostove totale	Norma e arkëtimit	Uji i pa faturuar	Kohëzgjatja e furnizimit me ujë	Piket totale te performaces (max 100)
<i>SHAU Malësi e Madhe</i>	2 093	120%	60%	50%	75%	6	19.62
<i>SHAU Shkodër Fshat</i>	2 287	40%	25%	55%	59%	15	33.69

Burimi: Enti Rregullator Ujit, Raporti i Performancës për SHAUK, 2013

SHAUK Malësi e Madhe ka për qëllim përmirësimin e shërbimit ndër vite duke synuar:

- a. shtimin e zonës së mbulimit,
- b. rritjen e numrit të kontratatve,
- c. uljen e lidhjeve të paligjshme,
- d. rritjen e sasisë së faturuar të ujit,
- e. rritjen e arkëtimeve,
- f. përdorimin me efikasitet të burimeve duke zgjedhur rënien e lirë kundrejt pompimit sa herë që është e mundur.

Përpos synimeve ambicioze për ta rritur numrin e kontratave në 12,000 SHAUK e krijuar është në pamundësi financiare për të bërë investime të reja me qëllim shtrirjen e përmirësimin e shërbimit, shtimin e matësive dhe integrimin e sistemeve lokale në rrjetin kryesor.

Investimet e reja varen tërësisht nga qeveria qendrore dhe donatorët e huaj të cilat kushtëzohen me një nivel të caktuar performance dhe me një menaxhim të qëndrueshëm dhe efikas.

Vendimmarrja në Bordin drejtues të SHAUK me përfaqësues të 18 njësive vendore aktuale është e vështirë dhe për pasojë edhe menaxhimi.

Një pjesë e njësive vendore në disa zona malore të Malësisë së Madhe si *Komuna Kelmend*, *Komuna Shkrel*, *Komuna Kastrat*, *Komuna Qender* nuk paguajnë kostot e energjisë për përdorimin e stacioneve të pompimit pronë e SHAUK Malësi e Madhe të cilat janë në funksion të sistemeve lokale të furnizimit me ujë. Këto sisteme janë të pa integruara në skemën e përgjithshme të menaxhimit të SHAUK së licensuar.

### **Shërbimi i mbledhjes së ujit të ndotur (kanalizime)**

#### **Situata aktuale**

- Për herë të parë në vitin 2014, SHAUK është pajisur me një licenca për shërbim e ujrave të ndotura. Për rrjedhojë nuk ekzistojnë të dhëna statistikore historike për këtë shërbim.
- Pohohet ekzistenca e tubacioneve në qendër të Koplikut por nuk ka një hartë dhe inventarizim të këtij rrjeti. Në fshatra ky shërbim bëhet me gropa primitive dhe kanalizime të improvizuara, pa standarte dhe me pasoja në mjedis (sensitive për ndotjen e lumenjve e të liqenit dhe me pasoja të mundshme për shëndetin e për turizmin).
- Velipoja është qyteti i parë brenda zones së shërbimit të SHAUK Malësi e Madhe që paiset me kanalizime dhe me sistem trajtimi ujërash të ndotur (investim i BE).
- Kostot e mbajtjes në punë të sistemit të trajtimit të UN janë të larta dhe do ta rëndojnë situatën financiare të SHAUK nëse nuk aplikohen tarifa për këtë shërbim. Zona Funktionale Malësi e Madhe aktualisht nuk është e lidhur dhe nuk përfiton shërbimin e këtij impianti.

## Rekomandime

Në vijim, rekomandojmë që autoriteti i ZF, për së pari:

1. *Të themelojë dhe të liçensojë një ndërmarrje e cila të marrë në dorë administrimin e shërbimit të furnizimit me ujë dhe grumbullimin e largimin e ujrave të ndotur në të gjithë territorin e ZF, dmth: një ZF - një entitet;*

Avantazhet

- a. Menaxhim i thjeshtuar dhe me përgjegjesi të drejtpërdrejtë tek drejtuesi vendor (një NJQV aksionere e vetme e entit),
  - b. Vendimmarrje e lehtë dhe në interes të banorëve,
  - c. Partneritet më i besueshem me investitorët e huaj,
  - d. Komunikim dhe marrëdhënie të thjeshtëzuar dhe të qëndrueshme me pushtetin qendror,
  - e. Unifikim i shërbimit në të gjithë Zonën Funktionale në parametrat e aksesit në shërbim, standarde të tarifa,
  - f. Mundësi për pjesët më pak të zhvilluara të ZF për të përfituar shërbim cilësor.
2. *Të inventarizojë asetet e SH.A Ujësjellës Kanalizime brenda territorit të Malësisë së Madhe dhe gjithashtu të konsolidojë të dhënat mbi shërbimin;*

Njohja më e thellë e situatës së ofrimit të shërbimit është e nevojshme për Bashkinë Malësi e Madhe pasi shume të dhëna mungojnë ose janë mbi bazë hamendësimi. Kjo njohje do të vijë sipas rendit si më poshtë rekomandohet:

### I. Furnizimi nëpërmjet sistemeve të centralizuara

- a. Identifikimi i burimeve ujore, tipi, sasia e ujit, vendndodhja,
- b. Identifikimi popullsisë në fshatra/kytet që mbulohen me shërbimin e furnizimit me ujë nëpërmjet sistemeve të centralizuara,
- c. Tipi i sistemeve të centralizuara (me vetrirjedhje dhe / ose me ngritje mekanike).
- d. Personeli i angazhuar sipas kategorise së punës,
- e. Matja e sasisë së shërbimit përfshirë, kohëzgjatja e furnizimit me ujë për çdo sistem.

### II. Identifikimin e popullsisë në fshatra/kytet që mbulohen me shërbimin e furnizimit me ujë direkt nga burimet natyrore dhe identifikimi i këtyre burimeve.

### III. Hedhja e të dhënave në GIS.

Në kuadër të organizimit dhe funksionimit të një ndërmarrje të re, detyra të tjera do të merren në konsideratë menjëherë, përfshirë, por jo duke u limituar ne sa me poshte rekomandohet:

3. *Hartimi i Planit të Investimeve Kapitale, afatshurter, afatmesem dhe afaatgjate, në përputhje me burimet aktuale të finacnimit si dhe me Masterplanin e Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve të Shqipërisë;*
4. *Llogaritjen e kostove dhe tarifave;*
5. *Vendosjen e nje sistemi faturimi dhe arketimi per te ardhurat;*
6. *Një sistem të vazhdueshëm për ngritjen e kapaciteteve të burimeve njerzore;*
7. *Të gjitha këto kërkesa për të dhëna janë të vlefshme edhe për sistemin e kanalizimeve të ujrave të zeza.*

### 3.2. Menaxhimi i mbetjeve

Shërbimi i menaxhimit të mbetjeve në të gjitha njësitë vendore të Malësisë së Madhe, ofrohet aktualisht në mënyrë të kufizuar ose shumë të kufizuar: shpeshësia e mbledhjes është e ulët në pjesën më të madhe të zonës, mbulimi nuk është i plotë, nuk kryhet trajtim i mbeturinave në vendin e depozitimit si dhe ndarja në burim apo riciklimi i tyre nuk zbatohet. Këto mangësi vijnë për shkak të mungesës së një plani, por edhe të mjeteve, pajisjeve, kapaciteteve të menaxhimit dhe, para së gjithash, të fondeve e investimeve publike. Shërbimi ofrohet nga njësitë vendore me punonjës dhe mjete të veta; vetëm në pak raste, shërbimi është ofruar me nënkontraktim.

Përshkrimi i shërbimit të mbetjeve për secilën njësi vendore është përmbledhur në formë tabelare në Tabelen 16 ndërsa pikat kryesore shtjellohen në vijim:

Bashkia Koplík ka në pronësi 100 kazanë, një kamion grumbullimi me vetëshkarkim 7 ton, një mjet transporti 7 ton dhe një fadromë. Mbeturinat urbane grumbullohen një herë në dy ditë, çdo ditë prej 50 kazanëve - në përshtatje me kapacitetin e kamionit; mbeturinat inerte grumbullohen 1 herë në javë me fadromë, ditën e dielë. Mbeturinat transportohen në një vend depozitimi të hapur të zonës, ku nuk kryhet asnjë trajtim i tyre, përveç djegies në disa raste. Me këtë shërbim vlerësohet të mbulohen të gjitha bizneset dhe rreth 90 % e familjeve; pjesa e mbetur janë familjet e zonave më periferike, ku për shkak të infrastrukturës së keqe, nuk kryhet grumbullim i drejtpërdrejtë i mbeturinave me kamionë por ato iu bashkohen kazanëve të pikave më të afërta nga vetë banorët.

Komuna Shkrel në vitin e fundit, ka nënkontraktuar shërbimin e menaxhimit të mbetjeve. Në pronësi të saj Komuna ka 96 kazanë dhe një kamion. Shërbimi mbulon 6 nga 14 fshatra, me shpeshësi afërsisht 2 herë në javë, dhe mbetjet depozitohen në të njëjtinë vend të hapur me Bashkinë Koplík.


Komuna Kastrat ofron shërbimin e menaxhimit të mbetjeve përmes 220 kazanëve, një kamion 4-5 ton, me një shpeshësi 2 herë në javë, duke arritur të mbulojë afërsisht 10 nga 13 fshatrat që Komuna përfshin. Mbetjet depozitohen në vend të veçuar depozitimi, të hapur, dhe ku nuk kryhet trajtim i mëtejshëm i tyre.

Komuna Kelmend ofron aktualisht shërbimin e mbetjeve, grumbullimi kryehet me kosha, gjithsej 30 të tillë, me shpeshësi 2 herë në muaj, duke mbuluar nevojat e qendrës Tamarë dhe fshatrave

Lëpushë e Selcë, të cilat përbëjnë rreth 50-60 % të banorëve gjithsej të Komunës. Mbetjet depozitohen përsëri në vende të hapura depozitimi dhe mbulohen.

Në Komunat Gruemirë dhe Qendër shërbimi i menaxhimit të mbetjeve nuk kryhet fare ose është tepër i kufizuar. Mjetet dhe pajisjet mungojnë, si dhe gjithashtu mungojnë punonjës të specializuar. Komuna Qendër ka blerë së fundi 40 kazanë, të cilët pritet të vihen në përdorim gjatë vitit 2015.

**Harta 12: Mbulimi aktual i popullsisë me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve në ZF MM**



Burimi i hartës: Autori

**Tabela 18: Përmbledhja e të dhënave për shërbimin e pastrimit në NjQV-të e ZF**

<b>Menaxhimi i mbetjeve</b>	<b>Bashkia Koplík</b>	<b>Komuna Kastrat</b>	<b>Komuna Kelmend</b>	<b>Komuna Shkrel</b>	<b>Komuna Gruemirë</b>	<b>Komuna Qendër</b>
Popullsia <sup>16</sup>	10 968	11 973	6 257	5 891	12 658	5 864
% e popullatës që merr shërbim	90	9-10 nga 13 fshatra	50-60% (Tamarë, Selca, Lepusha)	6 nga 14 fshatra	20	
<i>% zona periferike të cilat nuk kanë kazanë, mbetjet I bashkohen pikave ku ka kazanë.</i>	10					
<i>% e bizneseve me shërbim</i>	100	nuk bëhet dallim	nuk bëhet dallim		50	
<i>Gjenerimi i mbetjeve nga kg/banorët/ditë</i>	0.6	0.33-0.5		0,4		
<i>Gjenerimi i mbetjeve kg/biznes/ditë</i>	1.2					
<i>Gjithsej njësia vendore ton/ditë</i>	7.2	5.0	2.6	2.5	5.3	2.4

Burimi: Njësitë e Qeverisjes Vendore

Nga tabela më sipër, duke pranuar një mesatare për gjenerimin e mbetjeve prej 0,42 kg/banor/ditë e gjithë ZF, në kushtet e një mbulimi të plotë me shërbim do të gjenerojë rreth 25 ton/ditë.

Në tabelat e mëposhtme paraqiten tarifat e shërbimit të mbetjeve që janë zbatuar gjatë vitit të fundit në secilën njësi vendore si dhe kosto e këtij shërbimi. Tarifat nuk mbulojnë koston e dhënies së shërbimit publik, dhe në disa raste si për Komunën Kelmend, Qendër e Kastrat, traifat për familjet janë shumë të ulta për arsye të aftësisë pagueese të ulët në këto zona. Bashkia Koplík arkëton rreth 60 % të të ardhurave nga tarifat; mund të përafrojmë të njëjtën shkallë arkëtimi edhe për komunitat e tjera për të cilat mungon informacioni i saktë.

Komuna Shkrel, e cila ka nënkontraktuar shërbimin e mbetjeve për vitin 2014, nuk ka zbatuar tarifa ndaj familjeve dhe bizneseve. Të dhënat e koston janë të përafuara dhe duhet të përdoren me kujdes.

**Tabela 19: Tarifat e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve në NJ.Q.V-të e ZF Malësi e Madhe**

<b>Tarifa e shërbimit 2014 (lekë/vit)</b>	<b>Bashkia Koplík</b>	<b>Komuna Kastrat</b>	<b>Komuna Kelmend</b>	<b>Komuna Shkrel</b>	<b>Komuna Gruemirë</b>	<b>Komuna Qendër</b>
<i>për familje</i>	1,500	600	100	-	1,200	500
<i>për biznes të vogël</i>	3,000	8,400	6,000	-	4,000	1,500
<i>për biznes të madh</i>	60,000		30,000 - 50,000	-	60,000	20,000 - 50,000

Burimi: Njësitë e Qeverisjes Vendore

<sup>16</sup> Sipas Regjistrimit të Gjendjes Civile

**Tabela 20: Kosto e shërbimit të mbetjeve në NJ.Q.V-të e ZF Malësi e Madhe**

Kosto e shërbimit 2014 (lekë/vit)	Bashkia Koplik	Komuna Kastrat	Komuna Kelmend	Komuna Shkrel	Komuna Gruemirë	Komuna Qendër
<i>Gjithsej</i>	3,120,000	800,000	1,956,000	1,600,000	n.a	300,000*

Burimi: Njësitë e Qeverisjes Vendore

\*Paguar gjithsej 2012-2013

### ***Integrimi i shërbimit***

Përdorimi më eficient e efektiv i mjeteve dhe pajisjeve të punës përmes shtrirjes së shërbimit në më shumë së një njësi vendore, mund të reduktojë koston e grumbullimit dhe të transportit të mbetjeve.

Integrimi i shërbimit të mbetjeve është një mundësi e vlerësuar tashmë nga njësitë vendore në bashkëpunim me CO-PLAN17. Kështu, është hartuar një skemë e dhënies së këtij shërbimi për Bashkinë Koplik së bashku me Komunat Qendër, Gruemirë dhe Shkrel.

Kjo skemë është zgjeruar këtu për **Komunën Kastrat dhe Komunën Kelmend** me të dhënat përkatëse të shërbimit që jepet aktualisht. Për të plotësuar treguesit që mungojnë, Komuna Kastrat është përafëruar me Komunën Gruemirë, e cila ka sipërfaqje dhe numër popullsie të ngashme, ndërsa Komuna Kelmend është përafëruar me Komunën Shkrel nisur nga ngjashmëria gjeografike/fizike dhe numri thuajse i njëjtë i popullsisë.

Shërbimi i integruar i mbetjeve për Malësinë e Madhe, sipas kësaj skeme, parashikon të kryhet me mjetet e mëposhtme:

- kazanë 1.1 m<sup>3</sup>, të shpërndarë sipas njërive si më poshtë,

Njësia vendore	Bashkia Koplik	Komuna Shkrel	Komuna Gruemirë	Komuna Qendër	<b>Gjithsej</b>
Kazanë 1.1 m <sup>3</sup>	87	97	95	40	<b>319</b>

- një makine teknologjike 10 ton e lartë
- një kamion 7 ton, në pronësi të Bashkisë Koplik
- një kamion 10 ton, në pronësi të Komunës Shkrel

<sup>17</sup> Studimi nga Co-Plan: Zhvillimi i bashkepunimit ndervendor për menaxhimin e mbetjeve në zonën e Malësisë së Madhe.



**Tabela 21: Mbulimi me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve në ZF Malësi e Madhe**

Nr.	NJ.Q.V.	Popullsia Gjendja Civile	Zona e mbuluar nga shërbimi	% e mbulimit	Shpeshtësia e largimit
1	Bashkia Koplik	10,746	Koplik	100%	7 herë/javë
2	Komuna Qendër	6,229	Dobrë, Bogicë+Polvar, Koplik i sipërm, Kalldrun, Stërbeq, Jubicë, Kamicë + Flakë	79%	3 herë/javë
3	Komuna Gruemirë	13,076	Gruemirë, Boric i Madh, Ktosh + Balshaj, Boric i Vogël, Grudë, Grill, Gjorm, Omaraj, Demiraj + Kcar + Cezmë, Rrashkullaj, Vorfë	90%	3 herë/javë
4	Komuna Shkrel (9 muaj)	6,271	Dedaj, Bzhetë, Zagorë, Bogë, Razëm + Vrith, Reç	56%	1 herë/javë
	Komuna Shkrel (3 muaj)				2 herë/javë
5	Komuna Kastrat*	11,994	9-10 fshatra nga 13 gjithsej	80%	3 herë/javë
6	Komuna Kelmend* (9 muaj)	6,239	Tamarë, Selcë, Lepushë	60%	1 herë/javë
	Komuna Kelmend* (3 muaj)				2 herë/javë
<b>ZF Malësi e Madhe</b>		<b>54,555</b>		<b>81%</b>	

Burimi: Bashkia Koplik, Co-Plan

\*Përafruar sipas shërbimit aktual

Meqënëse, zona e Shkrelit ka sezonin turistik gjatë 3 muajve të verës, për këtë periudhë skema parashikon gjenerim më të madh mbetjesh urbane dhe nevojën për një mbulim më të shpeshtë me menaxhimin e mbetjeve. Për të realizuar shërbimin shtesë, vlerësohet të nevojiten 56 kazanë të tjerë, rreth 60% më shumë se në muajt jashtë sezonit veror.

Me zgjerimin këtu të skemës, ky dallim është bërë dhe për zonën e Kelmendit, e cila është e ngjashme me Shkrelin lidhur me aktivitetin turistik veror.

**Tabela 22: Tregues të shërbimit të menaxhimit të mbetjeve në ZF Malësi e Madhe**



Nr.	NJ.Q.V.	Sasia e mbeturinave kg/frymë/ditë	Sasia e mbeturinave ton/javë	Shpeshtësia e largimit herë/javë	Numri i kazanëve 1.1 m <sup>3</sup>	Gjatësia e rrugës së grumbullimit nga kazanët deri në B. Koplík km/rrugë	Gjatësia e rrugës së transportit nga B. Koplík për në f.g km/rrugë	Koha e shkarkimit të kazanëve orë/javë	Koha e grumbullimit orë/javë	Koha e transportit orë/vajte-ardhje	Koha e shkarkimit të kamionit orë/kamion
1	Bashkia Koplík	0.70	52.66	7	87	4	6	25.4	0.9	0.12	0.25
2	Komuna Qendër	0.35	12.06	3	40	27.8	6	5.0	2.8	0.12	0.25
3	Komuna Gruemirë	0.35	28.83	3	95	45.5	6	11.9	4.6	0.12	0.25
4	Komuna Shkrel (9 muaj)	0.35	8.60	1	97	88.3	6	4.0	2.9	0.12	0.25
	Komuna Shkrel (3 muaj)	0.60	14.75	2	56		6	4.7	5.9	0.12	0.25
5	Komuna Kastrat*	0.35	23.51	3	95	45	6	11.9	4.5	0.12	0.25
6	Komuna Kelmend* (9 muaj)	0.35	9.17	1	97	88	6	4.0	2.9	0.12	0.25
	Komuna Kelmend* (3 muaj)	0.60	15.72	2	56		6	4.7	5.9	0.12	0.25
Koha e shkarkimit të një kazani 2.5 min Koha e shkarkimit të një kamioni 15 min Shpejtësia e mjetit gjatë grumbullimit 30 km/orë Shpejtësia e mjetit gjatë transportit 50 km/orë											
<b>ZF Malësi e Madhe</b>		<b>0.53</b>	<b>165.30</b>								

Burimi: Bashkia Koplík, Co-Plan

\*Përafruar sipas treguesve të Komunës Gruemirë dhe Shkrel, përkatësisht

Më poshtë paraqiten kostot e përlogaritura afërsisht të dhënies së shërbimit të integruar të mbetjeve në Malësinë e Madhe, sipas njësive vendore që ajo përfshin. Sa më i madh numri i popullsisë që mbulohet, pra sa më e madhe shtrirja e shërbimit, aq më e ulët është kosto e dhënies së tij. Nga përdorimi i mjeteve, pajisjeve dhe punonjësve të përbashkët, pritet që kosto vjetore për Malësinë e Madhe si e tërë të jetë më e ulët, çfarë synon dhe integrimi i shërbimit

**Grafiku 20: Kosto e vlerësuar e menaxhimit të mbetjeve të ZF Malësi e Madhe**



Burimi: Përlogaritje të autorit në bazë të metodologjisë nga DLDP

### Harta 13: Skemë e përgjithshme e grumbullimit të mbetjeve urbane nga ZF Malësi e Madhe



Burimi i hartës: Autori, të dhëna Bashkia Koplík

## Rekomandime

Problemet për ZF lidhen me dy çështje:

- *Zgjerimin e zonës së shërbimit, grumbullimin e mbetjeve nga të gjitha njësitë administrative (ish komunat dhe bashkia Koplík), dhe*
- *Transprotin dhe trajtimin përfundimtar të mbetjeve.*

1. Ndërsa sa i takon pikës 1 një zgjidhje e mundëshme është ajo sa është vlerësuar nga DLDP nëpërmjet studimit të Co-Plan për “Zhvillimin e bashkepunimit ndervendor për menaxhimin e mbetjeve”
2. Ndërsa për pikën 2 zgjidhja është Landfilli i çertifikuar më i afërt me Malësinë e Madhe në Bushat. Ky landfill ndodhet rreth 34 km larg Bashkisë Koplík, largësi është vlerësuar se sjell kosto shumë të larta të transportit të mbetjeve. Për këtë arsye, njësitë vendore në bashkëpunim me Co-Plan, konsiderojnë mundësinë e depozitimit të mbetjeve në një fushe grumbullimi për gjithë zonën funksionale të Malësisë së Madhe. Skema e propozuar për vitin 2015 parashikon depozitimin e mbetjeve në një fushë (gropë) me vendndodhje rreth 3 km larg qendrës Koplík, përgjatë aksit rrugor Shkodër-Han i Hotit, që ka një kapacitet kohor përdorimi deri në 30 vjet me rradhë. Nga ana tjetër, në këtë vend nuk parashikohet trajtim i mbetjeve të grumbulluara por vetëm depozitim të tyre, pra fusha e grumbullimit nuk do të kryejë funksionin e plotë të një landfilli.
3. Ne mendojmë se sa propozohet më sipër, nuk është një zgjidhje ekologjike dhe e qëndrueshme për shërbimin publik të menaxhimit të mbetjeve në Malësinë e Madhe. Organizimi i shërbimit me transportim drejt në landfillin e Bushatit duhet të bëhet mundësia e vetme për transportin dhe trajtimin e mbetjeve. Hapja e një venddepozitimi të ri të pakontrolluar apo edhe ndërtimi i një landfilli të ri në ZF të Malësisë së Madhe nuk do të ishte e rekomandueshme si për shkak të koston së madhe kapitale fillestare ashtu edhe për shkak të koston së lartë të operimit dhe ineficiences për një popullsi sa ajo e kësaj zone.
4. Sasia maksimale që mund të gjenerojë kjo zonë sikur shërbimi të mbulojë 100 % të territorit vlerësohet rreth 25 ton/ditë. Kjo sasi është e transportueshme me një mjet, me një rrugë në ditë, nga një pikë qendrore e ZF, rreth 30 - 35 km afër Koplíkut deri në landfill-in e Bushatit.
5. Por ndërsa njësa vendore do të zgjidhë transportin e mbetjeve në landfill, autoritetet në ZF duhet të kujdesen që banorët e saj, që në shumicë jetojnë në zonë rurale, të fillojnë menjëherë me kompostimin e mbetjeve organike dhe vecanërisht ato të oborrit në kushtë individuale ose grup familjesh. Një shëmbull të mirë mund të japin për këtë qëllim bujtinat apo shtëpitë pritëse të turistëve. Shtrirja e kompostimit do ta ulte ndjeshën sasinë e mbetjeve që kanë nevojë të transportohen në Bushat, ashtu si dhe koston apo “gate fee” që kjo njësi duhet të paguaj për trajtimin e mbetjeve.

6. Nga ana tjetër, zgjidhja me një *pikë të ndërmjetme grumbullimi* (apo ndryshe Stacioni Transferimi) është një mundësi e përshtatshme për ZF, duke marrë parasysh largësinë e kësaj pike diku ndërmjet Koplikut dhe Gruemirës dhe një distance prej rreth 30 – 35 km larg landfillit Bushat.
7. Për të realizuar këtë duhet e caktohet një pikë e përkohëshme për grumbullimin e mbetjeve në një kontenier të levizshëm me kapacitet 20 – 25 ton dhe një kokë kamioni i cili të transportojë një herë në dy ditë mbetjet e te gjithë ZF nga kjo pikë deri në landfill-in e Bushatit. Kësisoj kostot do të bëheshin të përbalueshme.
8. Megjithatë, në tre vjecarin e parë, në kushtet e një buxheti të kufizuar, sugjerohet që Qeveria Qëndrore të subvencionojë koston e transportit dhe të trajtimit (gate fee), ndërsa njësi vendore të hartojë një Plan për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve, të përqëndrohet në zgjerimin e zonës së mbulimit më shërbimin e grumbullimit të mbetjeve si dhe nxitjen dhe mbështetjen e kompostimit të mbetjeve organike dhe mbledhjen e mbetjeve me metoda te tjera alternative.

### 3.3. Rrugët, hekurudhat dhe transporti publik

#### Aksesi i zonës funksionale

Qendra e zonës funksionale Malësi e Madhe, Bashkia Koplik, lidhet me qytetet kryesore në drejtimin jug-perëndimor të vendit nëpërmjet rrugës ndërrbane kryesore. Kjo është rrugë e përfunduar në vitet e fundit, pra relativisht e re dhe në gjendje të mirë, gjë që lehtëson ndjeshëm lëvizjen e automjeteve përgjatë këtij drejtimi. Kështu, Bashkia Koplik ndodhet rreth 112 km larg kryeqytetit të vendit, Tiranës - të përshkueshme brenda një kohe prej përafërsisht dy orësh e gjysmë. Në këtë drejtim rruga kalon nga qyteti i Shkodrës dhe i Lezhës si dhe gjithashtu, përgjatë saj takohet me Autostradën Durrës-Kukës-Morinë (Rruga e Kombit), në largësi rreth 70 km nga pika Milot. Rruga ndërrbane kryesore vazhdon edhe më tej Tiranës në jug-perëndim të vendit, duke bërë të mundur lidhjen lehtësisht dhe me qytete të tjera.

Rruga kombëtare e segmentit Hani i Hotit – Shkodër, 39 km, cila e përshkon zonën dhe e lidh atë nga veriu në jug me rrjetin rrugor kombëtar.

Largësia nga Aeroporti Kombëtar Nënë Tereza në Rinas është rreth 100 km ndërsa ndaj Portit Durrës është rreth 125 km; të dyja këto infrastruktura janë të arritshme nëpërmjet rrugëve të shtruara e në gjendje shumë të mirë.

Pika kufitare më e afërt është Hani i Hotit, rreth 18 km larg Bashkisë Koplik në drejtimin veri-perëndimor të zonës funksionale, ndërsa pika kufitare e Vermoshit ndodhet rreth 80 km larg por arrihet me vështirësi pasi nuk lidhet ende me rrugë të asfaltuar.

Qendra e zonës funksionale Malësi e Madhe, duke qenë e shtrirë në pjesën më perëndimore të vendit, ka ndërlidhje të mirë me qytetet më të mëdha dhe infrastrukturat më kryesore përgjatë pjesës jug-perëndimore tij. Nga ana tjetër, në drejtim të veriut lidhja vështirësohet, me pika strategjike si Vermoshi por gjithashtu dhe me fshatrat më të thellë.

Linja hekurudhore Shkodër – Hani i Hotit me gjatësi 34 km e lidh këtë zonë me rrjetin kombëtar hekurudhor si dhe me atë ndërkombëtar nëpërmjet pikës kufitare të Hanit të Hotit nëpërmjet stacionit të ndërmjetëm në Bajzë.

Strategjia Sektoriale e Transportit 2008 – 2013 ka evidentuar se ndërprerja e transportit të mallrave me Malin e Zi nëpërmjet pikës së Hanit të Hotit është një prej faktorëve kryesor në rënien e volumit të përgjithshëm të transportit hekurudhor në Shqipëri. Megjithëse është kryer riparimi i kësaj linje në vitin 2002, volumi i transportit nëpërmjet kësaj linje është në ulje të vazhdueshme. Siç është theksuar edhe më sipër, rënie e volumit të transportit të mallrave, mungesa krahas rritjes së kostove të mirëmbajtjes e kanë ulur shumë rendimentin e këtij sektori deri në nivele të papërfillshme ose pothuaj mungesë totale të përdorimit.

### **Lëvizja brenda zonës funksionale**

Zona funksionale e Malësisë së Madhe aktualisht ka një rrjet të dobët rrugor. Fshatrat e thellë malorë janë të lidhur nga rrugë të paasfaltuara, dhe ndërlidhja e tyre me qendrat më të urbanizuara bëhet vazhdimisht më e vështirë gjatë dimrit. Arsyeja bazë e mangësive të rrjetit rrugor janë pamjaftueshmëria e fondeve të njësisve vendore, e cila vjen si pasojë e krijimit dhe arkëtimit në përgjithësi të ulët të të ardhurave nga taksat e tarifave vendore.

Në hartën në vijim paraqitet rrjeti i plotë i rrugëve ndërlidhëse të zonës funksionale, sipas kategorizimeve të tyre, duke dhënë një paraqitje të përgjithshme të infrastrukturës rrugore së tanishme që mundëson ndërveprimet ekonomike apo dhe ato shoqërore të njësisve vendore me njëra-tjetrën.

Harta 14: Infrastruktura rrugore e zonës funksionale Malësi e Madhe



Burimi: Ministria për Çështjet Vendore, Raporti i Zonave Funkcional

Rrjeti përbëhet nga *rruga interurbane kryesore* Shkodër - Hani i Hotit, nga *rrugët interurbane dytësore* të cilat zgjaten prej këtij segmenti dhe drejtohen për në Tamarë dhe Shkrel - për në Razëm dhe Parkun Kombëtar Theth, ndërsa pjesa tjetër janë *rrugët lokale* kryesore e dytësore të cilat shtrihen në të gjitha komunat<sup>18</sup>.

Kështu, Bashkia Koplëk dhe qyteti i Shkodrës, lidhur me funksionin e tyre si qendra të aktivitetit tregtar dhe punësimit për zonën funksionale, janë të arritshme nga qendrat e Komunave Kastrat,

<sup>18</sup> Ky përshkrim i rrjetit rrugor të zonës funksionale është hartuar në bazë të përkufizimeve të kategorive të rrugëve sipas Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë. Në krahasim me kategorizimin e rrugëve sipas legjendes së hartës, përshkrimi i afrohet më shumë standardit real të rrjetit.



Kelmend dhe Shkrel përmes segmentit të rrugës kombëtare Shkodër - Han i Hotit dhe rrugës interurbane dytësore (në legjendën e hartës: kategoria 1).

Komuna Gruemirë lidhet me Bashkinë Koplík përmes rrugëve rurale kryesore (në legjendën e hartës: kategoria 2), por ka ndërveprim ekonomik të dendur, numrin me të madh të popullsisë mes komunave të zonës funksionale, me mbi 13,000 banorë, si dhe daljet më të shumta ditore të të punësuarve në drejtim të qendrave Koplík dhe Shkodër. Lëvizja është e vështirë duke marrë parasysh se rreth 85 % e këtyre rrugëve janë të pashtruara.

Fshatrat më të thellë të secilës komunë, nga ana tjetër, lidhen përmes rrugëve rurale dytësore (në legjendën e hartës: kategoria 3).

Shtirirja e rrjetit rrugor është ndjeshëm më e kufizuar në pjesën veriore të zonës funksionale, e cila, për pasojë është veçanërisht e shkëputur dhe nga veprimtaria ekonomike e shoqërore me pjesën jugore, siç përshkruhet dhe në paragrafin 2.2 më sipër.

Pjesa malore e Malësisë së Madhe është një nga zonat me potencialin kryesor për zhvillimin e turizmit. Në Komunën Kelmend, investimet në infrastrukturën rrugore për vitin 2013 – 2014 kanë zënë peshën kryesore, përkatësisht 61 % dhe 44 % e totalit të investimeve të ndërmarra<sup>19</sup>. Komuna ka në projekt ndërtimin e segmentit Makaj – Velipojë (Vermosh) me një vlerë prej 260,000,000 ALL, i cili është një pjesë e rrugës që lidh Bashkinë Koplík me pjesën e alpeve të Komunës Kelmend. Gjithashtu ka një projekt për rindërtimin e rrugës Qendër Vermosh – Pjetrojë me vlerë prej 76,000,000 ALL.

Bashkimi në një njësi të vetme administrative e territorit të Malësisë së Madhe, që pritet të shoqërohet me rritje të eficiencës dhe efektivitetit të aparatit administrativ vendor, mund të sjellë dhe rritje të fondeve të investimit, eficiencës së përdorimit të tyre, dhe dendësimi i ndërveprimit dhe lëvizjeve të banorëve mund të justifikojë grante më të larta të qeverisë qendrore.

## Transporti publik

Transporti publik në zonën funksionale kryhet në pjesën më të madhe me minibus. Përmes tyre të gjitha njësitë vendore lidhen me qytetin e Koplíkut dhe të Shkodrës. Përkrah këtij fakti, përdorimi i transportit publik nga qytetarët për të shkuar në punë është në nivele të ulëta për shkak të infrastrukturës së fragmentuar ndërmjet njërive vendore. Pjesa dërrmuese e popullsisë në të gjitha njësitë vendore lëvizin për në punë në këmbë, biçikletë, me makinë ose motoçikletë, dhe vetëm një pjesë e vogël, që nuk i kalon 12 %, udhëton me minibus apo taksi. Autobusët përdoren më pak, përsëri për shkak të infrastrukturës së vështirë rrugore.

**Tabela 23: Transporti për në punë i të punësuarve në ZF Malësi e Madhe**

Mjeti	Koplík	Qendër	Gruemirë	Kelmend	Kastrat	Shkrel
<i>autobus, minibus, tren, taksi</i>	8,70	7,26	11,82	3,24	11,33	5,22
<i>makinë dhe motoçikletë</i>	29,27	45,81	35,05	13,89	35,39	18,82
<i>në këmbë dhe biçikletë</i>	58,07	33,71	37,50	66,67	42,15	69,84

Burimi: INSTAT, Web Atlas, Census 2011

<sup>19</sup> Pjesë e tyre ka qenë shtrimi i rrugës deri në Tamarë, e cila më parë ka qenë e vështirë për t'u kaluar nga mjetet.

Aktualisht, vetëm një numër i vogël mjeteve veprojnë të licencuara nga njësitë vendore përkatëse. Të licencuara nga Bashkia Koplík janë 37 mjete, nga Komuna Gruemirë janë 25 dhe nga Komuna Kelmend gjithashtu 25 mjete.

Dy linjat kryesore të transportit ndërrurban, të licencuara nga Qarku Shkodër, janë Koplík – Shkodër – Koplík, me shpeshësi 7 ditë në javë, çdo një orë nga ora 8.00h deri në 16.00h. Linja Shkrel – Koplík është licencuar gjithashtu nga Qarku për transport mësuesish dhe studentësh, dhe udhëton rregullisht 7 ditë në javë. Këto linja transporti publik përdorin minibus të regjistruar si taksi.

Stacionet e minibusëve për linjat e transportit publik në përgjithësi nuk janë të pajisur me sinjalistikën përkatëse dhe plane udhëtimi të afishuara që të përmbajnë oraret, nisjen, destinacionin përfundimtar dhe ndalesat e ndërmjetme. Kjo vështirëson lëvizjen për banorë që nuk e njohin mirë zonën, dhe veçanërisht për turistët.

**Tabela 24: Linjat e transportit publik të ZF Malësi e Madhe**

	Për në	Koplík	Kastrat	Kelmend	Shkrel	Qendër	Gruemirë	Shkodër	Tiranë
Nga									
Koplík			Ditor Mb	Ditor Mb	Ditor Mb	Ditor Mb	Ditor Mb	Ditor Mb & B	Ditor Mb & B
Kastrat	Ditor Mb			Stop route from Koplík	Nga Koplík	Stop route to Koplík	Nga Koplík	Stop route to Kelmend	Nga Koplík & Shkodër
Kelmend	Ditor Mb	Stop route to Koplík			Nga Koplík	Stop route to Koplík	Nga Koplík	Ditor Mb	Nga Koplík & Shkodër
Shkrel	Ditor Mb	Nga Koplík	Nga Koplík			Nga Koplík	Nga Koplík	Ditor Mb	Nga Koplík & Shkodër
Qendër	Ditor Mb	Stop routes from Koplík	Stop route from Koplík	Nga Koplík			Nga Koplík	Nga Koplík	Nga Koplík & Shkodër
Gruemirë	Ditor Mb	Nga Koplík	Nga Koplík	Nga Koplík	Nga Koplík			Ditor Mb	Nga Shkodër
Shkodër	Ditor Mb & B	Ditor Mb	Ditor Mb	Ditor Mb	Ditor Mb	Nga Koplík	Ditor Mb		Ditor Mb & B
Tiranë	Ditor Mb & B	Nga Koplík & Shkodër	Nga Koplík & Shkodër	Nga Koplík & Shkodër	Nga Koplík	Nga Koplík	Nga Koplík & Shkodër	Ditor Mb & B	

Burimi: DLDP, 2012: Report for the second delineation of the functional areas

Shënim: Mb = Minibus, B = Bus, specifikimi 'nga' tregon se nuk ka lidhje të drejtpërdrejtë

### Menaxhimi dhe financimi i rrugëve

Aktualisht, në inventarin e *rrugëve rurale* të Rrethit të Malësisë së Madhe dhe Komunave të tij janë 103 km rrugë rajonale dhe 317.5 km rrugë komunale, gjithsej 420.5 km, të përmbledhura në tabelën e mëposhtme. I detajuar me emërtimet e segmenteve të rrugëve dhe gjatësitë përkatëse, inventari jepet në aneksin bashkëngjitur dokumentit.

**Tabela 25: Rrugët rurale nën administrimin e njësive vendore të ZF Malësi e Madhe, 2012**


Njësia administrative	Sasia	Rrugë Rajonale (km)	Rrugë Komunale (km)
KOMUNA KELMEND	1	36	
KOMUNA SHKREL	2	12	
KOMUNA GRUEMIRË	1	5	
RRETHI MALËSI E MADHE	5	50	
KOMUNA SHKREL	23		56.8
KOMUNA KELMEND	17		67.0
KOMUNA QENDËR	10		36.6
KOMUNA GRUEMIRË	10		68.1
KOMUNA KASTRAT	35		90.4
ZF MALËSI E MADHE		103	318.9

Burimi: Ministria e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit

\*Shuma e km gjithsej të rrugëve komunale ka një mospërputhje prej 1.35 km me shumën e përfutur nga mbledhja e km të secilit segment rrugor.

Për vitin 2014, investimet në ngritjen dhe përmirësimin e infrastrukturës rrugore kanë zënë peshtë në totalin e investimeve vendore si vijon:

**Grafiku 21: Investimi në ndërtim rrugësh ndaj investimeve gjithsej në ZF Malësi e Madhe, 2014**



**Tabela 26: Shpenzime mirëmbajtje rrugësh në ZF Malësi e Madhe, 2014**

Buxheti i njësisë vendore 2014	Bashkia Koplík	Komuna Gruemirë	Komuna Qendër	Komuna Kelmend	ZF Malësi e Madhe
Shpenzime mirëmbajtje rruge	-	-	959,068	3,945,181	4,904,249

Burimi: Njësitë e Qeverisjes Vendore

Burimet kryesore të investimeve janë transfertat e pakushtëzuara nga qeveria qendrore e, në një masë shumë të ulët, nga të ardhurat e veta të njësisë vendore. Ky fakt thekson nevojën për rritje të eficiencës së pushtetit vendor përmes integritit të administrimit të rrjetit rrugor që shpresohet të arrihet nga zgjerimi i njësisë administrative në kufijtë e zonave funksionale.

**Tabela 27: Vlerësim i kostos së mirëmbajtjes së rrjetit të rrugëve të ZF Malësi e Madhe**

Administrimi i rrugës	Kategoria e rrugës	Gjatësia km	Kosto lekë/km/vit	Shpenzime mirëmbajtje rruge lekë/vit
Rrethi (Qarku)	Rrugë rajonale	50	130,550	6,527,500
Bashkia Koplík	Rrugë lokale (urbane)	19.3		
	të shtruara (të reja, pa mirëmbajtje dimërore)	15.1	414,000	6,251,400
	të pashtruara dytësore	4.2	44,000	184,800
Komunat	Rrugë lokale (komunale)	370.5		
	të shtruara (të vjetra, me mirëmbajtje dimërore)	74.1	809,000	59,946,900
	të pashtruara	296.4	156,000	46,238,400
ZF MALËSI E MADHE	Rrugë Rurale	420.5		<b>119,149,000</b>
	Rrugë Urbane	19.3		

Burimi: Llogaritje të autorit

Shënim: Në 'rrugë rurale' janë përfshirë rrugët sipas inventarit të vitit 2012 të Ministrisë së Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit. Në 'rrugë urbane' janë përmblodhur rrugët sipas inventarit të Bashkisë Koplík, 2014, duke zbritur segmentin me gjatësi 3 km të rrugës interurbane dytësore dhe atë 4.4 km të rrugës interurbane kryesore - by pass i rrugës Shkodër - Han i Hotit.

### Rekomandime për integrimin e shërbimit publik

1. Segmenti *rrugor interurban kryesore* Shkodër - Hani i Hotit e një cilësie shume të mirë, i siguron zonës një lidhje të qëndrueshme dhe të vazhdueshme më pjesën tjetër të vendit si dhe me tregun ndërkombëtar nëpërmjet pikës kufitare të Hanit të Hotit.
2. Duke pasur parasysh relievin e ndryshueshëm dhe shumë të thyer të zonës funksionale të Malësisë së Madhe, përmirësimi i rrjetit të brendshëm rrugor është bazë për një zhvillim të njëtrajtshëm ekonomik dhe shoqëror të saj; ky i fundit është veçanërisht i rëndësishëm për zonën veriore të bjeshkëve e alpeve, e cila, deri më tani, është krahasimisht më e shkëputur në lidhje më këto ndërveprime.

Në këtë kuadër, në planin e investimeve kapitale ZF duhet të planifikojë rritjen graduale të rrjetit *rrugor interurban dytësor* për të lidhur të gjitha qendrat e komunave me qendrën e Zonës Funktionale.

3. Gjithashtu, ndërtimi i rrugëve ndërlidhëse ka rëndësi të veçantë për zhvillimin e turizmit, i cili, sipas analizës së mësipërme ekonomike, është përcaktuar si sektor kyç i zhvillimit të krejt zonës funksionale. Një element e rëndësishëm i nxitjes dhe zhvillimit të turizmit është pikërisht mundësia për të vizituar njëkohësisht disa pika turistike të Malësisë së Madhe, duke përfshirë pjesën liqenore, bjeshkët dhe zonat e larta alpine. Një gjë e tillë kërkon mbështetje nga një rrjet rrugorë të shtrirë në të gjitha njësitë vendore e që përfshin pikat e tyre turistike.

Në këtë kuadër, në planin e investimeve kapitale ZF duhet të planifikojë rritjen graduale të rrjetit *rrugor lokal* për të bërë të aksesueshme atraksionet turistike në thellësi të Zonës Funktionale.

4. Shtrirja e *rrjetit të rrugëve lokale* në kushtet e krijimit të një njësie administrative funksionale parashtron pikërisht drejtimin e avantazheve konkurruese të zonave që deri tani qeverisen të veçuara nga njëra-tjetra, drejt një zhvillimi të përbashkët: për Malësinë e Madhe, e cila ka vetëm një qendër urbane, dhe që do të mbështet në zhvillimin e bujqësisë, blegtorisë dhe turizmit, integrimi i fshatrave nëpërmjet *rrjetit rrugor lokal* më të thellë dhe zonave malore, është domosdoshmëri.
5. Me krijimin e një njësie të vetme, shërbimi i transportit publik do të projektohet e administrohet në mënyrë të tillë që të përfshijë interesin e shumë më tepër qytetarëve, duke përmirësuar ndërlidhjen e fshatrave të thellë me qendrat më të urbanizuara.
6. Ngritja e stacioneve të linjave të minibusëve apo autobusëve në vendndodhje të përcaktuara dhe plane të rregullta udhëtimi është e nevojshme për ofrimin brenda standardeve bashkëkohore të shërbimit të transportit publik, i cili të lehtësojë lëvizjen e banorëve brenda Malësisë së Madhe. Stacione të linjave të transportit publik janë gjithashtu të nevojshme për pritjen e turistëve vendas e të huaj të cilët nuk e njohin zonën.
7. Lidhur me mirëmbajtjen e infrastrukturës, bazuar në vlerësimet e kostove mesatare të mirëmbajtjes së rrugëve nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit, mund të përafrojmë shpenzimet vjetore të mirëmbajtjes së zonës funksionale të Malësisë së Madhe për totalin e rrjetit rrugor rural e urban që zona mund të ketë nën administrim si njësi vendore.
8. Në krahasim me vlerën e shpenzimeve të mirëmbajtjes së vitit 2014, të shpenzuar nga të gjitha njësitë vendore së bashku, vlera e përafroar e tyre për zonën funksionale është shumë më e lartë.
9. Njësia administrative duhet të jetë në gjendje të krijojë të ardhura të veta të mjaftueshme për të mbuluar shpenzime operative të larta për mirëmbajtjen e rrugëve dhe sigurimin minimal të transportit publik në akset kryesore rrugore, ndërsa segmente të tjera do të mbulojnë nga transporti publik privat. Në këtë drejtim, nevojitet një vlerësim i kujdesshëm i bazës së taksave dhe tarifave vendore që do të ketë zona funksionale Malësi e Madhe si dhe i masave që mund të rrisin arkëtimin e tyre nga subjektet pagues.

10. Ndërsa investimet kapitale për përmirësimin e gjëndjes së rrugëve dhe lidhjes së qendres së ZF me njësitë periferike do të mbeten nën kujdesin e buxhetit të shtetit, Fondit për Zhvillimin e Rajoneve apo donacione në këtë sektor.
11. Për shkak të kostove të larta të operimit dhe mirëmbajtjes, dendësisë së popullsisë dhe volumit të mallrave, duke qenë pjesë e sistemit hekurudhor kombëtar, dhe për aq kohë sa nuk do të ketë një plan kombëtar për rigjallërimin e sistemit hekurudhor në Shqipëri, ne nuk arrijmë që ta shikojmë segmentin hekurudhor Shkodër - Hani i Hotit që të funksionojë si një sistem eficient interurban komunikimi dhe transporti i veçuar nga sistemi kombëtar, për rrjedhojë, të paktën në periudhë kohore afat afatmesëm (3 - 10 vjet). Në këto kushte ky segment hekurudhor nuk duket se do të shërbejë si një incentivë zhvillimi për ZF, në të kundërt subvencione të konsiderueshme do të kërkoheshin nga buxheti i shtetit për ta bërë atë funksionale dhe të dobishëm.

## 4. Organizimi i qeverisjes vendore të tanishme

### 4.1. Struktura dhe burimet njerëzore

Një pamje e përmblodhur e strukturës dhe burimeve njerëzore të gjashtë njësive vendore pjesë përbërëse të ZF Malësi e Madhe sipas fushave kryesore të veprimit jepet në tabelën më poshtë:

Funksioni	Koplik	Qendër	Gruemirë	Kelmend	Shkrel
Kryetar	1	1	1	1	1
Nën Kryetar	1	1	1	1	1
Sekretar Kryetari/Këshilli	1	1	1	1	1
Juridike	1	-	-	1	1
Finance/Tatim Taksa	4	1	3	3	3
Tatim Taksa	2	1	1	1	1
Ndihma Ekonomike	2	1	1	1	2
Bujqësia	-	1	2	1	-
Shërbime Publike	1	2	1	3	11
Urbanistike/Kadastër	2	-	1	1	3
Inspektorat i Ndërtimeve	3	-	-	-	-
Administrim Pyjesh	-	-	-	-	4
Kontroll Veteriner dhe I Ushqimit	1	-	-	-	1
Kultura, Sporti	2	-	-	1	-

Burimi: Njesite e Qeverisjes vendore

Bashkia Koplik, përkrah pozicioneve drejtuese, është e përbërë nga departamentet e mëposhtme, domethënë në lidhje me objektin e kësaj analize:

Zyra Juridike / Audit i brendshëm

Zyra e Financës / Zyra e Taksave

Zyra e Ndihmës ekonomike / Zyra e Emergjencave civile

Zyra e Urbanistikës / Zyra e Kadastrës

Zyra e Inspektoratit ndërtimor  
Zyra e Kontrollit veterinar dhe ushqimit  
Zyra e Kulturës

Puna në këto departamente mbulohet nga një deri në tre punonjës. Gjithshtu, është i punësuar një inspektor shërbimesh publike dhe pjesa tjetër e stafit janë punonjës të mirëmbajtjes dhe ndihmës.

Nëpërmjet kësaj strukture të tanishme, Bashkia Koplík mbulon **funksionet e veta** si më poshtë:

*Në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike, Zyrat e Urbanistikës dhe e Kadastrës mbulojnë përkatësisht funksionin e planifikimit urban dhe menaxhimit të tokës në pronësi të Bashkisë Koplík, dhe kanë në përbërje vetëm nga një punonjës.*

Zyra e Inspektoratit Ndërtimor ka në përbërje të saj tre punonjës dhe përgjigjet për inspektimin e ndërtimeve brenda territorit administrativ të Bashkisë Koplík..

Shërbimi i furnizimit të popullatës me ujë të pijshëm kryhet nga Sh.a. Ujësjellës Kanalizime Malësi e Madhe, në të cilën Bashkia Koplík është aksionere së bashku me 17 njësi vendore të tjera dhe për këtë arsye nuk ka punonjës të fushës në përbërje të saj; po kështu, Bashkia nuk ka punonjës në lidhje me shërbimin e sistemit të kanalizimeve.

Shërbimi i largimit të mbeturinave është i kontraktuar me një kompani private. Mbikqyrja e cilësisë së kryerjes së shërbimit mbulohet nga një inspektor i vetëm shërbimesh publike.

*Shërbimet me karakter social, kulturor e sportiv mbulohen nga Zyra e Kulturës, me gjithsej dy punonjës – njëri përgjegjës për bibliotekën, kulturën dhe sportin si dhe një punonjës social.*

Shërbimi veterinar i kontrollit të produkteve ushqimore të njërive prodhuese apo fermave brenda territorit të Bashkisë Koplík si mishi, qumështi etj. ofrohet nga Zyra e Kontrollit veterinar dhe ushqimit, e cila mbulohet nga një punonjës i vetëm.

Vihet re se struktura e Bashkisë Koplík nuk mbulon administrimin e zonave të mbrojtura dhe parqeve kombëtare, gjë që është e nevojshme duke pasur parasysh se njëzia ka nën administrim një pjesë të bregut të liqenit të Shkodrës.

Edhe pse bujqësia është sektori kryesor i zhvillimit ekonomik të Bashkisë, aktualisht nuk ka asnjë punonjës që ta mbulojë këtë fushë si nga pikëpamja e politikave të zhvillimit ashtu edhe nga pikëpamja e asistencës së fermerëve me infomacion.

Komuna Qendër, përkrah sektorit drejtues, është e organizuar sipas këtyre departamenteve kryesore:

Zyra e Financës  
Zyra e Taksave  
Zyra e Ndihmës ekonomike  
Zyra e Bujqësisë  
Zyra e Shërbimeve

Secili prej departamenteve të mësipërm mbulohet nga një punonjës i vetëm.

Nëpërmjet kësaj strukture Komuna mbulon **funksionet e veta** si më poshtë:

*Infrastruktura dhe shërbimet publike* mbulohen kryesisht përmes Zyrës së Shërbimeve dhe punonjësve me kontratë.

Komuna Qendër ka të punësuar 1 punonjës për shërbime ujësjellësi me arsim të mesëm. Ajo është një nga 18 Komunat aksionere të Sh.a Ujësjellës Kanalizime Malësi e Madhe por nuk është pjesë zonës së mbulimit faktik me shërbim nga kjo ndërmarrje. Në Komunë funksionon një rrjet ujësjellësi i pavarur.

Shërbimi i menaxhimit të mbetjeve është ofruar deri në vitin 2014 me nënkontraktorë në frekuenca jo të rregullta, ose nga vetë njësia në nivele tepër të ulta.

Nga struktura vihet re në mënyrë të veçantë mungesa e një Zyre Kadastre apo specialistëve të bujqësisë për këtë komunë duke pasur parasysh se ekonomia e këtyre zonave është tipikisht agrare dhe bujqësia është burimi kryesor i të ardhurave të banorëve dhe motorri kryesor i zhvillimit ekonomik vendor.

Komuna Gruemirë, përkrah sektorit drejtues, është e organizuar sipas këtyre departamenteve kryesore më domethënëse për këtë analizë:

Zyra e Financës / Zyra e Taksave  
Zyra e Ndihmës ekonomike  
Zyra e Bujqësisë  
Zyra e Planifikimit urban  
Zyra e Shërbimeve

Secili prej departamenteve të mësipërm mbulohet nga 1 punonjës i vetëm. Veç tyre, janë të punësuar me kontratë 4 punonjës shërbimesh të arsimit të mesëm.

Nëpërmjet kësaj strukture Komuna mbulon **funksionet e veta** si më poshtë:

*Infrastruktura dhe shërbimet publike* mbulohen kryesisht përmes Zyrës së Shërbimeve dhe punonjësve me kontratë.

Shërbimi i furnizimit me ujë dhe kanalizime u ofrohet banorëve nga Sh.a Ujësjellës Kanalizime Malësi e Madhe ndërsa shërbimi i menaxhimit të mbetjeve është ofruar deri në vitin 2014 me nënkontraktorë.

Komuna ka një Zyrë të Planifikimit Urban, ndërsa në lidhje me infrastrukturën rrugore – ndërtim, rehabilitim apo mirëmbajtje të rrugëve, në strukturë nuk parashikohet departament përkatës. Komuna përfshin zona dhe popullsi rurale ku infrastruktura rrugore mungon ndjeshëm dhe, për pasojë, ndërlidhja e fshatrave me njëri-tjetrin si dhe me qendrën Koplík është e dobët. Për këtë arsye, mungesa e specialistëve në fushën e urbanistikës, infrastrukturës rrugore dhe



transportit publik në strukturën organizative vendore si dhe e fondeve për të mbuluar këto funksione është e ndjeshme.

Në të njëjtën linjë arsyetimi, Komunat Qendër dhe Gruemirë (së bashku me Komunën Kastrat) përfaqësojnë pjesën fushore të zonës funksionale Malësi e Madhe. Nga struktura e tyre vihet re në mënyrë të veçantë mungesa e një Zyre Kadastrë apo specialistëve të menaxhimit të tokës për të dy këto komuna të cilat kanë nën administrim pjesën më të madhe të tokës bujqësore të zonës funksionale – së bashku rreth 50% dhe, duke përfshirë Komunë Kastrat, rreth 76% të ha tokë bujqësore gjithsej.

Si për Komunën Qendër, edhe për Komunë Gruemirë mungojnë specialistë të bujqësisë, ndërkohë që ekonomia e zonës është tipikisht agrare dhe bujqësia është burimi kryesor i të ardhurave të banorëve dhe motorri kryesor i *zhvillimit ekonomik vendor*.

Komuna Kelmend, përkrah sektorit drejtues, përbërhet nga departamentet e mëposhtëm:

Zyra Juridike  
Zyra e Financës / Zyra e Taksave  
Zyra e Ndihmës ekonomike  
Zyra e Shërbimeve  
Zyra e Menaxhimit të territorit / Urbanistikës  
Zyra e Zhvillimit rural  
Zyra e Shërbimeve sociale, arsimit, kulturës dhe sporteve

Në lidhje me përmbushjen e **funksioneve të veta**, përkrah gjetjeve të përshkruara në strukturat e njësisve të mësipërme, për këtë komunë veçojmë ekzistencën e Zyrës së Zhvillimit Rural, një zyrë unike për të gjitha NJ.Q.V.-të përbërëse të zonës funksionale e cila vepron si zyrë partnere për hartimin dhe zbatimin e projekteve të zhvillimit në zonë, këto të lidhura kryesisht me turizmin.

Edhe pse administrimi i pyjeve është një aspekt i rëndësishëm në zonë, vihet re mungesa specialistëve të kësaj fushe në Komunën Kelmend, ku shtrihet zona e pyjeve të Malësisë së Madhe.

Zyra Shërbimeve kryen me punonjësit e saj shërbime që lidhen me funksionimin e ujësjellësve lokalë e me grumbullimin e mbetjeve. Në Komunë funksionojnë disa ujësjellës lokalë me rënie të lirë të cilët nuk janë pjesë e rrjetit të Sh.a Ujësjellës Kanalizime Malësi e Madhe.

Komuna Shkrel, përkrah sektorit drejtues, është e përbërë nga sektorët e mëposhtëm:

Zyra Juridike  
Zyra e Financës / Zyra e Taksave  
Zyra e Ndihmës ekonomike  
Zyra e Shërbimeve (Ndërrmarja e Ujësjellësit)  
Zyra e Menaxhimit të territorit / Urbanistikës  
Zyra e Kadastrës  
Zyra e Turizmit  
Zyra e Administrimit të pyjeve

Veçojmë së administrimi i pyjeve është një departament i rëndësishëm i Komunës Shkrel ku shtrihet zona e pyjeve të Malësisë së Madhe. Ky sektor është i përbërë nga një inxhiner dhe tre inspektorë të mesëm.

Për të gjitha njësitë vendore, për përmbushjen e funksioneve të karakterit shoqëror, kulturor apo sportiv, mungojnë ndjeshëm departamente apo punonjës të posaçëm.

Ndër **funksionet e përbashkëta** të pushtetit vendor, të gjitha njësitë mbulojnë kujdesin social dhe zbutjen e varfërisë nëpërmjet Zyrës së Ndhmës ekonomike, me një deri në dy punonjës.

#### 4.2. Veçantitë dhe të përbashkëtat në dhënien e shërbimeve publike

Nga analiza e tre shërbimeve kryesore publike të NJ.Q.V-ve të tanishme (ujësjellës-kanalizime, grumbullimi i mbetjeve dhe transporti publik) janë vënë re këto karakteristika të ofrimit të shërbimit dhe mbulimit me burime njerëzore:

##### *Ujësjellës – Kanalizime*

- Në të paktën dy njësi vendore ka punonjës të ujësjellësit; në këto njësi shërbimi i furnizimit me ujë nuk është i agreguar dhe ato nuk janë pjesë e zonës së mbulimit të Sh.a Ujësjellës Kanalizime Malësi e Madhe. Në njësitë e tjera, ku shërbimi kryhet nga Sh.a Ujësjellës Kanalizime Malësi e Madhe, nuk ka punonjës ujësjellësi.

##### *Grumbullim mbetjesh*

- Në të paktën dy njësi vendore punonjësve të kontraktuar kryejnë shërbimin e largimit të mbetjeve. Në njësitë e tjera ky shërbim është i nënkontraktuar dhe punonjësi i njësisë kryen vetëm koordinimin dhe mbikqyrjen e cilësisë së kryerjes së shërbimit nga nënkontraktori.

##### *Mirëmbajtje rrugësh, sheshesh, trotuaresh*

- Njësitë vendore nuk rezultojnë të kenë burime njerëzore të cilat kryejnë këto shërbime.

Shërbimi i transportit publik nuk kërkon staf të përherëshëm në asnjërin prej NJ.Q.V.-ve.

#### 4.3. Rekomandime mbi strukturën organizative të njësië vendore Malësi e Madhe

Struktura e Zonës Funktionale Malësi e Madhe do të ngrihet mbi rekomandime që reflektojnë parimet të funksionalitetit të njësisë vendore, dhe gjithashtu, që janë në mbështetje të drejtimeve zhvillimit të dhënë në PZF, të zbatimit të objektivave të zhvillimit strategjik dhe të projekteve strategjike të lidhura me to.

##### *Nga ana funksionale, struktura e re duhet të:*

- 1- Ruajë funksionet qendrore duke i unifikuar ato në zyra qendrore në njësinë qendër të zonës funksionale.

Grumbullimi i funksioneve administrative (financë, prokurim, urbanistikë, kadastër) në njësinë qendër të ZF do të sjellë ekonomi të shkallës pra ofrim të njëjtit shërbim me një numër total më të vogël punonjësish si pasojë e ndarjes më të mirë të punës, shmangies së hierarkisë dhe specializimit të stafit. Personeli i kursyer nga ekonomia e shkallës mund të rialokohet në sektorë të tjerë sensitivë që kërkojnë rritje.

2- Rrisë kapacitetet e kualifikimit të stafit në sektorin e financës dhe urbanistikës me qëllim sigurimin e një fillese të mirë të punës në zonën e re funksionale.

Puna e qeverisë së ardhshme vendore duhet të nisë me *konsolidimin e njohjes së territorit* të ri që ajo do të ketë nën administrim. Për këtë, *inventarizimi* do të jetë një proces i nevojshëm dhe veçanërisht në këto drejtime kryesore:

- Inventarizimi i territorit të Bashkisë Malësi e Madhe
- Inventarizimi i aseteve të Bashkisë Malësi e Madhe
- Konsolidimi i financave të Bashkisë Malësi e Madhe

Për këtë qëllim, Bashkia do të përballet me sfidën e agregimit të informacionit nga të gjitha njësitë vendore përbërëse dhe, më tej, do të ketë nën përgjegjësi menaxhimin e aseteve materiale e financiare për një territor shumë më të madh se ai që është menaxhuar nga njësitë vendore deri tani. Për rrjedhim stafi i saj duhet të pasurohet me individë me eksperiencë të mjaftueshme, ose plane trainimi duhet të bëhen për stafin ekzistues me qëllim sigurimin e një faze fillestare të suksesshme.

3- Shtrijë disa shërbime qendrore në ato pjesë të territorit ku nuk janë ofruar më parë.

4- Shërbimet që ofrohen nga njësitë vendore ndaj qytetarëve përmes sporteleve duhet të integrohen në një zyrë të vetme të vendosur në territorin e çdo njësie të tanishme vendore.

Qëllimi i këtyre zyrave të shërbimit qytetar është lehtësimi i marrjes së shërbimeve nga banorët e çdo zone të bashkisë së ardhshme, pa nevojën për të udhëtuar për çdo rast drejt qendrës Koplík. Ngritja dhe funksionimi me efektivitet i tyre kërkon koordinimin me Bashkinë Malësi e Madhe në Koplík së pari lidhur me bazën e të dhënave përkatëse dhe bazën kompjuterike me të cilën do të punohet. Një studim paraprak mund të jetë i nevojshëm në këtë drejtim.

5- Sigurojë që në njësitë vendore aktuale të mbeten ato shërbime të cilat duhet të jenë afër banorëve dhe që, për arsye të ndryshme, nuk mund të ofrohen nga qendra e zonës funksionale, por duke mbajtur një komunikim dhe kontroll të vazhdueshëm me qendrën.

Shërbime si Gjendja Civile, shpërndarja e ndihmës ekonomike, inspektorët dhe pagesa e taksave, inspektorët e ushqimit e bujqësisë duhet të vazhdojnë të jenë pranë banorëve duke mos krijuar distanca të mëtejshme.

6- Shërbimet publike duhet të jepen në mënyrë të unifikuar në të gjithë territorin.

Punojësit aktualë të ujësjellësve në dy NJ.Q.V.-të duhet ti bashkohen Sh.a Ujësjellës Kanalizime Malësi e Madhe dhe këto NJ.Q.V. si dhe sistemet e ujësjellësve që ato disponojnë duhet të bëhen pjesë e administrimit dhe zonës së mbulimit të Sh.a Ujësjellës Kanalizime Malësi e Madhe.

Shërbimi i grumbullimit dhe largimit të mbetjeve duhet të bëhet në mënyrë të unifikuar për të gjithë zonën funksionale në përputhje me rekomandimet e dhëna në pjesën e shërbimeve të PZF. Në këtë kontekst, struktura e zonës funksionale duhet të përmbajë specialistë qëndrorë të cilët të vendosin standardet e shërbimit dhe të monitorojnë kryerjen e tij nga nënkontraktori.

Punonjësit që aktualisht kryejnë grumbullim e largim mbetjesh mund ti bashkohen shoqërive që do të kryejnë këtë shërbim në të ardhmen.

Zyra e shërbimeve duhet të vendosë standardin, frekuencën dhe mënyrën e mirëmbajtjes së rrugëve, shesheve e trotuareve. Ky shërbim duhet të kryhet i kontraktuar dhe roli i zyrës përkarëse të shërbimeve duhet të jetë kryesisht planifikimi e monitorimi.

***Nga prespektiva e zhvillimit, struktura e re duhet të:***

1- Përmbajë zyrë për zhvillimin e sektorëve kyç të ekonomisë.

Në strukturën e zonës funksionale Malësi e Madhe duhet të ketë departament të zhvillimit ekonomik puna e të cilit të jetë drejtimi dhe mbështetja e zhvillimit të sektorëve strategjikë dhe atyre të rëndësishëm për zona të ndryshme të njësisë (fushore, liqenore dhe malore). Këta mund të jenë sektorët e evidentuar në konceptin strategjik të zhvillimit të hartuar nën PZF, ose të vlerësuar nga drejtuesit e njësisë vendore në të ardhmen.

Brenda këtij departamenti duhet të evidentohen qartë:

- a) Zyra e Informimit të Fermerëve, projekt i kërkuar me këmbëngulje nga banorët e zonës
- b) Zyra e Zhvillimit të Turizmit, si vijim i përvojës së mirë në Kelmend dhe si mbështetje për krijimin e produkteve të duhura për zhvillimin e turizmit dhe për zbatimin e projekteve strategjike të lidhura me këtë sektor.

2- Ofrojë shërbime në të mirë të zonës të cilat nuk janë ofruar më parë, si monitorimi i mjedisit dhe zonave të mbrojtura.

Specialistë të mjedisit do të jenë të nevojshëm edhe në lidhje me drejtimin e një zhvillimi të qëndrueshëm të turizmit si sektor strategjik i zhvillimit të zonës.

***Kutia 4: Raport mbi Forumin për projekt idetë për investime në ZF Malësi e Madhe, 03 prill 2015***

Forumi i organizuar për prezantimin dhe diskutimin e projekt ideve mbi investime të nevojshme në zonën e Malësisë së Madhe, është i mendimit se, përkrah riorganizimit të strukturës së njësisë së re vendore, njëkohësisht është i nevojshëm rindërtimi i ndërtesës eksistuese të Bashkisë Kopluk - ku me shumë gjasa do të vendoset administrata e ardhshme vendore e Bashkisë Malësi e Madhe - në përshtatje me departamentet dhe stafin e ri që ajo do të ketë në përmbajtje të saj. Forumi argumenton se aktualisht kjo ndërtesë përmbledh edhe institucione të tjera veç Bashkisë Kopluk dhe vendosja e zyrave nuk është e përshtatshme nga pikëpamja logjistike.

## **PJESA B: PROGRAMI I ZHVILLIMIT TË ZONËS FUNKSIONALE**

### **5. Koncepti i zonës funksionale Malësi e Madhe**

#### **VIZIONI**

*“Malesi e Madhe e zhvilluar në mënyrë harmonike dhe të qëndrueshme, me infrastrukturë të përmirësuar e cila mbështet zhvillimin ekonomik të zonës dhe përmirëson jetesën e banorëve të saj, me bujqësi të zhvilluar dhe konkurruese në tregjet europiane, me turizëm të zhvilluar malor dhe liqenor.”*

#### **OBJEKTIVAT STRATEGJIKE**

Objektivat strategjik prioritarë të identifikuar në mbështetje të arritjes së vizionit janë:

##### **1- Zhvillimi cilësor dhe sasior i sektorit të bujqësisë**

##### **2- Zhvillim i sektorit të turizmit bazuar tek:**

- a) Ngritja e kapaciteteve dhe e teknologjisë për mbështetjen e zhvillimit bujqësor;
- b) Ngritja e standardit të turizmit në parametra bashkëkohore;
- c) Ngritja e ambjenteve mbështetese turistike në zonen e liqenit dhe ate të alpeve;
- d) Ndërtimi i infrastrukturës për rritjen e aksesit në zonat turistike;
- e) Ngritja e kapaciteteve për të hartuar dhe zbatuar produktet dhe aktivitetet turistike;

##### **3- Përmirësim i shërbimeve me qëllim ruatjen e mjedisit dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së banorëve**

### **6. Projekte kyçe të zonës funksionale Malësi e Madhe**

#### **Kriteret e përzgjedhjes së projekteve strategjike:**

Propozimet për projekte strategjike zhvillimi të ZF Malësi e Madhe duhet ti përgjigjen pyetjeve vlerësuese të mëposhtme:

1. A është projekti në përputhje me vizionin e ZF?
2. A kontribuon projekti në një ose më shumë objektiva strategjike?
3. A kontribuon projekti në zhvillimin e një ose më shumë sektorëve të ekonomisë së ZF?
4. A kontribuon projekti në hapjen e vendeve të reja të punës?
5. A kontribuon projekti në rritjen e aksesit të popullsisë në shërbimet jetike të zonës (shëndetsi, arsim, tregje, etj.)?
6. A kontribuon projekti në rritjen e nivelit të jetesës së popullsisë?
7. Ç’pjesë e popullsisë së ZF përfiton nga ky projekt?
8. Sa prioritar është ky projekt në raport me nevojat e tjera të ZF?

9. A ka pasur projekte të ngjashme në të kaluarën për ndonjërin nga NJ.Q.V. dhe çfarë përvojë ka ajo?

## LISTË PROJEKTESH POTENCIALE

### Projekte të zhvillimit ekonomik

	<i>Titulli i projektit</i>	<i>Perputhet me vizionin</i>	<i>Objektivi strategjik relevant</i>	<i>Sektori Ekonomik i Ndikuar</i>	<i>Sherbimi Publik i Permiresuar</i>	Njesite perfituese
1.	Nxitje e kultivimit te bimeve medicinale ne token e pambjelle (subvencion i fares dhe sigurim i tregut per tre vitet e para te kultivimit per cdo ha shtese)	Po	OS 1	Bujqesia		Koplik, Gruemire, Qender, Kastrat, Shkrel
2.	Ngritje e Qendres se Informimit te Fermereve mbi tendencat ne tregun bujqesor dhe edukim per diversifikim te mbjelljeve	Po	OS 1	Bujqesia		Te gjitha
3.	Nxitje investimi ne industri perpunuese baze per bimet etero vajore	Po	OS 1	Bujqesia, Industria bujqesore		Koplik, Gruemire, Qender, Kastrat, Shkrel
4.	Nxitje investimi ne industri perpunuese baze per geshtenjat	Po	OS 1	Bujqesia, Industria bujqesore		Kelmend, Shkrel
5.	Pjesemarrje ne panaire nderkombetare per promovimin bimeve medicinale, geshtenjes e duhanit	Po	OS 1	Bujqesia		Te gjitha
6.	Nxitje investimi per zhvillimin e kultivimit te peshqve ne lumenj e liqen	Po	OS 1	Bujqesia Peshkimi		Kelmend, Kastrat, Qender, Gruemire
7.	Financim programi per zevendesimin e cative te eternitit ne bujtinat e Kelmendit	Po	OS2	Turizmi,		Kelmend, Shkrel
8.	Nxitje per industrine perpunuese te duhanit me destinacion tregun vendas e te huaj	Po	OS1	Bujqesia, Industria bujqesore		Kastrat, Qender, Gruemire, Shkrel, Koplik

9.	Asistence per ri-marketim dhe ri-negocim i licences per parkun industrial Koplík duke e orientuar drejt OS te Zones Funktionale	Po	OS1, OS2,	Bujqesia, Industria		Te gjitha
10.	Hartim I planit te integruar te zhvillimit te turizmit ne ZF MM	Po	OS1, OS2	Turizmi		Te gjitha
11.	Trainim ne hoteleri, menaxhim bujtine kombinuar me agro turizem	Po	OS2	Turizmi, Bujqesi		Kelmend,

### Projekte të përmirësimit të shërbimeve publike

	<i>Titulli i projektit</i>	<i>Perputhet me vizionin</i>	<i>Objektivi strategjik relevant</i>	<i>Sektori Ekonomik i Ndikuar</i>	<i>Sherbimi Publik i Permiresuar</i>	Njesite perfituese
1.	Hartim i planit urbanistik te ZF Malesi e Madhe	Po	OS 1, OS3	Ndertimi, Turizmi, Sherbimet (restorante)	Infrastruktura publike, menaxhimi i territorit	Te gjitha
2.	Financim i studimit urbanistik per zhvillimin e zones turistike prane bregut te liqenit	Po	OS2	Turizmi	Menaxhimi i territorit	Kelmend, Kastrat, Qender, Gruemire
3.	Ndertim i rruges dhe ndricimit per kembesore e bicikleta pergjate bregut te liqenit	Po	OS 1, OS3	Turizmi, Sherbimet (restorante)	Infrastruktura publike	Kastrat, Qender, Gruemire, Koplík
4.	Ndertim i rrugeve lidhese te qendrave te banuara me bregun e liqenit	Po	OS 1, OS3	Turizmi, Sherbimet (restorante)	Infrastruktura publike	Kastrat, Qender, Gruemire, Koplík, Shkrel
5.	Ngritje e infrastruktures lundruese (mol, kalate) mbeshtetese per barka peshkimi ose varka shetitese	Po	OS2, OS3	Turizmi, Peshkimi	Infrastruktura publike	Kastrat, Qender, Gruemire, Koplík
6.	Sistemim hapësire te gjelberuar pergjate bregut te liqenit	Po	OS 1, OS3	Turizmi, Sherbimet (restorante)	Infrastruktura publike	Kastrat, Qender, Gruemire, Koplík
7.	Ndertimi i nje stacioni transferimi per mbetjet	Po	OS1, OS3	Ndertimi	Largimi i mbetjeve	Malësi e Madhe
8.	Hartimi i standarteve per ndertimin e gropave septike	Po	OS 1, OS3		Kanalizimet	Te gjitha
9.	Rehabilitim i ndertesës se Bashkise Koplík pershtatur me funksionet e reja qendrore	Po	OS3	Ndertimi	Gjendja civile, ndihma ekonomike	Te gjitha

10.	Ndertim stacionesh autobuzi me standarte bashkekohore	Po	OS1, OS3	Transport, Turizem	Transport Publik	Te gjitha
-----	---	----	----------	--------------------	------------------	-----------

**Projekte në ndihmë të fillimit të shpejtë të punës në njësinë e re (QUICK START)**

	<i>Titulli I projektit</i>	<i>Perputhet me vizionin</i>	<i>Objektivi strategjik relevant</i>	<i>Fusha e veprimit</i>			Njesite perfituese
				Fuqizim strukturash	Ngritje Kapacitetesh	Sherbime te integruara	
1.	Inventarizim dhe konsolidim i asetëve dhe financave të ZF	Po	OS3	Po	Po	Po	Te gjitha
2.	Inventarizim i territorit të ZF	Po	OS3	Po	Po	Po	Te gjitha
3.	Studim për integrimin e shërbimeve në sportelet e ZF në një zyre të vetme	Po	OS3	Po	Po	Po	Te gjitha
4.	Inventarizim i asetëve të Shoqërisë Ujësjetës Kanalizime për ZF Malesi e Madhe	Po	OS3	Po	Po	Po	Te gjitha



## FISHAT E PROJEKTEVE

### PROJEKTE TE ZHVILLIMIT EKONOMIK

Titulli i projektit	Nxitje e kultivimit te bimeve medicinale ne token e paperdorur
Lloji i projektit	Zhvillim i sektorit strategjik te bujqesise
Vendndodhja e projektit	Fshatrat e Koplikut, Qendres, Gruemires, Shkrelit,
Buxheti i vlerësuar gjithsej	30,000 Euro

#### 1. Analiza e problemit

Analiza ekonomike e Zones Funktionale evidenton se jane rreth 3,728 ha toke bujqesore te cilat nuk perdoren per asnje lloj aktiviteti bujqesor. Dy format e rritjes se sektorit bujqesor jane: 1- rritja e produktivitetit dhe perfituesmerise se perdorimit te tokes tradicionalisht te mbjelle; dhe 2- mbjellja e tokes aktualisht jo ne perdorim me kultura te marketueshme dhe me norme kthimi te kenaqshme.

Nga studimi i tendencave te tregut te viteve te fundit si dhe bazuar ne mendimin profesional te eksperteve te bujqesise ne zone rezulton se bimet medicinale jane kulturat te cilat njihen njeresiht ne zone, kultura per te cilat ekziston nje tradite kultivimi dhe ka nje treg te caktuar.

Hezitimi i fermerëve për të shtrirë kultivimin në toka të reja ka të bëjë me shpenzimet fillestare që duhen për këtë proces (fara, kosto e punës) si dhe mungesa e sigurisë që produkti i ri do të gjejë treg.

Për të siguruar zhvillim të qëndrueshëm të bujqesise në këtë drejtim (përdorim i tokes aktualisht të pambjelle) nevojitet një ndihmë për stadin fillestar të këtij procesi e cila adreson dy problemet kryesore të fermerëve: sigurimin e fares për mbjelljet dhe krijimin e sigurisë që produkti i kultivuar do të blihet nga grumbulluesit e medhenj.

#### 2. Objektivi i projektit

Objektivi i projektit është financimi i fares së bimeve medicinale për fermerët që rrisin sasinë e tokes së kultivuar duke vënë në përdorim toke të reja si dhe sigurimi i kontratave të blerjes për sasinë shtese të prodhuar nga grumbulluesit lokalë të bimeve medicinale.

#### 3. Rezultatet e pritshme të projektit

Rezultatet e pritshme të projektit janë:

- Shtim i tokes se punuar
- Rritje e qendrueshme e sektorit bujqesor
- Rritje e të ardhurave për familjet e fermerëve
- Rritje e punësimit në bujqesi për familjet që shtojnë sasinë e tokes se punuar

- Rritje e ekspertizes dhe tradites ne kultivimin e bimeve etero-vajore.

#### **4. Aktivitetet e projektit**

1. Studim i tokave aktualisht jo ne perdorim dhe evidentim i tokave te pershtatshme per kultivimin e bimeve etero-vajore
2. Promovim i programit te fermeret e zones
3. Thirrje per aplikim dhe kalkulim i kerkese per fare per sejcilin fermer
4. Dhenie e fares ose fidaneve ne momentin e duhur per kultivim
5. Monitorim i perdorimit
6. Hartim i kontratave fillestare me grumbulluesit
7. Monitorim i rezultateve per vitin e pare
8. Axhustim i objektivave dhe promovim i eksperiancave pozitive me qellim shtimin e aplikuesve ne vitin e dyte.

#### **5. Pjekuria e projektit**

Programi per mbeshtetjen e kultivimit te bimeve medicinale ne tokat e paperdorura dhe garantimin e tregut per produktin ne periudhen fillestare bazohet ne eksperiencon pozitive ne zone me kultivimin dhe tregtimin e bimeve etero-vajore dhe ne tendencen pozitive te tregut per keto bime ne kater vitet e fundit. Banoret e zones jane te familiarizuar per kultivimin e ketyre bimeve. Ky program perputhet me strategjine subvencionuese per bujqesine te Qeverise qendrore e cila vitin e kaluar nepermjet AZHBR investoi ne shtimin e kapaciteteve magazinuese te bimeve etero-vajore ne zonen e Malesise se Madhe.

Zbatimi i projektit nuk kerkon njohuri shtese nga fermeret. Ajo qe kerkoet eshte mundesi financiare per te perballuar kostot financiare si dhe krah pune i lire ne familjet e fermereve.

Projekte te tjera te cilat mbeshtesin industrite perpunuese baze te bimeve etero-vajore jane drejtpersedrejt projektet qe nxisin shtimin e prodhimit dhe te hapesires se kultivuar me keto bime.

#### **6. Burimet e financimit të projektit**

**AZHBR**  
**USAID**  
**BE**  
**JAICA**

#### **7. Kosto e projektit**

Kosto e përafërt për subvencionimin e farës dhe promocionin e programit për tre vjet parashikohet të jetë rreth 30,000 Euro.

Titulli i projektit	Ngritja e Qendrës së Informimit të Fermerëve
Lloji i projektit	Zhvillimi i sektorit strategjik të bujqësisë
Vendndodhja e projektit	Koplik Zona funksionale Malësi e Madhe
Buxheti i vlerësuar gjithsej	15,000 ne vit

### **1. Analiza e problemit**

Analiza ekonomike e PZF ka nxjerrë në pah një numër problematikash që deri më tani kanë penguar shfrytëzimin e potencialit të të ardhurave të sektorit bujqësor në Malësi të Madhe. Një pjesë e tyre lidhet me tregun - mungesa e informacionit mes fermerëve mbi mundësitë për diversifikim të fermave apo avantazhin e farave autoktone dhe natyrale. Ngritja e një qendre informimi dhe drejtuese e fermerëve është një projekt ide në përgjigje të nevojës për të zgjidhur këto problematika dhe lejuar zgjerim të prodhimit bujqësor që gjen treg më të gjerë rajonal apo dhe ndërkufitar.

### **2. Objektivi i projektit**

Objektivi i projektit është mbështetja e fermerëve të zonës funksionale Malësi e Madhe me informacion në lidhje me tregun vendas e të huaj si dhe me mundësitë për përfitim të fondeve financiare për investime të nevojshme në përgjigje të kërkesës së tregut; marrja e informacionit të saktë është një element i rëndësishëm për të riorganizuar sektorin e bujqësisë - sektori parësor strategjik për zonën - në mënyrë të tillë që të shfrytëzohen avantazhet konkurruese dhe potenciali i të ardhurave.

### **3. Rezultatet e pritshme të projektit**

Rezultatet e pritshme të projektit janë fermerët të mirë informuar mbi potenciale afatgjata dhe të qëndrueshme të zhvillimit të fermave të tyre, e në veçanti për mundësitë që do të ofrojë toka aktualisht e pa kultivuar bujqësore dhe rishpërndarje e sipërfaqeve të kulturave që mbillen aktualisht në Malësi të Madhe.

Përfitues të drejtpërdrejtë janë fermerët e zonës funksionale, e cila numëron aktualisht rreth 8,222 ferma, kryesisht familjare. Nga ana tjetër, përfitues janë të gjithë banorët e saj, rreth 54,555, duke pasur parasysh se bujqësia është veçuar si sektori primar për zhvillimin e përgjithshëm ekonomik të saj.

### **4. Aktivitetet e projektit**

Aktivitetet kryesore të projektit për ngritjen e qendrës së informimit të fermerëve janë:

1. Rregullimi i kuadrit ligjor nën të cilin do të funksionojë kjo qendër informimi për zonën funksionale Malësi e Madhe.
2. Sigurimi i infrastrukturës së nevojshme për funksionimin e saj (ambienti, mjetet e punës)

3. Ngritja e një grupi specialistësh të sektorit të bujqësisë si dhe stafit operativ të qendrës.
4. Organizimi i një fushate informimi mbi hapjen e kësaj qendre dhe qëllimin e saj.

## 5. Pjekuria e projektit

Ngritja e një qendre informimi për fermerët është një projekt ide e cila ka për bazë nevojat e gjetura nga analiza ekonomike e PZF dhe rekomandimet e dhëna, të miratuara gjithashtu nga ekspertë të fushës së bujqësisë në Malësi të Madhe.

Një aktivitet i kyç paraprak për realizimin me sukses të projektit mund të veçohet hartimi i një plani për zgjerimin e tokës aktualisht të pa kultivuar bujqësore si dhe shfrytëzimin më efektiv të pjesës së kultivuar, në bazë të studimit të tregut rajonal dhe ndërkufitar. Informimi e drejtimi i fermerëve të zonës funksionale sipas një plani paraprak hedh gjithashtu bazat për bashkëpunim mes tyre.

## 6. Burimet e financimit të projektit

Donatorë të mundshëm të projektit janë identifikuar: Ministria e Bujqësisë dhe Shoqata e Fermerëve, të cilët janë të lidhur drejtpërdrejt me zhvillimin bujqësisë dhe kapaciteteve njerëzore në këtë drejtim.

## 7. Kosto e projektit

Elementi bazë i kostos së këtij projekti janë pagat e konsulentëve dhe organizatorëve të tij, si dhe një fond fillestar për sigurimin e infrastrukturës së nevojshme për ngritjen e qendrës.

Kosto e vitit të parë të qendrës vlerësohet në 20,000 Euro ku përfshihet edhe kosto e infrastrukturës ndërsa në vitet në vijim kostot e pritshme janë 15,000 Euro.

Titulli i projektit	Nxitje e investimeve për ngritjen e industrisë perpunuese të bimeve etero vajore
Lloji i projektit	Zhvillim i qendrueshëm i sektorit strategjik të bujqësisë
Vendndodhja e projektit	Fshatrat e Koplikut, Qendres, Gruemires, Shkrelit,
Buxheti i vlerësuar gjithsej	300,000 Euro

## 1. Analiza e problemit

Analiza ekonomike e Zonës Funksionale evidenton se janë rreth 3,570 ha toke bujqësore të cilat prodhojnë mesatarisht 9,000 kg bime etero-vajore në vit. Perfitimi kryesor nga këto bime është nxjerrja e perberësve të caktuar si vaji, esencat dhe perberës kimike të caktuar të cilët përdoren me pas në industrinë kozmetike, farmaceutike, ushqimore etj.

Cikli i produktit kalon nga fermeri tek grumbulluesi lokal per tu derguar me pas ne gjendje te paperpunuar tek grumbullues nderkombetare, posedues ose jo te nje industrie perpunimi te ketyre bimeve. Pothuajse i gjithe prodhimi i ketyre bimeve eshte i destinuar per eksport duke qene se ne vend nuk ka ndonje industri te njohur perpunimi dhe prodhimi te produkteve me baze esencat e nxjerra nga keto bime. Volumi i destinuar per perdorim familjar ne forme cajrash apo erezash eshte i paperfillshem.

Grumbullimi i bimeve, gjetja e tregut dhe eksportimi duhet te kryhen brenda nje peruidhe te caktuar dhe shume te kufizuar kohe gjate se ciles bima ruan vlerat e veta. Me kalimin e kesaj periudha bimet rrezikojne te kalben dhe humbasin vlerat. Prodhimi i nje viti nuk eshte i marketueshem ne vitin qe vjen.

Ekzitojne teknologji baze per nxjerrjen e vajit bruto nga bima etero/vajore. Futja e bimeve ne kete proces perpunimi fillestar redukton rrezikun e kalbjes se tyre dhe te humbjes se prodhimit ne rast te mos gjetjes se nje tregu te menjehershem. Ne rast te ekzistences se kesaj industrie objekti i konkurrueshem ne tregjet nderkombetare nuk do te ishte bima medicinale por ekstrakti i vajit bruto te nxjerre prej saj i cili i reziston kohes dhe lejon fleksibilitet ne gjetjen e tregjeve.

## **2. Objektivi i projektit**

Objektivi i projektit është financimi i ngritjes se nje pike perpunimi te bimeve medicinale me qellim nxjerrjen e vajit dhe esencave te tjera bruto nga keto bime per perpunim te metejshem ne fabrika te specializuara perendimore sipas destinacionit perkates industrial.

## **3. Rezultatet e pritshme të projektit**

Rezultatet e pritshme te projektit jane:

- Rritje e industrise se zones
- Reduktim i prodhimit te shkuar dem
- Vende te reja pune ne fabrike
- Menyre e re konkurrueshmerie ne tregun nderkombetar
- Shtim i tokes se punuar
- Rritje e qendrueshme e sektorit bujqesor
- Rritje e te ardhurave per familjet e fermereve
- Rritje e punesimit ne bujqesi per familjet qe shtojne sasine e tokes se punuar
- Rritje e ekspertizes ne perpunimin e bimeve etero-vajore.

## **4. Aktivitetet e projektit**

1. Studim i zgjidhjes teknologjike dhe i fizibilitetit te ngritjes se nje fabrike perpunimi per bimet etero vajore bazuar ne volumet e pritshme te prodhimit
2. Studim i formes ligjore te ekzistences (PPP, koncension, grant etc).

3. Studim i tregut kombetar e nderkombetar dhe i avantazheve konkurruese te produktit shqiptar
4. Projektim i linjes
5. Promovim i projektit dhe gjetja e bashkefinansuesve shteterore, donatore te huaj e private.
6. Zbatim i projektit, ngritje e fabrikes
7. Monitorim i rezultateve te viteve te para.

## **8. Pjekuria e projektit**

Grumbullimi i bimeve medicinale dhe dergimi i tyre per eksport nuk eshte nje zgjidhje afatgjate per prodhuesit e ketyre bimeve. Cdo vit gjetja ose mos gjetja ne kohe e nje grumbulluesi con ne mundesine e prishjes se prodhimit duke dhene nje goditje te forte financiare per fermeret e zones dhe duke kercenuar kultivimin e vitit pasardhes. Eshte momenti qe ky nen/sector te hyje ne nje faze te re zhvillimi i cili perfshin perpunimin paraprak te bimes. Ky zhvillim nuk eshte i parakohshem pasi ky nen/sector eshte i prapambetur krahasuar me dege te tjera te ngjashme te industrise ushqimore si perpunimi i vajit te ullirit, vajit te lulediellit etc pa folur per nje game te gjere te produkteve ushqimore te konservuara. Venia ne perdorim e linjes se perpunimit mund te kerkoje fillimisht prezencen e nje ekspertize te huaj per te garantuar edhe certifikimin e produktit. Ne te njejten kohe mund te trainohen eksperte vendas qe punojne ne industri te ngjashme.

Ekzistenca e nje linje perpunimi dhe perdorimi me eficence i saj do te coje ne stimulimin e rritjes se prodhimit te ketyre bimeve duke kontrinuar edhe ne projektin paralel te venies ne pune te tokave aktualisht te pambjella ne zonen e Malesise se Madhe dhe jo vetem.

Impakti i ketij investimi i kalon kufijte e ZF Malesi e Madhe dhe mund te jete me rendesi kombetare ne fushen e tij.

## **9. Burimet e financimit të projektit**

**AZHBR**  
**USAID**  
**BE**  
**JAICA**

## **10. Kosto e projektit**

Kostot e projektit do të përfshijnë projektimin, blerjen dhe instalimin e linjës së përpunimit dhe përmbledhen në një vlerë të përafërt prej 300,000 Euro

Titulli i projektit	Nxitje e investimeve per ngritjen e industrise perpunuese te geshtenjave
Lloji i projektit	Zhvillim i qendrueshem i sektorit strategjik te bujqesise
Vendndodhja e projektit	Fshatrat e Kelmendit e Kastratit
Buxheti i vlerësuar gjithsej	200,000 Euro

## 1. Analiza e problemit

Analiza ekonomike e Zones Funktionale evidenton se jane rreth 450 ha toke te mbjella me drure geshtenje, kryesisht ne zonen e Kelmendit e te Kastratit, nga të cilat mblidhen mesatarisht 1300 ton geshtenja ne vit. Perfitimi kryesor nga geshtenjat eshte shitja ne tregun vendas per perdorim direkt nga konsumatori si dhe shitja ne tregun e huaj per predorim direkt ose per perpunim te metejshem per industrine ushqimore.

Cikli i produktit kalon nga grumbulluesit individuale tek grumbulluesi lokal per tu derguar me pas ne gjendje te paperpunuar tek grumbullues nderkombetare, posedues ose jo te nje industrie perpunimi te geshtenjave. Eksporti i tyre ka ardhur ne rritje me nje treg shume te pelqyer ne Itali. Ne vend nuk ka ndonje industri te njohur perpunimi te geshtenjave dhe prodhimit te produkteve me baze esencat e nxjerra per industrine ushqimore. Volumi i destinuar per perdorim familjar eshte i vogel ne raport me prodhimin total. Nje pjese e prodhimit nuk vilet fare nga pemet si pasoje e mos pasjes se nje tregu te qarte.

Grumbullimi i geshtenjave, gjetja e tregut dhe eksportimi duhet te kryhen brenda nje peruidhe te caktuar dhe shume te kufizuar kohe gjate se ciles fruti ruan vlerat e veta. Me kalimin e kesaj peruidhe frutat rrezikojne te thahen dhe te humbasin vlerat e tyre. Prodhimi i nje viti nuk eshte i marketueshem ne vitin qe vjen.

Ekzistojne teknologji baze per zjerjen dhe konservimin e geshtenjave. Futja e frutit ne kete proces perpunimi fillestar redukton rrezikun e kalbjes, demtimit nga insekte humbjes se prodhimit ne rast te mos gjetjes se nje tregu te menjehershem. Ne rast te ekzistences se kesaj industrie objekti i konkurrueshem ne tregjet nderkombetare pervec geshtenjes se fresket do te ishte dhe geshtenjae zjere dhe e konservuar, produkt i cili i reziston kohes dhe lejon fleksibilitet ne gjetjen e tregjeve.

## 2. Objektivi i projektit

Objektivi i projektit është financimi i ngritjes se nje pike perpunimi te geshtenjve me qellim ruajtjen e vlerave ushqimore, rritjen e jetegjatesise se produktit per perpunim te metejshem ne fabrika te specializuara perendimore sipas destinacionit perkates industrial.

## 3. Rezultatet e pritshme të projektit

Rezultatet e pritshme te projektit jane:

- Rritje e industrise se zones
- Reduktim i prodhimit te shkuar dem
- Vende te reja pune ne fabrike
- Menyre e re konkurrueshmerie ne tregun nderkombetar
- Nxitje per shtim te tokes se pyllezuar me geshtenja
- Rritje e qendrueshme e sektorit bujqesor
- Rritje e te ardhurave per familjet e fermereve
- Rritje e punesimit ne bujqesi per familjet qe shtojne sasine e tokes se punuar
- Rritje e ekspertizes ne perpunimin e geshtenjave autoktone.

#### **4. Aktivitetet e projektit**

1. Studim i zgjidhjes teknologjike dhe i fizibilitetit te ngritjes se nje fabrike perpunimi per geshtenjen autoktone shqiptare bazuar ne volumet e pritshme te prodhimit
2. Studim i formes ligjore te ekzistences (PPP, koncension, grant etc).
3. Studim i tregut kombetar e nderkombetar dhe i avantazheve konkurruese te produktit shqiptar
4. Projektim i linjes
5. Promovim i projektit dhe gjetja e bashkefinansuesve shteterore, donatore te huaj e private.
6. Zbatim i projektit, ngritje e fabrikes
7. Monitorim i rezultateve te viteve te para.

#### **8. Pjekuria e projektit**

Grumbullimi i geshtenjave dhe dergimi i tyre per eksport nuk eshte nje zgjidhje afatgjate per mbledhesit e kesaj bime ne zonen malore te Malesise se Madhe. Cdo vit gjetja ose mos gjetja ne kohe e nje grumbulluesi con ne mundesine e prishjes se prodhimit duke ulur te ardhurat dhe dekurajuar fermeret e zones per kultivimin dhe grumbullimin e vitit pasardhes. Eshte momenti qe ky nen/sector te hyje ne nje faze te re zhvillimi i cili perfshin perpunimin paraprak te produktit. Ky zhvillim nuk eshte i parakohshem pasi ky nen/sector eshte i prapambetur krahasuar me dege te tjera te ngjashme te industrise ushqimore si perpunimi i vajit te ullirit, vajit te lulediellit etc pa folur per nje game te gjere te produkteve ushqimore te konservuara. Venia ne perdorim e linjes se perpunimit mund te kerkoje fillimisht prezencen e nje ekspertize te huaj per te garantuar edhe certifikimin e produktit. Ne te njejten kohe mund te trainohen eksperte vendas qe punojne ne industri te ngjashme.

Ekzistenca e nje linje perpunimi dhe perdorimi me eficence i saj do te coje ne stimulimin e krijimit te pyjeve te reja me geshtenja krijimi i te cilave kerkon nje periudhe te konsiderueshme kohe per tu vene ne eficence (tre deri ne kater vjet) por garanton prodhim te vazhdueshem.

Impakti i ketij investimi i kalon kufijte e ZF Malesi e Madhe dhe mund te jete me rendesi kombetare ne fushen e tij.



## 9. Burimet e financimit të projektit

AZHBR  
FZHR  
FSHZH  
USAID  
BE  
JAICA

## 10. Kosto e projektit

Kostot e projektit do të përfshijnë projektimin, blerjen dhe instalimin e linjës së përpunimit dhe përmbliidhen në një vlerë të përafërt prej 200,000 Euro.

Titulli i projektit	Program për zëvendësimin e çatave me eternit/llamarinë në Komunën Kelmend
Lloji i projektit	Spektori strategjik i turizmit
Vendndodhja e projektit	Komuna Kelmend, ZF Malësi e Madhe
Buxheti i vlerësuar gjithsej	350,000 Euro

### 1. Analiza e problemit

Në Kelmend, gjenden sot 105 shtëpi me çati të ndërtuara nga materiali eternit (me baze asbesti), i cili është përdorur gjerësisht në dekadat e mëparshme në ndërtim, por që më vonë është vlerësuar në shkallë ndërkombëtare shumë i dëmshëm për shëndetin e njerëzve që ekspozohen direkt me të gjatë punës ose dhe gjatë jetesës në shtëpi.

Largimi i çatave me eternit është një domosdoshmëri në dy drejtime: për sigurimin e shëndetit të banorëve dhe për zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit në zonë funksionale të Malësisë së Madhe.

Gjithashtu të përhapura në Komunën Kelmend janë dhe çatitë me llamarinë, të cilat nuk janë një element tërheqës për vizitorët.

Duke qenë se turizmi është një nga dy sektorët strategjikë të gjetur nga analiza ekonomike për PZF, dhe Kelmendi është një nga zonat me potencialin kryesor për zhvillimin e turizmit malor e alpin në të ardhmen, është i nevojshëm zëvendësimi i këtyre dy materialeve të ndërtimit të çatave me materiale më të përshtatshme.

### 2. Objektivi i projektit

Projekti mund të shihet i përbërë nga dy komponentë:

1. Zëvendësimi i çative me eternit në zonat turistike të Komunës Kelmend, nga 105 shtëpi me çati të tilla që aktualisht gjenden në të gjithë komunën.
2. Zëvendësimi i çative me llamarinë në zonat turistike të Komunës Kelmend.

Këta komponentë do të jenë në mbështetje të zhvillimit të qëndrueshëm të turizmit në këtë zonë, përveçse është në përfitim të drejtpërdrejtë të shëndetit të banorëve që aktualisht jetojnë në këto shtëpi.

### **3. Rezultatet e pritshme të projektit**

Rezultati i programit janë shtëpitë me çati të ndëtuara nga materiale bashkëkohore të padëmshme për shëndetin e banorëve dhe karakteristike të fshatrave malorë të Komunës Kelmend.

Numri i shtëpive që mund të përfitojnë nga komponenti i parë i projektit - largimi i çative me eternit - arrin deri në 105.

Nga të dy komponentët, me ndërtimin në Kelmend të çative me materiale më karakteristike të zonave malore, nga programi përfitojnë të gjithë banorët e zonës funksionale Malësi e Madhe, rreth 54,555 banorë gjithsej, në formën e shtimit të numrit të vizitorëve.

### **4. Aktivitetet e projektit**

Aktivitetet kryesore të projektit janë largimi i çative me eternit apo llamarinë të një numri shtëpish dhe rindërtimi i tyre me material të padëmshëm për shëndetin dhe karakteristik të zonës alpine të Kelmendit.

### **5. Pjekuria e projektit**

Çështja e çative të ndëtuara me eternit në zonën turistike të Kelmendit është ngritur në analizën e sektorit strategjik të turizmit nisur nga të dhënët e marra nga shoqëria italiane V.I.S, e cila mbështet prej disa vitesh deri më tani zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm alpin në Komunën Kelmend dhe Shkrel. Programi i propozuar këtu është një ide që vjen në përgjigje të kësaj çështjeje dhe rekomandimit për zgjidhjen e saj në analizë. Aktualisht është në proces tenderimi një projekt për zëvendësimin e çative me eternit si edhe ato me llamarinë të fshatit Tamarë. Programi do të jetë një vazhdim i kësaj ndërmarrjeje nga Komuna Kelmend duke e shtrirë më tej në fshatra të tjerë të zonës.

### **6. Burimet e financimit të projektit**

Lidhur me projektin janë identifikuar këta donatorë të mundshëm: EU, Buxheti Qendror në kuadër të Strategjisë Kombëtare të Turizmit 2014-2020, GIZ, si dhe Ministria e Shëndetësisë. Këta donatorë janë evidentuar si të mundshëm nisur nga madhësia e projektit dhe natyra e tij.

## 7. Kosto e projektit

Sipas informacioneve nga Komuna Kelmend, kosto e heqjes së çatave me eternit ose llamarinë dhe rindërtimit të tyre me material druri është vlerësuar rreth 70 EUR/m<sup>2</sup>, ndërsa sipërfaqja mesatare e një shtëpie në këtë zonë është 100 m<sup>2</sup>. Kështu, për një shtëpi, kosto e këtij projekti mund të përafrohet në 7,000 EUR.

Kosto e zevendesimit e përlogaritur për 50 shtëpi është 350,00 Euro.

Titulli i projektit	Nxitje e investimeve per ngritjen e industrise perpunuese te duhanit
Lloji i projektit	Zhvillim i qendrueshem i sektorit strategjik te bujqesise
Vendndodhja e projektit	Fshatrat e Koplikut, Qendres, Gruemires, Shkrelit,
Buxheti i vlerësuar gjithsej	250, 000 Euro

### 1. Analiza e problemit

Analiza ekonomike e Zones Funktionale evidenton se jane rreth 238 ha toke bujqesore te cilat prodhojne rmesatarisht 250 ton duhan ne vit. Prodhimi arriti pikun në vitin 2013 me 600 tonë por nuk arriti të shitej i gjithi. Perfitimi kryesor nga duhani eshte eksportimi i gjetheve te tij pas procesit te tharjes dhe grumbullimit paraprak.

Cikli i produktit kalon nga mbledhja e gjetheve nga fermeret individuale, tharja e tyre dhe dergimi tek grumbulluesi lokal per tu derguar me pas ne gjendje te paperpunuar tek grumbullues nderkombetare, posedues ose jo te nje industrie perpunimi te metejsheem te duahnit. Pothuajse i gjithë prodhimi i duhanit eshte i destinuar per eksport duke qene se ne vend nuk ka ndonje industri te njohur perpunimi. Volumi i destinuar per perdorim individual ne vend i njohur si “duhan me te dredhur” eshte i paperfillshem.

Grumbullimi i bimeve, gjetja e tregut dhe eksportimi duhet te kryhen brenda nje peruidhe te caktuar dhe shume te kufizuar kohe gjate se ciles bima ruan vlerat e veta. Me kalimin e kesaj periudha bimet rrezikojne te kalben dhe humbasin vlerat. Prodhimi i nje viti nuk eshte i marketueshem ne vitin qe vjen nqse nuk eshte i ruajtur mire.

Tregu nderkombetar i duhat bruto shqiptar ka ardhur ne renie dhe si pasoje edhe motivimi per ta kultivuar ate. Kjo tendence eshte e papranueshme per banoret e zones te cilet i referohen periudhes se ekonomise komuniste kur industria e duhanit prodhonte produkte te preferueshme per tregun vendas por edhe ate te huaj.

Ekspertet mendojne se rivitaizimi i produkteve vendase te duhanit mund te konkuroje produktet e shtrenjta te importit ne cmim dhe cilesi duke ju dhene shqiptareve nje mundesi per te shijuar duhanin vendas dhe duhen ju dhene fermerëve nje mundesi per te kultivuar ate bime per te cilen dikur ka patur shume tradite dhe njohuri. Ne rast te ekzistences se kesaj industrie objekti i konkurrueshem ne tregun vendas dhe ne tregjet nderkombetare nuk do te ishte gjethja e duhanit por markat tradicionale te cigareve shqiptare.

## **2. Objektivi i projektit**

Objektivi i projektit është financimi i ngritjes se nje fabrike duhani me qellim prodhimin e cigareve me brande te njohura vendase qe revokojne suksesin e dikurshem, ose perpunimin fillestar te duhanit (tharjen, grirjen, paketimin) per perpunim te metejshem ne fabrika te specializuara perendimore.

## **3. Rezultatet e pritshme të projektit**

Rezultatet e pritshme te projektit jane:

- Rritje e industrise se zones
- Reduktim i prodhimit te shkuar dem
- Vende te reja pune ne fabrike
- Menyre e re konkurrueshmerie ne tregun vendas dhe nderkombetar
- Shtim i tokes se punuar
- Rritje e qendrueshme e sektorit bujqesor
- Rritje e te ardhurave per familjet e fermerëve
- Rritje e punesimit ne bujqesi per familjet qe shtojne sasine e tokes se punuar
- Rritje e ekspertizes ne perpunimin e bimeve etero-vajore.

## **4. Aktivitetet e projektit**

1. Studim i zgjidhjes teknologjike dhe i fizibilitetit te ngritjes se nje fabrike perpunimi per bimet etero vajore bazuar ne volumet e pritshme te prodhimit
2. Studim i formes ligjore te ekzistences (PPP, koncension, grant etc).
3. Studim i tregut kombetar e nderkombetar dhe i avantazheve konkurruese te produktit shqiptar
4. Projektim i linjes
5. Promovim i projektit dhe gjetja e bashkefinancuesve shteterore, donatore te huaj e private.
6. Zbatim i projektit, ngritje e fabrikes
7. Monitorim i rezultateve te viteve te para.

## **5. Pjekuria e projektit**

Shqiperia dhe Shkodra ne vecanti kane tradite ne kultivimin e duhanit dhe prodhimin e cigareve. Kjo tradite nuk ka humbur dhe ka nje hapesire ne treg per nje produkt vendas i cil mund te

rezultate të sukseshme dhe të konkurojë në çmim produktet gjithmone e me të shtrenjta të importit. Çdo vit gjetja ose mos gjetja në kohë e një grumbulluesi në mundësi të prishjes së prodhimit duke dhënë një goditje të fortë financiare për fermerët e zonës dhe duke kërcënuar kultivimin e vitit pasardhës. Është momenti që ky nën/sector të hyjë në një fazë të re zhvillimi i cili përfshin përpunimin paraprak ose të plotë të gjethes së duhanit. Ky zhvillim nuk është i parakohshëm pasi ky nën/sector është i prapambetur krahasuar me degete të tjera të ngjashme të industrisë ushqimore si përpunimi i vajit të ullirit, vajit të lulediellit etj pa folur për një gamë të gjërë të produkteve ushqimore të konservuara. Venia në përdorim e linjes së përpunimit të duhanit mund të kërkojë fillimisht prezencën e një ekspertize të huaj për të garantuar edhe certifikimin e produktit. Në të njëjtën kohë mund të trajnohen eksperte vendas që punojnë në industri të ngjashme.

Ekzistenca e një linje përpunimi dhe përdorimi me efikasitet i saj do të çojë në stimulimin e rritjes së prodhimit të këtyre bimëve duke kontribuar edhe në projektin paralel të venies në punë të tokave aktualisht të pambjella në zonën e Malësisë së Madhe dhe jo vetëm.

Impakti i këtij investimi i kalon kufijtë e ZF Malësi e Madhe dhe mund të jetë me rëndësi kombëtare në fushën e tij.

## **6. Burimet e financimit të projektit**

**AZHBR**  
**USAID**  
**BE**  
**JAICA**

## **7. Kosto e projektit**

Kostot e projektit do të përfshijnë projektimin, blerjen dhe instalimin e linjës së përpunimit dhe përmblidhen në një vlerë të përafërt prej 250,000 Euro.

Titulli i projektit	Hartimi i një plani strategjik të zhvillimit të turizmit në zonën funksionale Malësi e Madhe
Lloji i projektit	Sektori strategjik i turizmit
Vendndodhja e projektit	Zona Funksionale Malësi e Madhe
Buxheti i vlerësuar gjithsej	20,000 Euro

## **1. Analiza e problemit**

Analiza ekonomike e PZF veçon turizmin si një ndër dy sektorët kyç për zhvillimin e ardhshëm ekonomik të Malësisë së Madhe. Ky sektor është zhvilluar deri më tani i ndarë sipas njësive

vendore, për këtë arsye, një hap i parë i rëndësishëm për zhvillimin tërësor të tij në zonën funksionale është hartimi i një plani strategjik zhvillimi i cili të përfshijë të gjitha pikat turistike, vlerat natyrore, kulturore, arkeologjike e historike të zonës si një e tërë. Plani duhet të jetë në koherencë dhe me Draft-Strategjinë Kombëtare të Turizmit 2014-2020.

## **2. Objektivi i projektit**

Hartimi i një dokumenti të zhvillimit strategjik të turizmit liqenor dhe malor të zonës funksionale, i cili bashkërendon të gjitha pikat turistike të saj; ky dokument do të ndihmojë njësinë vendore në përfitim të fondeve për ngritjen e infrastrukturës në zbatim të këtij plani, duke shërbyer dhe si sinjal për drejtimin e investimeve nga sipërmarrësit e zonës në fushën e turizmit.

## **3. Rzultatet e pritshme të projektit**

Rezultati kryesor i projektit do të jetë dokumenti i planit strategjik të zhvillimit të turizmit në zonën funksionale, në përfitim të administratës së ardhshme vendore - për drejtimin e investimeve në infrastrukturë, si dhe të banorëve të saj, rreth 54,555 banorë, si një mjet bazë i zhvillimit të sektorit të turizmit.

## **4. Aktivitetet e projektit**

Projekti mund të përfshijë aktivitetet e mëposhtme:

1. Ngritja e një grupi pune me ekspertë të territorit të Malësisë së Madhe dhe vlerave natyrore, kulturore, arkeologjike e historike të krahinës.
2. Përgatitja e një harte turistike të Malësisë së Madhe ku tregohen pikat e saj turistike, si edhe shtigjet e rrugët e kalimit.
3. Hartimi i një plani strategjik të zhvillimit të turizmit malor dhe liqenor në zonë.
4. Hartimi i paketave turistike gjithëpërfshirëse të zonës funksionale.

Realizimi i projektit mund të shtrihet në një hark kohor deri në gjashtë muaj.

## **5. Pjekuria e projektit**

Ky projekt është një ide e cila vjen në përgjigje të nevojës për integrimin e zhvillimit të turizmit në Malësinë e Madhe si një njësi e vetme vendore, dhe nxjerrjen në pah të pikave turistike.

Aktualisht ekzistojnë plane strategjike veprimi apo zhvillimi të turizmit me objekt shpesh liqenin e Shkodrës dhe pjesën e Alpeve të Shqipërisë. Nisur nga kjo, një aktivitet i nevojshëm paraprak për realizimin me sukses të këtij projekti mund të jetë bashkërendimi i planeve strategjike të kësaj natyre, të ndërmarra nga donatorë të ndryshëm dhe në zhvillim e sipër, të cilët kanë në fokus një pikë turistike, një pjesë të zonës funksionale ose që shtrihen në nivel ndër zonal apo dhe ndërkufitar.

## 6. Burimet e financimit të projektit

Donatorë të mundshëm të projektit janë: Ministria e Kulturës, IPA dhe GIZ.

## 7. Kosto e projektit

Kosto e pritshme e ekspertizës së specializuar për kete studim është 20,000 Euro.

Titulli i projektit	Trajnim në hoteleri dhe menaxhim bujtinash, kombinuar me agroturizëm
Lloji i projektit	Sektori strategjik i turizmit
Vendndodhja e projektit	Zona Funksionale Malësi e Madhe
Buxheti i vlerësuar gjithsej	30,000 Euro

### 1. Analiza e problemit

Një nga elementët më kyç të zhvillimit ekonomik dhe shoqëror të zonës funksionale Malësi e Madhe, përkrah burimeve natyrore dhe infrastrukturës, është arsimimi i forcës punëtore në drejtim të sektorëve më strategjikë. Në analizën e PZF, treguesit e arsimit dhe punësimit nxjerrin në pah një nevojë të lartë për specializim të popullsisë në moshë pune, e cila ka kryesisht arsim 8-9 vjeçar. Gjithashtu, analiza veçon turizmin si një nga dy sektorët me potencial më të madh të ardhurash në Malësi të Madhe.

Me qëllim krijimin e kushteve për zhvillimin e këtij sektori, është i nevojshëm trajnimi i forcës punëtore në fushën e hotelerisë, menaxhimit të bujtinave apo formave të tjera të shërbimeve me natyrë turistike, si dhe të gastronomisë, duke drejtuar këtu sipërmarrësit drejt produkteve bujqësore e blegtorale natyrore apo ushqimeve sloë-food tipike të krahinës.

### 2. Objektivi i projektit

Objektivi i projektit është trajnimi i popullsisë në moshë pune në zonën funksionale Malësi e Madhe të interesuar për të punuar në sektorin e turizmit malor apo liqenor, në fushën e menaxhimit, shërbimit apo gastronomisë.

### 3. Rezultatet e pritshme të projektit

Rezultatet e pritshme të këtij projekti janë një forcë punëtore më e specializuar për punën në sektorin strategjik të turizmit në zonën funksionale si dhe e sensibilizuar për vlerat e produkteve ushqimore tradicionale dhe natyrore dhe ndërlidhjen (sinergjinë) e tyre me zhvillimin e turizmit.

#### **4. Aktivitetet e projektit**

Aktivitetet kryesore që mund të parashikohen në projekt janë si më poshtë:

1. Ndërmarrja e një fushate informuese dhe nxitëse drejtuar personave në moshë pune në zonën funksionale që aktualisht punojnë ose janë të interesuar të punonjnë në sektorin e turizmit.
2. Organizimi i trajnimeve në fushën e hotelerisë, menaxhimit të bujtinave, shërbimit të klientëve.
3. Drejtimi i sipërmarrësve në fushën e turizmit në zonë drejt ofrimit të ushqimeve natyrore, karakteristike e pjatave tipike të krahinës me qëllim rritjen e numrit të vizitorëve.

Trajnimet në fushën e hoteleri-turizmit mund të zhvillohen në bazë të një programi në faza të njëpasnjëshme për një periudhë disa mujore deri një vjeçare.

#### **5. Pjekuria e projektit**

Projekti për trajnimin e forcës punëtore në Malësinë e Madhe në fushën e hotelerisë, menaxhimit të bujtinave apo agroturizmit është një ide në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm të sektorit strategjik të turizmit. Një ndërmarrje e ngjashme kryhet rregullisht në njësinë vendore Kelmend dhe Shkrel nga shoqëria italiane V.I.S, ndërsa është me vend zgjerimi i saj dhe në pjesën tjetër të popullsisë së zonës funksionale.

#### **6. Burimet e financimit të projektit**

Donatorë të mundshëm të këtij projekti janë: Buxheti Qendror, EU e UNDP, në bazë të fokusit të projektit në zhvillimin e kapaciteteve humane me synim zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit në zonën funksionale.

#### **7. Kosto e projektit**

Baza e koston së këtij projekti do të jenë paga e stafit trajnues, specialist në fushat e ndryshme që do të jenë pjesë e programit të trajnimit. Trainimi mund të përfshijë dy deri në tre sesione në tema të ndryshme.



## PROJEKTE TE PERMIRESIMIT TE SHERBIMEVE PUBLIKE

Titulli i projektit	Financim i studimit urbanistik për zhvillimin e zonës turistike pranë bregut të liqenit
Lloji i projektit	Zhvillim i qëndrueshëm i sektorit strategjik të turizmit, zhvillim i shërbimit publik të menaxhimit të territorit
Vendndodhja e projektit	Bregu i liqenit të Shkodrës pranë Koplikut, Qendrës, Gruemirës e Shkrelit
Buxheti i vlerësuar gjithsej	80,000 Euro

### 1. Analiza e problemit

Bazuar në informacionin e marrë nga banorët e zonës dhe grupet e interesit peshkimi dhe turizmi konsiderohen si fushat me aktivitet potencial për fshatrat përreth liqenit.

Turizmi konsiderohet si zgjidhja e të gjitha problemeve ekonomike për shkak të mungesës së eksperiencës dhe të mos kuptuarit e tij. Mungesa e planifikimit dhe e forcës së ligjit, modeli laissez-faire i ndjekur për t'i dhënë shtysë ekonomisë, iniciativat private të filluara pa analiza të shëndosha të tregut përbëjnë qasjen e ndjekur deri më tani në bregdetin shqiptar. Kjo qasje ka prodhuar ndikime negative në mjedis dhe mos arritjen e rezultateve të dëshiruara ekonomike.

Për rrjedhojë, sfidat nga ndikimi i zhvillimeve ekonomike dhe urbane në liqen janë të mëdha. Zhvillimi i qëndrueshëm i zonës kërkon planifikim të kujdesshëm, bashkëpunim ndërmjet aktorëve për krijimin dhe nxitjen e burimeve alternative të të ardhurave dhe aktiviteteve ekonomike. Kjo nënkupton se mbrojtja e liqenit nuk mund të arrihet vetëm nga administrata e zonës së mbrojtur dhe rolit statik të saj.

Nevojitet një qasje e qartë proaktive, bashkëpunuese dhe komunikuese për të garantuar që jo vetëm zhvillimet dhe aktivitetet ekonomike aktuale por edhe ato të ardhshme të mos ndikojnë negativisht në zonën e mbrojtur të liqenit.

Një studim urbanistik për zhvillimin e zonës turistike pranë liqenit duke patur parasysh konceptin e zonimit ekonomik dhe zhvillimin e kujdesshëm të turizmit do të përbënte drejtimin udhëheqës për aktorët vendimarrës në ZF Malësi e Madhe.

### 2. Objektivi i projektit

Objektivi i projektit është financimi i hartimit të një plani urbanistik për zhvillimin e zonës turistike pranë liqenit duke patur parasysh konceptin e zonimit ekonomik dhe zhvillimin e kujdesshëm të turizmit.

### 3. Rezultatet e pritshme të projektit

Rezultatet e pritshme të projektit janë:

- Plan i hartuar për zhvillimin e bregut të liqenit
- Celje e rrugës për investime të mirëplanifikuara
- Shtim i numrit të aktivitete pranë bregut të liqenit
- Shtim i numrit të vizitorëve
- Shtim i gamës së shërbimeve dhe bizneseve
- Rritje e të ardhurave
- Vende të reja pune

#### **4. Aktivitetet e projektit**

1. Studim i zonës etero vajore bazuar në volumet e pritshme të prodhimit
2. Hartim i planit të zhvillimit urban Studim i formës ligjore të ekzistencës (PPP, koncension, grant etc).

#### **5. Pjekuria e projektit**

Aktualisht nuk ekziston asnjë plan për zhvillimin e zonës së bregut të zonës verilindore të bregut të liqenit të Shkodrës. Studimi duhet të jetë pjesë e Planit Urbanistik të ZF Malësi e Madhe por mund të ekzistojë edhe si studim i pjesshëm vetëm për zonën në fjalë me qëllim hapjes rrugë të disa përmirësimeve në infrastrukturë, mjedis e shërbime.

#### **6. Burimet e financimit të projektit**

**FZHR**  
**FSHZH**

#### **7. Kosto e projektit**

Kosto e vlerësuar e një studimi të planifikimit urban për një territor të tillë është 80,000 Euro.

Titulli i projektit	Ndërtim i rrugës për këmbësorë e biçikleta përgjatë bregut të Liqenit të Shkodrës
Lloji i projektit	Shërbimet publike/Sektori strategjik i turizmit/ Sektori i shërbimeve
Vendndodhja e projektit	Vija bregore e Liqenit të Shkodrës në ZF Malësi e Madhe NJ.Q.V Qendër, Kastat, Koplik, Guremirë
Buxheti i vlerësuar gjithsej	

### 1. Analiza e problemit

Ndër gjetjet e analizës ekonomike të PZF mbi gjendjen e tanishme të sektorit të turizmit në pjesën fushore të zonës funksionale Malësi e Madhe është mungesa e theksuar e infrastrukturës rrugore në fshatrat e bregut të Liqenit të Shkodrës si dhe e aktiviteteve zbavitëse përgjatë tij. Kështu, projekt ideja për ndërtimin e një rruge për këmbësorë e biçikleta përgjatë bregut të Liqenit i përgjigjet nevojës për të nxitur turizmin liqenor, por jo vetëm.

Në gërshetim me tërheqjen e vizitorëve, ndërtimi i kësaj rruge mund t'i japë nxitje tregtisë së produkteve vendase, restoranteve, kampingjeve e formave të tjera të zhvillimit të sektorit të shërbimeve, ndërsa është në funksion dhe të përmirësimit të shërbimeve publike të njësisë së ardhshme vendore.

### 2. Objektivi i projektit

Objektivi i projektit është nxitja e zhvillimit të turizmit liqenor në pjesën fushore të zonës funksionale përmes shtimit të mundësive të veprimtarive dhe argëtimit të banorëve e vizitorëve. Projekti mund të sjellë përfitim në radhë të parë për banorët e njësive vendore me dalje në liqen, që janë Komuna Qendër, Kastat, Gruemirë dhe Koplik përmes zhvillimit ekonomik por edhe përmirësimit të infrastrukturës rrugore përreth tyre.

### 3. Rezultatet e pritshme të projektit

Rezultatet e pritshme të projektit janë:

1. një rrugë këmbësorësh dhe biçikletash e ndriçuar përgjatë vijës rreth 30 km të bregut të Liqenit të Shkodrës në Malësi të Madhe;
2. rritje e aksesit drejt liqenit duke marrë parasysh se, deri më tani, një lloj i tillë rruge mungon në gjatësinë më të madhe të vijës bregore;
3. rritje e numrit të vizitorëve dhe zhvillim të sektorit të shërbimeve

Numri i banorëve të katër njësive vendore që kanë dalje në liqen, pra drejtpërdrejt përfituese të ndërtimit të rrugës, është rreth 42,000 – afërsisht 77 % të popullsisë së gjithë zonës funksionale.

#### 4. Aktivitetet e projektit

Projekti mund të zhvillohet sipas fazave të mëposhtme të punimeve:

1. Rikonstruksion i shtresave të rrugës, vendosja e shtresave të asfaltit
2. Ndërtim i trotuareve
3. Ndërtim i një korsie për biçikleta
4. Punime elektrike për ndriçimin e rrugës

Për një gjatësi rruge rreth 30 km parashikohet një kohë punimesh ndërtimi rreth 3 vjet.

#### 5. Pjekuria e projektit

Projekti është një ide e nisur në bazë të nevojave të zhvillimit ekonomik dhe infrastrukturor të gjetura nga analiza e PZF.

Aktivitetet paraprak kyç që do të nevojitet është një studim urbanistik e teknik i të gjithë vijës bregore të liqenit përgjatë së cilës është më e përshtatshme të kalojë rruga. Ky aktivitet do t'i japë qëndrueshmëri projektit, i cili pritet të jetë afatgjatë duke marrë parasysh gjatësinë prej 30 km të vijës që mbulon kjo projekt ide.

#### 6. Burimet e financimit të projektit

Donatorë të mundshëm për këtë projekt janë identifikuar: Buxheti Qendror, Buxheti Vendor, Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe EU.

#### 7. Kosto e projektit

Në bazë të investimeve në infrastrukturën rrugore të vendit të financuara nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit gjatë viteve 2005-2013 (referuar veçanërisht ndërtimit të një rruge të ngjashme në segmentin Shkodër-Shirokë), mund të përafrojmë një kosto të ndërtimit të një rruge këmbësorësh dhe biçikletash prej 33,800,000 lekë/km ose 245,000 euro/km.

Titulli i projektit	Ndërtim i rrugëve lidhëse të qendrave të banuara me bregun e Liqenit të Shkodrës
Lloji i projektit	Shërbimet publike/Sektori strategjik i turizmit
Vendndodhja e projektit	NJ.V.Q Qendër, Gruemirë, Koplik, Kastrat NJ.V.Q Qendër, Gruemirë, Koplik, Kastrat
Buxheti i vlerësuar gjithsej	

## **1. Analiza e problemit**

Projekti për ndërtimin e rrugëve lidhëse të qendrave kryesore të banuara të zonës funksionale Malësi e Madhe me liqenin e Shkodrës i drejtohet nevojës për të ngritur infrastrukturën rrugore të zonës funksionale. Kjo nevojë është nxjerrë në pah në analizën e shërbimeve publike të PZF si një nga mangësitë kryesore që përcaktojnë standardin e jetesës së tanishme të banorëve dhe që lidhet ngushtë me mundsitë për shfrytëzimin e potencialit të të ardhurave nga turizmi liqenor. Gjithashtu, ndërtimi i rrugëve lidhëse është i nevojshëm për të mbështetur paketat që përfshijnë një tërësi pikash turistike që zgjaten nga pjesa liqenore deri në atë malore të zonës funksionale.

## **2. Objektivi i projektit**

Objektivi i këtij projekti është ngritja e infrastrukturës rrugore të nevojshme për shtimin e lëvizjes së banorëve të zonës funksionale drejt liqenit të Shkodrës, duke krijuar mundësinë e tërheqjes së vizitorëve në zonë si dhe dendësuar bashkëveprimin mes qendrave të banuara për qëllime ekonomike dhe sociale.

## **3. Rezultatet e pritshme të projektit**

Rezultatet e pritshme më të matshme të projektit janë:

1. Rrugë të asfaltuara të cilat lidhin me bregun e liqenit të Shkodrës qendrat dhe fshatrat e njësive vendore Qendër, Gruemirë, Kastrat e Koplík - një popullsi rreth 42,000 banorë ose 77 % e popullsisë gjithsej të Malësisë së Madhe.
2. Shtimi i dendësisë së lëvizjeve të këtyre banorëve drejt bregut të liqenit të Shkodrës.
3. Shtimi i numrit të vizitorëve në zonën funksionale Malësi e Madhe të cilët zgjedhin turizmin liqenor.

## **4. Aktivitetet e projektit**

Projekti mund të zhvillohet sipas fazave të mëposhtme të punimeve:

1. Rikonstruksion i shtresave të rrugës, vendosja e shtresave të asfaltit
2. Punime elektrike për ndriçimin e rrugës
3. Vendosja e sinjalistikës rrugore (tabela turistike)

## **5. Pjekuria e projektit**

Projekti për ndërtimin e rrugëve lidhëse të qendrave të banuara të zonës fushore të Malësisë së Madhe me liqenin e Shkodrës është një ide për të zgjidhur nevojën e plotësimit të zonës me infrastrukturën rrugore më bazë.

Realizimi i kësaj ideje është një ndër një numër masash për ngritjen e infrastrukturës më bazë të nevojshme për të nxitur zhvillimin e sektorit të turizmit në zonën funksionale.

## 6. Burimet e financimit të projektit

Donatorë të mundshëm të projektit janë: Buxheti Qendror, Buxheti Vendorë, Regional Development Program dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit. Këta donatorë janë evidentuar si të mundshëm meqënëse fokusi i tyre lidhet ndër të tjera me zhvillimin e infrastrukturës vendore me synim promovimin e mëtejshëm të turizmit.

## 7. Kosto e projektit

Në bazë të Listës së Rrugëve të Financuara nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit 2005-2013, për ndërtim rruge në zona të ulta në veri të vendit, mund të përafrojmë një kosto ndërtimi rreth 4,000,000 lekë/km ose rreth 28,000 EUR/km.

Titulli i projektit	Sistemim hapësire të gjelbëruar përgjatë bregut të Liqenit të Shkodrës
Lloji i projektit	Shërbimet publike/Spektori strategjik i turizmit/ Spektori i shërbimeve
Vendndodhja e projektit	Vija bregore e Liqenit të Shkodrës në ZF Malësi e Madhe NJ.Q.V Qendër, Kastat, Koplík, Guremirë
Buxheti i vlerësuar gjithsej	50,000 Euro

### 1. Analiza e problemit

Liqeni i Shkodrës është pjesë e kyçe e potencialit të të ardhurave nga turizmi liqenor i pjesës fushore të zonës funksionale Malësi e Madhe. Në analizën e PZF nënvijëzohet statusi i zonës së mbrojtur që ka aktualisht liqeni, dhe gjithashtu rehabilitimi i florës dhe faunës së tij si një pikënisje e nevojshme për zhvillim të qëndrueshëm i turizmit në këtë zonë në të ardhmen. Në këto kushte, sistemimi dhe gjelbërimi i bregut të liqenit, me bazë bimësinë që karakterizon pellgun, është një hap fillestar, i cili duhet të ndiqet nga format të tjera të rigjallërimit të qëndrueshëm të jetës së liqenit.

### 2. Objektivi i projektit

Projekti synon tërheqjen e vizitorëve në zonën e Malësisë së Madhe dhe gjithashtu shtimin e njësisive tregtare, restoranteve dhe shërbimeve në përgjithësi, me anë të rigjallërimit të florës së liqenit të Shkodrës.

### 3. Rezultatet e pritshme të projektit

Rezultatet e pritshme të projektit janë rritja e numrit të vizitorëve në zonën përreth bregut të liqenit si dhe shtimi apo zgjerimi i shërbimeve tregtare, të restoranteve etj. Drejtpërdrejt,

ndikohen fshatrat e vijës bregore të liqenit nëpërmjet bizneseve me natyrë turistike apo të shërbimeve, ndërsa njësitë vendore përkatëse përbëjnë gjithsej 77 % të popullsisë zë zonës funksionale (rreth 42,000 banorë).

#### **4. Aktivitetet e projektit**

Ndër punimet bazë të cilat mund të parashikohen në këtë projekt janë:

1. Pastrimi dhe sistemimi i bregut të liqenit të Shkodrës
2. Sistemimi i truallit dhe gjelbërimi i tij
3. Mbjellja e bregut me bimësi karakteristike

#### **5. Pjekuria e projektit**

Projekti është një ide në mbështetje të konceptit të zhvillimit strategjik të Malësisë së Madhe hartuar në analizën e PZF. Nga ana tjetër, ka një studim mbi Liqenin e Shkodrës: “Plani Strategjik i Veprimit për Liqenin e Shkodrës në Shqipëri dhe Malin e Zi”, i cili është hartuar nga ministritë përgjegjëse të mjedisit të të dy vendeve. Ky dokument përshkruan gjendjen e florës karakteristike të pellgut dhe nevojat për ndërhyrje me qëllim zhvillimin e qëndrueshëm të ekosistemit.

#### **6. Burimet e financimit të projektit**

Donatorë të mundshëm të projektit janë identifikuar: Ministria e Mjedisit, Buxheti Vendor, Fondi Global i Mjedisit, Banka Botërore si dhe fondet IPA, nisur nga fokusi i projektit mbi rehabilitimin e mjedisit dhe veçanërisht në liqenin e Shkodrës.

#### **7. Kosto e projektit**

Kosto e përafert e sistemimit të një territori të gjelbert dhe pasija me vende qëndrimi prej druri ose materiale në perputhje me natyrën është 50,000 Euro.

Titulli i projektit	Hartimi i standarteve për ndertimin e gropave septike
Lloji i projektit	Zhvillim i qëndrueshëm i sektorit strategjik të turizmit, zhvillim i shërbimit publik të menaxhimit të ujërave të ndotura
Vendndodhja e projektit	I gjithë territori i ZF
Buxheti i vlerësuar gjithsej	20,000 Euro

## **1. Analiza e problemit**

Shërbimi i organizuar i grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura në ZF Malësi e Madhe është në stade fillestare. Për herë të parë në vitin 2014, SHAUK është pajisur me një licencë për shërbimin e kanalizimeve të ujërave të ndotura. Për rrjedhojë nuk ekzistojnë të dhëna statistikore historike për këtë shërbim.

Konfirmohet ekzistenca e tubacioneve në qendër të Koplikut por nuk ka një hartë dhe inventarizim të këtij rrjeti. Në fshatra ky shërbim bëhet me gropa primitive dhe kanalizime të improvizuara, pa standarte dhe me pasoja në mjedis (sensitive për ndotjen e lumenjve e të liqenit dhe me pasoja të mundshme për shëndetin e për turizmin).

Një stacion trajtimi tjerash të ndotura është ndërtuar në Velopojë Velipoja, brenda zonës aktuale të shërbimit të SHAUK Malësi e Madhe, (investim i BE).

Zona Funktionale Malësi e Madhe aktualisht nuk është e lidhur dhe nuk përfiton shërbimin e këtij impianti dhe do të duhen investime kolosale në tubacione për ta realizuar këtë lidhje në të ardhmen. Nuk ka ande një orientim strategjik për çështjen e kanalizimeve dhe ndalimin e derdhjes së ujërave të ndotura në liqenin e Shkodrës e në lumenj.

Në këto kushte edhe për një periudhë të gjatë kohe do të vazhdojë përdorimi i gropave septike në familjet rurale, sidomos në zonat me denduri të ulët e shpërndarje të madhe të popullsisë. Ky shërbim i kryer nga vetë banorët mund të bëhet më pak i dëmshëm për mjedisin nëse gropat septike ndërtohen në një standart të caktuar i cili nuk lejon penetrimin e toksinave në tokë dhe më pas dërgimin e tyre në liqen përmes ujërave nëntokësore. Këto standarte mund të adoptohen nga drejtuesit e ZF Malësi e Madhe si standarte të detyrueshme për këtë shërbim si hap fillestar në ndalimin e ndikimit negativ në mjedis.

## **2. Objektivi i projektit**

Financimi i dizenjimi i një standarti të caktuar për gropat septike të përdorura nga banorët e zonave ku nuk ka rrjet kanalizimesh të njohur si të tillë nga SHAUK i cili siguron mbrojtjen e mjedisit dhe është i përballueshëm nga banorët.

## **3. Rezultatet e pritshme të projektit**

Rezultatet e pritshme të projektit janë:

- Standarte të miratuara të gropave septike
- Ulje e ndotjes së ambjentit rreth shtëpive të banorëve
- Ulje e ndotjes së ujërave nëntokësore, lumenjve e liqenit.



#### 4. Aktivitetet e projektit

9. Analizë e nevojave individuale mesatare të një familje ose biznesi për shërbimin e mbledhjes së ujërave të ndotiura nëpërmjet gropave septike
10. Hartim i standarteve të ndërtimit të gropave septike për familjarë e biznese.

#### 5. Pjekuria e projektit

Aktualisht nuk ekziston asnjë standart për ofrimin e këtij shërbimi në Zonën Funktionale. Nuk ka studime të mëparshme por mund të merren eksperiencia nga zona rurale të shteteve të zhvilluara Europiane. Zvicra dhe Gjermania kanë një përvojë të gjerë në këtë drejtim. Puna për hartimin e këtyre standarteve duhet të fillojë me një analizë paraprake të nevojave, të terrenit dhe të organizimit të vendbanimeve.

#### 6. Burimet e financimit të projektit

**Bashkia Malësi e Madhe**  
**DLDP**

#### 7. Kosto e projektit

Kosto e vlerësuar e një studimi të planifikimit urban për një territor të tillë është 20,000 Euro.

#### PROJEKTE NE NDIHME TE FILLIMIT TE SHPEJTE TE PUNES TE ZF (QUICK START)

Titulli i projektit	Asistencë për inventarizim dhe konsolidimin e aseteve dhe financave te ZF
Lloji i projektit	Quick start, Manaxhim i Zonës Funktionale
Vendndodhja e projektit	Qendra e ZF
Buxheti i vlerësuar gjithsej	20,000 Euro

#### 1. Analiza e problemit

Njësia e re administrative përfaqësuese e Zonës së re Funktionale do të përballet menjëherë me sfidën e identifikimit të burimeve të të ardhurave për zonën funksionale si dhe me njohjen dhe identifikimin e aseteve, pronave, territorit nën administrimin e saj. Njësitë ekzistuese vendore nuk do të jenë më operative. Staf i Bashkisë së re mund të jetë potencialisht pa kualifikimin e nevojshëm për të realizuar operacione shkrirjesh (merge) të njësive administrative. Identifikimi i burimeve të të ardhurave, pronave dhe aseteve të ZF mund të shndërrohet në një proces të tejzgjatur duke bërë të vështirë operimin e njësisë së re vendore dhe duke rrezikuar mundësitë e saj për të ofruar shërbime.

Konsolidimi fillestar i të gjitha aspekteve financiare dhe administrative të Zonës do të kerkoje ndihmë të specializuar me qëllim futjen sa më shpejt në efincencë të manaxhimit të ri të Zonës.

## **2. Objektivi i projektit**

Hartimi i një rregjistri asetesh të konsoliduar për ZF, hartim i pasqyrave financiare fillestare të konsoliduara, hartim i një rregjistri të konsoliduar të tokës dhe banesave, hartim i një rregjistri të konsoliduar të bizneseve dhe burimeve të tjera të të ardhurave vendore.

## **3. Rezultatet e pritshme të projektit**

Rezultatet e pritshme te projektit jane:

- Rregjistër asetesh i konsoliduar për ZF, hartim i
- pasqyrave financiare fillestare të konsoliduara,
- rregjistri të konsoliduar të tokës dhe banesave,
- rregjistri të konsoliduar të bizneseve dhe burimeve të tjera të të ardhurave vendore.

## **4. Aktivitetet e projektit**

11. Identifikim i të dhënave për cdo njësi vendore për sejcilin prej komponentëve të kërkuar.
12. Verifikim me burime qendrore në rastet kur është i mundur.
13. Konsolidim i të dhënave në rregjistra e pasqyra të konsoliduara.
14. Hartim i standarteve të ndërtimit të gropave septike për familjarë e biznese.

## **5. Pjekuria e projektit**

Aktualisht nuk ekziston asnjë ide për ofrimin e këtij shërbimi në Zonën Funktionale. Ministria e Pushtetit Vendor nëpërmjet Projektit STAR po bën pilotimin e kësaj asistence në dy Zona Funktionale të reja. Procesi ka rezultuar i vështirë dhe ka provuar nevojën për ekspertizë të mirëfilltë për kryerjen e tij. Autoritetet vendore ku po kryhet ky procesi nuk kanë eksperiencën dhe kualifikimin e duhur për këtë stad. Njohja me eksperiencën e KPMG me dy zonat pilot dhe problemet e hasura nga Projekti STAR mund të shërbejnë për të përmirësuar mënyrën e adresimit të asistencës në ZF Malësi e Madhe.

## **6. Burimet e financimit të projektit**

**Bashkia Malësi e Madhe  
DLDP**

## **7. Kosto e projektit**

Kosto e velrësuar e një asistence të tillë për ZF Malësi e Madhe është 20,000 Euro.

Titulli i projektit	Asistencë për inventarizim dhe konsolidimin e asetëve dhe financave të SHAUK për territorin e ZF Malësi e Madhe
Lloji i projektit	Quick start, Manaxhim i Zonës Funktionale
Vendndodhja e projektit	Qendra e ZF
Buxheti i vlerësuar gjithsej	45,000 Euro

### 1. Analiza e problemit

Njësia e re administrative përfaqësuese e Zonës së re Funktionale do të përballet menjëherë me nevojën për ofrimin e shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizime për banorët e saj. Drejtuesve të ZF do tu duhet të themelojë dhe të licensojë një ndërmarrje e cila të marrë në dorë administrimin e shërbimit të furnizimit me ujë dhe grumbullimin e largimin e ujrave të ndotura në të gjithë territorin e ZF, dmth: një ZF - një entitet.

Një njohje më e thellë e situatës së ofrimit të këtyre shërbimeve është e nevojshme pasi shume të dhëna mungojnë ose janë mbi bazë hamendësimi.

Në kuadër të organizimit dhe funksionimit të një ndërmarrje të re, detyra të tjera do të merren në konsideratë mënjëherë, përfshirë, por jo duke u limituar ne:

8. Hartimi i Planit të Investimeve Kapitale, afatshurter, afatmesem dhe afaatgjate, në përputhje me burimet aktuale të financimit si dhe me Masterplanin e Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve të Shqipërisë,
9. Llogaritjen e kostove dhe tarifave,
10. Vendosjen e një sistemi faturimi dhe arketimi për të ardhurat

Të gjitha këto kërkesa për të dhëna janë të vlefshme si për sistemin e furnizimit me ujë ashtu edhe për sistemin e kanalizimeve të ujrave të zeza.

### 2. Objektivi i projektit

Projekti ka si objektivi identifikimin e bazës së të dhënave për ndërmarrjen e re të ujësjellësit për ZF Malësi e Madhe si dhe matjen e standarteve të shërbimit të furnizimit me ujë dhe atij të largimit të ujrave të ndotura.

### 3. Rezultatet e pritshme të projektit

Rezultatet e pritshme të projektit janë:

- Rregjistër i burimeve ujore, tipi, sasia e ujit, vendndodhja,
- Rregjistër i rrjeteve të tubacioneve dhe e standartit të tyre

- Rregjistër i popullsisë në fshatra/qytete që mbulohen me shërbimin e furnizimit me ujë në përmjet sistemeve të centralizuara,
- Rregjistër i sistemeve të centralizuara (me vetërrjedhje dhe / ose me ngritje mekanike).
- Listë e konsoliduar e personelit të angazhuar sipas kategorise së punës,
- Tregues të matur të shërbimit përfshirë kohëzgjatja e furnizimit me ujë për çdo sistem,
- Identifikimin e popullsisë në fshatra/qytet që mbulohen me shërbimin e furnizimit me ujë direkt nga burimet natyrore dhe identifikimi i këtyre burimeve
- Hartë e GIS e populluar me të gjithë informacionin e mësipërm.

#### **4. Aktivitetet e projektit**

- 1- Identifikimi i burimeve ujore, tipi, sasia e ujit, vendndodhja,
- 2- Identifikimi i rrjeteve të tubacioneve dhe e standartit të tyre,
- 3- Identifikimi i popullsisë në fshatra/qytet që mbulohen me shërbimin e furnizimit me ujë në përmjet sistemeve të centralizuara,
- 4- Identifikimi i sistemeve të centralizuara (me vetërrjedhje dhe / ose me ngritje mekanike).
- 5- Identifikimi i personelit të angazhuar sipas kategorise së punës,
- 6- Matja e sasisë së shërbimit përfshirë, kohëzgjatja e furnizimit me ujë për çdo sistem,
- 7- Identifikimin e popullsisë në fshatra/qytet që mbulohen me shërbimin e furnizimit me ujë direkt nga burimet natyrore dhe identifikimi i këtyre burimeve
- 8- Hedhja e të dhënave në GIS.

#### **5. Pjekuria e projektit**

Aktualisht nuk ekzistojnë të dhëna të sakta për asnjë nga aspektet e funksionimit të Shoqërisë Aksionere Malësi e Madhe. Në raportet e vlerësimit të performancës të Entit Rregullator të Ujit komentohet për luhatjet e vazhdueshme në të dhënat e raportuara nga SHAUK Malësi e Madhe. Ekzistojnë disa të dhëna bazë për një pjesë të territorit të cilat duhen integruar me pjesë të territorit të cilat nuk kanë qenë pjesë e kësaj SHAUK dhe i kanë administruar në mënyrë individuale burimet, sistemet dhe shërbimet në fjalë.

### **10 Burimet e financimit të projektit**

**Bashkia Malësi e Madhe**  
**DLDP**  
**MTI**

### **11 Kosto e projektit**

Kosto e vlerësuar e një asistence të tillë për situatën e të dhënave në SHAUK Malësi e Madhe është 45,000 Euro.